

Fakulteti: Fakulteti i drejtësisë

Programi studimor: E drejta Penale

Kandidati: Fjolla Saiti

Mentore: Prof D-r Besa Arifi

**Titulli punues i temës:**

"Pranimi i fajit në procedurën penale - aspekte krahasuese"

"Признавање на вина во кривична постапка - компаративни аспекти"

"Admission of guilt in criminal proceedings - comparative aspects"

## Përmbajtja:

### Hyrje

.....  
.4

### **Kapitulli I - Pranimi i fajit në procedure penale** .....6

1.1 Pranimi i fajit – nocioni  
..... 6

1.2 Rëndësia e pranimet të fajit në procedurë penale.....9

1.3 Pranimi i fajit, marrëveshja në procedurë penale dhe institute te së drejtës restor..  
10

### **Kapitulli II - Pranimi i fajit në procedurë penale aspektet komparative** .....13

2.1 Pranimi i fajit në procedurë penale te sistemet juridike anglosaksone.....13

2.1.1 Shtete e bashkuara të Amerikës - “Plea bargaining”.....13

2.1.2 Britania e madhe dhe Wells  
.....21

2.2 Pranimi i fajit në procedure penale te sistemet juridike kontinentale.

2.2.1 Gjermania  
.....26

2.2.2 Italia..... 31

2.2.3 Hollanda  
.....34

2.3 Aspektet rajonale te pranimet te fajit në procedurë penale.....36

2.3.1 Republika e Kroacisë.....36

2.3.2 Republika e Sërbisë  
.....40

2.3.3 Repubila e Kosovës	44
2.3.4 Republika e Shqipërisë	52
<b>Kapitulli III - Pranimi i fajit në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....</b>	<b>55</b>
3.1 Gjenezja dhe aspektet e përgjithshme normative të pranimit të fajit ne RMV.....	55
3.2 Kushtet dhe mënyra e aplikimit te pranimit të fajit në procedurë penale ne RMV....	59
3.3 Efektet e praktike nga aplikimi i pranimit të fajit në RMV.....	69
<b>Kapitulli IV - Pranimi i fajit në procedurë penale dhe liritë e të drejtat e njeriut.....</b>	<b>82</b>
4.1 Mbikëqyrja gjyqësore e aplikimit te pranimit të fajit.....	82
4.2 E drejta e ankimit.....	85
4.3 Revokimi i pranimit të fajit, aspekte praktike.....	87
<b>Kapitulli V- Përfundimi dhe rekomandime.....</b>	<b>92</b>
Bibliografija.....	95

## Hyrje

Tema e këtij hulumtimi përmban një lëndë studimore aktuale, me një traditë më të gjatë në vendet e sistemeve juridike të etabluara si një segment i së drejtës restorative në kuptimin më të gjërë, që ka për qëllim përshpejtimin e procedurës penale dhe rritjen e efikasitetit nga njera anë, dhe evitimin e harxhimeve të panevojshme nga ana tjetër, gjithnjë duke pasur parasysh liritë dhe të drejtat e njeriut, gjatë zhvillimit të një procedure të tillë.

Lëndë e këtij hulumtimi është pranimi fajit në procedure penale – aspekte nacionale dhe në veçanti ata krahasuese, duke filluar nga origjina e këtij instituti penal juridik, nevoja e aplikimit të këtij instituti, kushtet dhe mënyra e aplikimit si dhe efektet procedurale dhe praktike në një sistem juridik.

Trajtimi bazë gërsheton përvojat krahasuese që kanë të bëjnë me aplikimin e këtij instituti, efektet e arritura dhe dobësitë e të këtij instituti, duke përfshirë edhe numra konkret për aplikimin e pranimi të fajit në procedurë penale, me theks mbi faktorët dominantë që stimulojnë këtë institut dhe benefitet e mundëshme, të akuzuarve që pranojnë fajin, në kontekst të llojit dhe lartësisë së sanksionit dhe benefiteve tjera.

Aplikimi i këtij instituti juridik me të cilin tejkalohej një fazë e procedura penale, është me rëndësi për efikasitetin e sistemeve juridike në luftën kundër krimit, duke arritur një funksionalitet maksimal të procedurës penale dhe efekteve penale juridike, siç është zvogëlimi i jo-dënueshmërisë, që shpeshhere aktorët procedural mundohen ta arrijnë nëpërmjet parashkrimit të ndjekjes penale. Ky synim është në kontekst edhe të nenit 6 të Konventës Europiane për liritë dhe të drejtat e njeriut, kur flitet për një gjykim brenda një intervali kohorë të arsyeshëm.

Ky përcaktim gjen mbështetje në akte dhe dokumente të Këshillit të Europës, në veçanti Rekomandimi P (87)18 i Komitetit të ministrave për thjeshtësimin e procedurës penale, që rekomandon zgjerimin e aplikimit të parimit të oportunitetit në ndjekjen penale, procedurën e shkurtuar për vepra minore ose vepra në masë, si dhe marrëveshje jashtë-gjyqësore në mes organeve kompetente dhe organeve tjera si këmbim për ndjekje penale.

Hulumtimi ka për qëllim të pasqyrojë aspektet legislative krahasuese, nevojën dhe mënyrën e aplikimit të pranimit të fajit në procedurë penale, si dhe efektet e arritura në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi, duke pasur parasysh aspektet procedurale siç është mundësia e ankimit, aspektet e trajtimit të barabartë të palëve dhe mbykqyrja gjyqësore.

Sot kriminaliteti është një çështje planetare dhe imponon nevojën e një reagimi të përshtatshëm dhe në kohë. Në këtë drejtim pranimi i fajit në kushte dhe procedurë ligjore ka rëndësinë e tij teorike dhe praktike, që do të gjendet në fokus të këtij hulumtimi.

Pranimi i fajit si insitut juridik i etabluar, gjenezën e ka tek sistemet juridike anglosaksone, duke u bazuar në aktet normative dhe praktikën gjyqësore shumvjeçare, por aplikimi më i gjërë i këtij instituti impon nevojën e regullimit normativ të detajuar, me qëllim të moskeqpërdorimit të njejtit, duke ofruar garanci maksimale për lirite dhe të drejtat e njeriut në kontekst të nenin 6 të Konventes Europiane për të drejtat e njeriut.

Ky institut penalo juridik, zgjon kureshtje hulumtuese edhe në aspekt të statistikave dhe efekteve ndaj kapaciteteve gjyqësore, si ato teknike dhe materiale, poashtu edhe ata njerëzore. Aspektet krahasuese të këtij instituti juridik, ndihmojnë përcaktimet normative dhe praktike të vendeve të ndryshme, në këtë drejtim edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## Kapitulli I - Pranimi i fajit në procedure penale.

### 1.1 Pranimi i fajit – nocioni.

Pranimin e fajit në procedurë penale gjenezën e ka te sistemi juridik i Shteteve të bashkuara te Amerikës, nëpërmjet institutit marrëveshje në procedurë penale që parashikon një autorizim të gjërë të palëve, në veçanti prokurorit publik që disponon me aktakuzën dhe nëpërmjet marrëveshjes gjegjësisht pranimin të fajit eviton gjykimin para porotës<sup>1</sup>, nëse gjen bashkëpunim të akuzuarit dhe mbrojtja e tij, të cilët në raste të caktuara kanë qëllimin e njëjtë, që të ikin gjykimin para porotës, por çdoherë duke llogaritur benefitet e mundshme të njërit apo formës tjetër të gjykimin.

Kjo formë e veprimit, përkundër benefiteve të lartpërmendura mundëson që procedura të mbarojë me rritëm të përshpejtuar, të zvogëlojë harxhimet procedurale, të zvogëlojë stigamatizimin e të akuzuarit dhe në fund procedura mund të ketë një mbarim të kontrolluar, gjegjësisht të dëshiruar nga palët pjesëmarrëse në një çështje penale juridike. Sistemi juridik anglo-sakson me një dinamikë më të përshpejtuar u orientua ka ky mekanizëm, që njihet edhe si drejtësi kontraktuale ose konsensuale.

Por një gjë e tillë nuk ndodhi me shtetet që promovojnë sistemin juridik kontinental. Për shembull Gjermania pas shumë luhatjeve duke përfshirë këtu edhe aplikimin joformal të marrëveshjes dhe pranimin e fajit, me në fund në vitin 2009 legalizoi marrëveshjen në mes palëve edhe atë në një formë tjetër, me gjykatësin në krye të procedurës për marrëveshje, edhe më tutje duke mbrojtur **parimin e gjetjes së vërtetës materiale** në procedurë penale dhe parimin e aficijalitetit. Ndërsa sistemi Italian, si një model i tretë njihet me një qasje të veçantë të gjykatësit të pavarur dhe objektiv si varijant i kundërt i atij Gjerman<sup>2</sup>, që do të

---

<sup>1</sup> Shih, Plea and Charge Bargaining Research Summary, Bureau of Justice Assistance U.S. Department of Justice January 24 ,2011, fq.1,PleaBargainingResearchSummary.pdf

<sup>2</sup> Dr. sc. Zvonimir Tomičić Viši asistent Pravnog fakulteta Sveučilišta Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku Ante Novokmet, mag. iur. Asistent Pravnog fakulteta Sveučilišta Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku, Pregledni znanstveni rad UDK 343.13:343.15 , fq 150.

fokusohe mi më gjerësisht kur do të shkruajmë për aspektet komparative to pranimit të fajit, duke filluar nga legaliteti i këtij instituti juridik, forma e aplikimit dhe rezultate e aritura nga ky mekanizëm.

Parimin e of icijalitetit e gjejmë shumë më herët te Ligji Austriak për procedurë penale nga viti 1853, që kish kuptimin se procedurë penale mund të n grehet dhe udhëhiqet vëtm në interes të shtetit, pa dalimi nga vullneti privat i palës së dëmtuar me veprën penale<sup>3</sup>. Parimi inkvizitor gjithashtu përfaqësonte interesin shtetërorë, që plotësohet me parimin e vlerësimit të dëshmimeve, pasi që e gjithë procedura karakterizohej me parimin inkvizitorë dhe veprimin ex officio, që paraqet një tendencë të qartë për të vërtetën formale në procedurë. Në këtë drejtim ligji kish pranuar të shtuquajturën teori dëshmuese negative sipas së cilës gjykatësi nuk ka qenë i obliguar të gjykojë të akuzuarin edhe përkundër asaj se egzistojnë dëshmi të caktuara, nëse nga disa shkaqe nuk ka qenë i bindur në fajësinë e tij, që në një farë mënyre paralajmëron idenë për vlerësim të lirë të dëshmimeve<sup>4</sup>.

Në kontekst të këtij instituti penalo juridik, theks të veçantë meritojnë parimet bazë të se drejtës penale të njohura nga të gjithë sistemet juridike. Vlen të thekslohet se e drejta tradicionale penale-procedurale dhe praktika gjyqësore që ishin karakteristikë për Europën, gjatë kohë e kundërshtonte të drejtën për marrëveshje për pranimin e fajit, gjegjësisht të drejtën konsensuale duke u bazuar në **parimin se reagimi ndëshkues**, është përcaktuar në mënyrë të prerë me ligj dhe ai nuk njih dialog, kompromis, as marrëveshje, duke pasur parasysh faktin se qëllimi kryesorë është mbrojtja e vlerave fundamentale socijale<sup>5</sup>.

Egzistojnë më shumë definicione të institutit penalo juridik - pranim i fajit në procedure penale dhe marrëveshje në procedurë penale. Marrëveshja për pranimin e fajit i njohur si “plea bargaining” mund të definohet si marrëveshje në mes prokurorit (paditësit) dhe të akuzuarit, me të cilën paditësi zotohet që të akuzuarit t’ia **zbutë aktakuzën** ose të propozojë ti shqiptohet **dënim më i butë**, ndërsa i akuzuari obligohet ta pranojë fajin që si pasojë ka heqje dorë nga e drejta kushtetuese për tu gjykuar para porotës.

Nëse thiremi në definicionin që regullon marrëveshjen në materjen civile, është plotësisht e qartë sa ajo është një akt dypalsëh, me të cilin palët i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e tyre. Ky definicion identifikohet më së shumti me marrëveshjen në SHBA, ku aktorë të vetëm të marrëveshjes janë palët në kontekst, gjegjësisht prokurori publik dhe i akuzuari, për dallim nga disa sisteme tjera të cilat në këtë proces i kanë dhënë një rol aktiv edhe gjykatësit. Por, pa dallim llojllojshmërisë dhe roleve të palëve, parashtrohet pyetja a mund këtë marrëveshje ta konsiderojm si marrëveshjen e tipit civil. Kuptohet se jo. Edhe pse logjika primare është ujdija, gjegjësisht marrëveshja nga e cila përfitojnë të dy palët dhe për të cilat parashihen të drejta dhe obligime, që në të shumtën e rasteve fillon me pranimin e fajit. Kjo formë e marrëveshjes e cila bazohet mbi kuptimin më të gjërë të pranimit të fajit,

<sup>3</sup> Ante Novokmet, mag.jur.Asistent Pravnogh Fakulteta u Osijeku, Austriski zakon o kaznenom postupku iz 1853 godine, s osvrtnom na njegovu ulogu u povjesti Hrvatskog kaznenog procesnog prava, Pregledni znanstveni rad UDK 343.1(436:497.5)(091), fq.85.

<sup>4</sup> Ibid, fq.86,

<sup>5</sup> OSCE, Marrëveshja për pranimin e fajit – Doracak për profesionist, fq.11.

**udhëhiqet nga parimi i legalitetit dhe ofcijalitetit** dmth, palë e kësaj marrëveshje nuk mund të jet çdo person por vetëm prokurori publik si organ shtetërorë dhe i akuzuari, në rastin konkret. Nga ana tjetër, duke u nisur nga kompetencat ligjore, prokurori publik mban llogari për interesin publik dhe të dëmtuarin në një procedurë konkrete, ndërsa gjykatësi ka një rol specifik në vërtetimin e këtij përcaktimi të prokurorit publik nga njëra anë dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të të akuzuarve nga ana tjetër, duke verifikuar (ose refuzuar) një marrëveshje të tillë ose pranimit të fajit i cili është bazë për sjelljen e aktgjykimeve dënuese.

Jo rallë herë, mendimi teorik shpreh rezervë ndaj këtij instituti juridik sa i takon rolit të viktimës në sistemin anglo-sakson. Prof. D-r Besa Arifi me të drejtë konstaton se viktima zakonisht është e përjashtuar nga procesi i quajtur “plea bargaining”, gjë që shpeshherë konsiderohet si tërësisht jo e drejtë, sepse paraqet një tjetër mënyrë të mbrojtjes së interesave shtetërore në llogari të interesave të viktimës, edhe pse me reformat e fundit në disa vende ku mbizotëron sistemi kontinental i së drejtës penale, legjislacionet e tyre parashohin një formë të **pjesmarjes së viktimës**<sup>6</sup>, duke e informuar atë me rezultatet e negociatave<sup>7</sup>. Ky proces është i ngjashëm me procesin e ndërmjetësimit në të drejtën kontinentale me dallimin, që në të drejtën anglo-saksone është një veprim normal, i arsyeshëm dhe i dëshirueshëm, që palët të negociojnë rreth pranimit të fajit, me qëllim që të mos shkohet në proces gjyqësor ose që i njëjti të lehtësohet. Në përkthim literal “bargaining” nënkupton “bërjen pazar” gjë që duket shumë e pazakontë për një jurist të sistemit kontinental, për të cilin **parimi i së vërtetës materiale është mbi të gjithë**<sup>8</sup>. Për më tej, procesi i negociimit të fajit në të drejtën anglo-saksone paraqet një proces shumë të mbyllur dhe të izoluar, ku zgjidhet një e keqe më e vogël në vend të një të keqeje më të madhe. Por, kjo qasje vjen në konsideratë vetëm për institucionet shtetërore. Sa i përket qasjes së viktimës, ky proces nuk paraqet gjë tjetër përpos një neglizhencë totale sa i përket interesit dhe sigurisë së saj dhe gjithçka tjetër që ajo e konsideron si drejtësi<sup>9</sup>.

Edhe përkundër pikave të përbashkëta të shprehura në më shumë definicione dhe legjislacione, në njërin anë ngel sistemi anglosakson i marrëveshjes i cili është i përqëndruar kah sasia e akt-akuzës, gjegjësisht numri, përshkrimi dhe kualifikimi juridik i veprës penale, përkundër konceptit European në të cilin lëndë e negociatave është lloji dhe lartësija e

---

<sup>6</sup> Netherlands Code of Criminal Procedure, Netherlands\_CPC\_am2012\_en.pdf, Section 51b, fq.17. Me kërkesën e viktimës, prokurori publik do t'i japë atij leje për të inspektuar rastin - dokumentet e rëndësishme për të. Gjatë seancës gjyqësore kjo leje jepet nga gjykata e shkalla e parë, para së cilës gjendet çështja. Me kërkesë të viktimës, do t'i jepet gjithashtu informacion se si viktima mund të marrë kompensim.

<sup>7</sup> Neni neni 490 alinea 4, LPP i RM, Kopje e aktgjykimit i dorëzohet të dëmtuarit. Nëse i dëmtuari nuk është i kënaqur me vendimin për llojin dhe lartësinë të kërkesës pronësorë juridike, të drejtën e tij mund ta realizojë në procedurë kontestimore.

<sup>8</sup> Shih prof dr. Milan Skulic, Odnos nacela istine i pojednostavljenih formi krivicnog postupka, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>, fq. 67- 74.

<sup>9</sup> Besa Arifi-Viktima-ne-Drejte-Penale-AJLS-2008.pdf, Roli i viktimës në të drejtën penale bashkëkohore – RSHSL, Konferenca Vjetore 2008, Ridefinimi i rolit të viktimës në të drejtën penale bashkëkohore përmes reformave ligjore. fq 3-4.

dënimit<sup>10</sup>, por edhe njëri edhe modeli tjetër bazohen në parimet juridike të shprehura në vendimet e Gjykatës supreme të Shteteve të bashkuara të Amerikës, në të cilat definohen obligimet kryesore të pandehurit gjatë procedurës për arritjen e marrëveshjes, ndalesa për hakmarje, roli i garantuesit dhe rruajtjesit të ligjshmërisë, aplikimi i diskrecionit të plotë të prokurorit në lidhje me llojin e veprave penale dhe çështje tjera me rëndësi për këtë lloj të procedurës. Ndërsa në të drejtën kontinentale kjo çështje është e rregulluar me ligj.

Sa u takon sistemeve kontinentale, procesi i negociimit të fajit (plea bargaining) nuk është dhe aq i inkorporuar. Është e qartë që ekzistojnë dispozita sipas të cilave bëhen përjashtime në ndjekjen ose dënimin e një personi që pranon të bashkëpunojë me organet e shtetit, nëpërmjet zbulimit të informatave rreth një ndërmarrjeje më të madhe kriminale, por kjo kryesisht realizohet në rastet e rënda të krimit të organizuar. Pra, një përjashtim i tillë nuk paraqet një praktikë të natyrshme dhe të përditshme siç është rasti në sistemin anglo-sakson, ku shumë pak raste e arrijnë gjykimin si pasojë e përdorimit të shpeshtë dhe të zakonshëm të institutit plea bargaining<sup>11</sup>. Një pasqyrim i këtillë i profesor Besa Arifit, nxjerr në dritë gjenezën e marrëveshjes dhe pranimit të fajit nëpërmjet institute të ndryshme ligjore, që më vonë merr mbështetje legjislative me Ligjin për procedurë penale të viti 2010 edhe në Republikën e Maqedonisë, si sistem i së drejtës kontinentale që tani më fiton segmente të së drejtës anglosaksone, nëse analizohet në tërësi.

Marrëveshja për pranimin e fajit është një nga reformat e fundit e vendeve në rajon dhe bëhet fjalë për një institut, që për bazë ka negociimin paraprak për pranimi e veprës penale, në mes të akuzuarit dhe prokurorit publik dhe në fund duke finalizuar me pranimin ose jo të propozim marrëveshjes nga ana e gjykatës. Ky institut aktualizohet edhe në ndërimet dhe plotësimet e LPP të Republikës së Serbisë, nga viti 2009<sup>12</sup>. Sipas profesor Stanko Bejatoviç<sup>13</sup> asnjë debat profesional në Serbi dhe më gjërë nuk ka vënë në pykëpyetje rëndësinë penalojuridike të këtij instituti juridik. Të kundërtën, ky institut për një kohë të shkurtër manifestoi arsyeshmërinë e tij. Ndërsa opinionin shkencorë për aplikimin e këtij instituti çdo ditë e më shumë e pranoi praktika.

## **1.2 Rëndësia e pranimit të fajit në procedurë penale.**

Duke u nisur nga specifikat e këtij instituti penalo juridik dhe kushtimisht hazarditeti që ai ofron, përkundër gjykimin në një procedurë kontradiktoe nëpërmjet së cilës arihet deri

---

<sup>10</sup> Д-р Гордана Бужаровска7 м-р Бобан Мисовски МРКПК, стр.2018

<sup>11</sup> Besa Arifi-Viktima-ne-Drejte-Penale-AJLS-2008.pdf , Roli i viktimës në të drejtën penale bashkëkohore – RSHSL, Konferenca Vjetore 2008, Ridefinimi i rolit të viktimës në të drejtën penale bashkëkohore përmes reformave ligjore. fq 3-4.

<sup>12</sup> Pojednostavljene forme postupanja u krivičnim stvarima, Rgionalna krivičnoprocesna zakonodavstva i istkustva u primeni, Obse misija u Srbiji, Fq,16, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>.

<sup>13</sup> Profesor i rregullt në Fakultetin juridik dhe Kryetarë i Shoqatës Serbe për teori dhe praktikë penalo juridike.

te e verteta materijale dhe vërtetimi i fajësisë së pandehurit, me të drejtë parashtrohet pyetja e rëndësisë së këtij instituti dhe atraktivitetit të tij proceduralo-penal.

Kjo formë e veprimit, përkundër benefiteve të lartpërmendura mundëson që procedura të mbarojë me rritëm të përshpejtuar, të zvogëlojë harxhimet procedurale, të zvogëlojë stigmatizimin e të akuzuarit, dhe në fund çështja penale të ketë një mbarim të kontrolluar gjegjësisht të dëshiruar, nga palët pjesëmarrëse në një çështje penalo juridike.

Rol kyç për pranimin e formave të ndryshme të marrëveshjeve për pranimin e fajit, i takon Rekomandimit Nr.(87)18 të Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës të vendeve anëtare për thjeshtësimin e të drejtës penale<sup>14</sup>, i cili rekomandon procedurën për marrëveshje për pranim të fajit, me qëllim të përshpejtimit të procedurës me rregulla të thjeshtësuara. Kjo ka të bëjë me mosprezantimin e dëshmive për gjendjen faktike, por vetëm dëshmitë që kanë të bëjnë me shqiptimin e dënimit. Këta aspekte mund të merren si përparësi të marrëveshjes për pranimin e fajit dhe pranimit e fajit gjatë shqyrtimit kryesorë. Ky institut penalo juridik, mundëson përshpejtimin e procedurës penale, zgjidhje më të shpejtë të lëndëve, dhe gjithësi arritje më të shpejtë të drejtësia.

Ky institut juridik, gjen nje aplikim të gjërë në SHBA. Sipas disa raporteve, më shumë se 90% e rasteve zgjidhen në këtë mënyrë<sup>15</sup>. Për dobitë e këtij instituti juridik gjithnjë e më shumë shprehen profesionistët e më shumë sistemeve juridike kontinentale.

Kështu, sipas Raportit vjetorë të Prokurorisë së Republikës së Maqedonisë së veriut, për punën e prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë së veriut në vitin 2020<sup>16</sup>, instituti penalo juridik - marrëveshja në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit, sjell deri te zgjidhje pozitive në aspekt të zgjidhjes së shpejtë të lëndëve, me atë edhe përparësi tjera për të akuzuarin dhe të drejtat e tij.

Sipas këtij raporti, dobitë nga marrëveshja në procedurë penale janë: zvogëlimi i harxhimeve në procedurë penale; procedurë penale efektive dhe efikase; zvogëlimi i kohëzgjatjes së procedurës, kështu që nga paraqitja e flet-padisë deri te mirratimi i propozim marrëveshjes mesatarisht nevojiten 5 muaj, që flet për arsyeshmërinë e prokurorisë që sa më shumë lëndë të kryhen në këtë mënyrë.

### **1.3 Pranimi i fajit, marrëveshja në procedurë penale dhe institute të së drejtës restorative.**

---

<sup>14</sup> Recommendation No.R(87)(18 ) concerning the simplification of criminal justice; Osce – Marrëveshje për pranimin e fajit – Doracak për profesionist, Shkup, dhjetorë 2010, fq.13; Обсе, Коментар на Законот за кривична постапка , Скопје ноември 2018 , fq. 964

<sup>15</sup> According to the Department of Justice's Bureau of Justice Assistance, "The overwhelming majority (90 to 95 percent) of cases result in plea bargaining". [https://www.law.cornell.edu/wex/plea\\_bargain](https://www.law.cornell.edu/wex/plea_bargain)

<sup>16</sup> <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/08/izveshta%D1%98-za-2020-%D1%98o-na-rsm.pdf>. Fq 29

Ndërprerja (pezullimi) e procedurës penale me kusht në Gjermani në vitet e gjashtëdhjeta njihet si parapërgaditje për aplikimin e pranimit të fajit dhe marrëveshjes në procedure penale, në kohën kur pranimi i fajit ende nuk kishte marrë formën e shkruar gjegjësisht nuk ish normuar, gjë që pasoi më vonë pas aplikimit joformal dhe rezultateve të arritura. Edhe Republika e Maqedonisë së Veriut në legjislacionin e saj ka parashikuar forma të tilla të përshpejtimit të procedurës penale dhe mosndjekjes për veprat me të lehta duke futur segmente të së drejtës restorative, që ka të bëjë me kompenzimin dhe reparacionin<sup>17</sup>.

Sipas definicionit të grupit punues për të drejtën restorative, “E drejta restorative është procedurë në të cilën të gjithë palët vendosin se si do të tejkalojnë pasojat e veprës penale dhe do të veprojnë në të ardhmen”, (Marshall, 1997, Restorative justice hand-book, 2000)<sup>18</sup>. Ndërsa Zehr (1990) të drejtën restorative e definon si model i së drejtës, i cili e përfshin viktimën dhe kryerësin e veprës penale në gjetjen e zgjidhjeve që promovojnë reparacion dhe këthim të ndjenjës së sigurisë.

Konsiderohet se e drejta restorative gjenezën e ka në sistemin juridik amerikan. Ky institut gjen përkrahje të **“parimit të oportunitetit”** si përjashtim i **“parimit të legalitetit”** nga i cili rrjedh obligimi për ndjekje penale të kryerësve të veprave penale.

Ky konflikt i parimeve në fjalë, më vonë dhe të vijë në shprehje edhe te format tjera të procedurave të përshpejtuara, në veçanti tek pranimi i fajit dhe obligimi ose jo për vërtetimin e gjendjes faktike ose fajësë të kryerësve të veprave penale, si një nga parimet bazë i së drejtës penale t.e “parimi i vërtetimit të së vertetës materijale”.

Edhe përkundër anëve negative, institucione të ndryshme që meren me çështje penale rekomandojnë aplikim më të madh të këtyre formave të procedurës penale<sup>19</sup>. Këtë problematikë e normojnë më shumë Kode penale të vendeve të ndryshme<sup>20</sup>, siç e regullon edhe Kodi penal i Republikës së Maqedonisë. Disa autorë janë të mendimit se ky institut duhet të precizohet me qëllim që asnjëra nga palët, mos të vijë në pozitë jo të barabartë.

Në Gjermani, hulumtimet dëshmojnë se autoriteti i organit shtetërorë gjatë miratimit të marrëveshjes në mes kryerësit dhe viktimës, garanton se dëmi dhe të kompenzohet, por gjithashtu mbron edhe kryerësin e veprës penale, pasi që e pengon të dëmtuarin të kërkojë kompenzim të fajit në situatë kur nuk është e sugurtë se pala tjetër ka shkaktuar dëmin me veprën penale<sup>21</sup>.

---

<sup>17</sup> Ligji për procedurë penale, „Gazeta zyrtare e RM“ Nr.150 nga 08.11.2010 viti.

<sup>18</sup> Shih, I Kovco, Kazna zatvor – Zasto i kuda, Hrvatski Ljetopis za kazneno pravo I praksu, Zagreb, vol.8 broj 2/2001, fq.117-136.

<sup>19</sup> Shih, Rezoluten e Kongresit të XIII për të drejtë penale, Kairo 1084.

<sup>20</sup> LPP i RM, Gazeta zyrtare e RM nr.15/97; LPP i RS, Gazeta zyrtare nr.46/06; LPP i Kroacisë N. Novine.

<sup>21</sup> Kondziela A “Tater – Opfer-Eusgleich und Unschuldsvemutung fur Kriminologie und Strafrechtreform mr.3”, fq.177.Shih, LPP i RM, Gazeta zyrtare e RM nr.15/97; LPP i RS, Gazeta zyrtare nr.46/06; LPP i Kroacisë N. Novine

S'do mend, se kjo procedurë dhe në veçanti pranimi i fajit nënkupton negociata nga palët relevante, që njihet edhe si medijacion në procedurë penale për të cilin në fillim egzistonin definicione të llojllojshme, varësisht nëse vijnë ata nga vendet anglosaksone ose e drejta kontinentale<sup>22</sup>.

Një definicion më i pranuar është ai i Kombeve të bashkuara<sup>23</sup>. Në më shumë definicione janë implementuar elementet e Rekomandimit për medijacion në materje penale, në të cilin medijacioni definohet si proces në të cilin viktimës dhe të akuzuarit i mundësohet në mënyrë vullnetarë të participojnë në zgjidhjen e konfliktit, që ka rrjedhur nga vepra penale me ndihmën e medijatorit<sup>24</sup>.

Por duke e pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimet e këtyre dy instituteve, duhet të bëhet distinkcion në mes medijacionit dhe marrëveshjes në procedurë penale, duke u nisur nga veprat penale lëndë e marrëveshjes<sup>25</sup>, parakushtet procedurale gjegjësisht pjesëmarësit dhe efektet penalo juridike. Deri sa te medijacioni palët kanë një pozitë thuajse komplet kontraktues, marrëveshja paraqet një zgjidhje alternative e kontesteve. Marrëveshja është instrument penalo-juridik me të cilin subjektet në procedurë vëndohen në një pozitë tjetër. Këtu prokurori publik fiton autorizime më të gjëra për të inicuar procedura të ndryshme për përshpejtimin e procedurës penale<sup>26</sup>(por çdoherë duke pasur parasysh interesin publik), me të cilat evitohet procedura klasike penale dhe njëkohësisht promovohet e ashtuquajtura **“drejtësi kontraktues”** gjegjësisht **“e drejtë konsensuale”**, në të cilën përveç të dëmtuarit edhe kryerësi i veprës penale mer një pozicion të veçantë. Forma të ndryshme të marrëveshjes stimulohen edhe në Rekomandimin nr. R (87) 18, për thjeshtëzimin e së drejtës penale, në situata kur i akuzuari e pranon fajin me qëllim të përshpejtimin të procedurës penale.

---

<sup>22</sup> Shih, Xhemali Saiti, Алтернативните мерки наспроти новите облици на криминалитет, Скопје 2013, fq, 47.

<sup>23</sup> Shih, д-р Лупчо Сотировски & Олга Ѓуркова, Меијација во кривичните предмети, Скопје, 2011, страна 19, sipas: The origins of Mediation – <http://toolsinnetwork.com/index.asp>

<sup>24</sup> Recommendation No.R (99) 19 of the Committee of Ministres to member States concerning mediation in penal matters, 15 shtator 1999.

<sup>25</sup> Modeli Françez i marrëveshjes nga viti 2004, njeh marrëveshje dhe miratim të aktgjykimit në bazë të marrëveshjes mes palëve, që nuk është e lejuar vetëm për veprimet kundërligjore, për të cilat është parashikuar denim në të holla ose dëni me burg deri në 5 vite.

<sup>26</sup> Ligji për procedurë penale i RM, Neni 39 – të drejtat dhe obligimet e prokurorit publik; Neni 42 – heqje dorë e prokurorit publik nga ndjekja penale; Neni 43 – anulim me kusht i ndjekjes penale; Neni 44 – mosndjekje penale.

## Kapitulli II - Pranimi i fajit në procedurë penale aspektet komparative

2.1 Pranimi i fajit në procedurë penale te sistemet juridike anglosaksone.

### 2.1.1 Shtete e bashkuara të Amerikës - “Plea bargaining”

Regullat federale të procedurës penale<sup>27</sup> në mënyrë të detajuar e regullojnë procedurën për marrëveshjen e palëve në kuadër të kaptinës së katërt me titull, “Seancë për prononcim për fajsinë dhe përgaditje për gjykim”. Sistemi penal amerikan njihet dy lloje të marrëveshjes në procedurë penale, edhe atë, marrëveshje për aktakuzën ose e njohur si “**charge bargaining**” dhe marrëveshje për sanksionin ose “**sentence bargaining**”.

**Marëveshje për aktakuzën - “charge bargaining”** paraqet marrëveshje në mes paditësit dhe të pandehurit me të cilën prokurori publik obligohet të **zbut aktakuzën**, në atë mënyrë që do të tërhiqet nga disa pika të saj, ose do të bëjë rikualifikimin e veprës penale. Me këtë qasje, konteksti (çështja) zgjidhet në procedurë të përsheptuar, kështu që tejkalohet një fazë e tërë e procedurës penale gjegjësisht shmanget gjykimi para porotës.

Duke u nisur nga marrëveshja e arritur, i akuzuari në seancë gjyqësore deklarohet si i fajshëm duke marrë për bazë aktakuzën e modeluar (adoptuar) për veprën e kryer. Në këtë situatë, gjykatësit i ngel vetëm të vërtetojnë se pranimi i fajit është bërë me vetëdije, i vullnetshëm dhe se marrëveshja është e mbështetur me dëshmi të tjera. Kjo mënyrë e zgjidhjes së kontesteve penale duke u bazuar mbi “Udhëzimet për shqiptimin e sanksioneve”, me të cilat kuadri në mes minimumit të veçanë dhe dënimit maksimal është paraqitur në mënyrë të detajuar dhe të ngushtë, u mundëson palëve në mënyrë të lehtë të parashikojnë lartësinë e dënimit që mund tu shqiptohet.

Modeli tjetër është “**sentence bargaininig**” ose “**marëveshje për sanksionin**”, në të cilin paditësi dhe i akuzuari merren vesh për një sanksion të caktuar i cili do të shqiptohet të akuzuarit nëse ai e pranon fajin, ose palët mund të bëjnë ujdë që paditësi në seancën për përcaktimin e sanksionit të angazhohet për një sanksion më të butë për të akuzuarin, ose që të mos shfaq asnjë propozim dhe të kundërshtojë propozimin e mbrojtjes në atë drejtim (11 (c), 1, B, C, Federal Rules of Criminal Procedure)<sup>28</sup>.

Marrëveshja për sanksionin nuk e obligon gjykatësin. Ai mund ta pranojë ose jo marrëveshjen, ose mund të ndërpresë procedurën për shqiptimin e sanksionit deri sa Shërbimi për shqiptimin e dënimeve nuk i dorëzon gjykatës Raport për veprën e kryer dhe kryerësin e veprës penale (11 (c), 3). Dhe mu për këtë, gjykata nuk është e lidhur me propozimin për lartësinë e sanksionit të ky lloji i marrëveshjes. Për shkaket e lartpërmendura

---

<sup>27</sup> Federal Rules of Criminal Procedure, 2011, <http://judiciary.house.gov/hearings/printers/112th/criminal, 2011.pdf>.

<sup>28</sup> Federal Rules of Criminal Procedure, 2011, <http://judiciary.house.gov/hearings/printers/112th/criminal2011.pdf>

statistikat flasin për një aplikim më të vogël të kësaj forme të marrëveshjes në procedurë penale.

Duke u nisur nga problematika e lartpërmendur, gjatë bisedimeve palët çdoherë duhet tu përmbahen “Udhëzimeve për shqiptimin e sanksioneve” të cilaj janë mirratuara me qëllim të zvoglimit të autorizimeve të gjykatësve në lidhje me shqiptimin e sanksioneve. Këta Regulla – Udhëzime, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë aplikuar me reformën e vitit 1984 me qëllim të realizimit të qëllimeve kryesore të dënimeve.

Nga kjo rrjedh se marrëveshja për akuzën dhe pazari i dënimit, zakonisht e ndajnë marrëveshjen për pranimin e fajësisë në dy lloje: negociatat e dënimit dhe marrëveshjet e akuzave. Megjithatë, marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të ndahen në kategori shtesë. Marrëveshja e dënimit është një metodë e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në të cilën prokurori pranon të rekomandojë një dënim më të lehtë për akuza specifike, nëse i pandehuri pranon fajësinë ose nuk i kundërshton atë. Pazari i akuzave është një metodë ku prokurorët bien dakord të heqin disa akuza ose të reduktojnë një akuzë për një vepër më pak të rëndë, në këmbim të një pranimi nga i pandehuri<sup>29</sup>.

Kur flasim për nocionin paditës i autorizuar në Shtet e Bashkuara, fjala është për paditësin shtetërorë (State Attorney), paditës i vetëm i autorizuar në procedurë penale në SHBA i cili duke u udhëhiqur nga “**parimi i oportunitetit**” mund të propozojë gjegjësisht aplikojë marrëveshjen në procedure penale, e cila mudëson kapërcimin e një faze të tërë të procedurës penale gjegjësisht gjykimin para porotës.

Kjo mënyrë e të vepruarit **pamudëson verifikimin e gjendjes faktike**, ndërsa gjykata shqipton vendim vetëm në bazë të asaj që palët ia prezantojnë në marrëveshje. Këta kompetenca **hapin dilemën funksionale të prokurorit publik**, në aspekt të mbrojtjes së interesit publik, duke pasur parasysh faktin se marrëveshja mer karakterin e një kontesti dy palësh. Por, edhe përkundër kësaj, nëse analizohen pozicionet e palëve, gjykatësit dhe Udhëzimet për matjen e dënimeve, intença e këtij instituti penalo juridik është që ti mundësojë prokurori publik të fitojë sa më shumë aktgjykime, që do të thotë rritje të efikasitetit gjegjësisht zgjidhje të sa më shumë çështjeve nga njëra anë, dhe zvoglimin e harxhimeve dhe rreziqeve eventuale nga vendimet e porotës, në anën tjetër. Kështu që, prokurori publik vendos të paditë vetëm kur ka dëshmi të sigurta dhe efikase.

Polemikat për praninë e pazareve për pranimin e fajit në SHBA, kanë qënë të vazhdueshme. Disa komentues kundërshtojnë marrëveshjet për pranimin e fajit, pasi që mendojnë se marrëveshjet i lejojnë të pandehurit të shmang përgjegjësinë për krimet që ka kryer. Të tjerë argumentojnë se marrëveshjet për pranimin e fajit janë shumë shtërnguese dhe minojnë të drejta të rëndësishme kushtetuese, pasi që marrëveshja për pranimin e fajit kërkon që i pandehuri të heq dorë nga tre të drejta të parashikuara në Amendamentin e Pestë dhe të Gjashtë të Kushtetutës së SHBA, që përmbajnë të drejtën për gjykim para porotës, të drejtën për t'u përballur me dëshmitarët dhe të drejtën për mos vetëinkriminim

---

<sup>29</sup> <https://www.nolo.com/legal-encyclopedia/the-basics-plea-bargain.html>.

<sup>30</sup>. Këtë hapsirë polemizuese e kristalizojnë qëndrimet e Gjykatës së Lartë (Supreme), e cila në shumë raste (*Brady v. United States* 397 U.S. 742 (1970), ka konstatuar se marrëveshjet për pranimin e fajësisë janë kushtetuese. Megjithatë, Gjykata e lartë ka vendosur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve duhet të jetë vullnetar dhe vetëm nëse i pandehuri është i njohtuar për pasojat e kësaj. (*McCarthy v. United States* 394 U.S. 459 1969)<sup>31</sup>.

Regullat federale të procedurës penale parashohin mundësinë që prokurori publik dhe i akuzuari të bëjnë marrëveshje<sup>32</sup> dhe të njëjtën janë të obliguar ta nxjerin para gjyqit (11 c, 2. 10 a, 3. FRCP). Por, kur mund të arrihet kjo. Sistemi amerikan bën dallim në mes pranimit të fajit të bërë para policisë (**confession**) në fazë të hetuesisë policorë, kur ende nuk kemi aktakuzë formale dhe pranim të fajit të bërë para gjyqit, në seancën për prononcim për fajësinë (**guilty plea**), pas ngritjes të aktakuzës. **Bisedimet për marrëveshje** palët mund ti fillojnë pasi që policia të mbarojë hetuesinë dhe dorëzojë padinë penale prokurorit. Në këtë fazë, paditësi ende nuk ka dëshmi të sigurt dhe është më fleksibil në bisedime, që i mundëson të dyshuarit një rezultat më të mirë në procedurë. Me Ligj nuk parashikohet mënyra e zhvillimit të bisedimeve por ata më thelbesisht rregullohen me Regulla interne të prokurorisë publike<sup>33</sup>.

**Format e deklaramit të të akuzuarit në seancë para gjykaës.** Në bazë të Regullit 10 dhe 11 -a të Federal Rules of Criminal Procedure i akuzuari mund të deklarohet në këtë mënyrë: "Jam fajtor", "nuk jam fajtorë" dhe "nolo contendere". Me deklaratën e fundit i akuzuari nuk e pranon fajin, njëkohësisht edhe nuk e mohon, por pajtohet ti shqiptohet sanksioni.

Në një deklaram "jo kontest" ose "nolo contendere", në thelb i pandehuri i thotë gjykatës: "Unë nuk zgjedh të kundërshtoj akuzat kundër meje". Ky lloj deklarami (pranimi), rezulton me një dënim penal ashtu si pranimi i fajit. Një pretendim i tillë për moskontestim do të shfaqet në dosjen penale të pandehurit. Megjithatë, nëse viktimi më vonë e padit të pandehurin në gjykatën civile, pranimi i fajit nuk mund të ofrohet si provë kundër të pandehurit si i tillë<sup>34</sup>.

Në këtë situatë parashtrohet pyetja se cili është motivi i kryerësit të veprës penale të bëj një marrëveshje në procedurë penale. Për tu bërë një marrëveshje në procedurë penale fillimisht nevojitet vullnet i mirë i prokurorit publik, në situata kur ai ka mungesë të dëshmive dhe gjykimin para porotës e bën të pasigurtë. Pasi të vërtetohet kjo, në shprehje vijnë

---

<sup>30</sup> Shih: Plea and Charge Bargaining Research Summary, Bureau of Justice Assistance U.S. Department of Justice January 24, 2011, fq.1 Ata që nuk janë në favor të marrëveshjes për pranimin e fajësisë argumentojnë se i pandehuri në çdo rast, më pas do të procedohet dhe do të zhvillohet një gjykim i paanshëm.

<sup>31</sup> [https://www.law.cornell.edu/wex/plea\\_bargain](https://www.law.cornell.edu/wex/plea_bargain).

<sup>32</sup> Federal Rules of Criminal Procedure 11 c1,

<sup>33</sup> Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Pravni vjesnik 2012 -34. fq. 155.

<sup>34</sup> Pretendimi "No Contest" (Nolo Contendere) në vend të pranimit të fajit, <https://www.nolo.com/legal-encyclopedia/criminal>.

autorizimet e gjëra të prokurorit publik që i mundësojnë atij të ashpërsojë aktakuzën ose ngritje të akt-akuzë sipas ligjit për recidivistë. **Një fakt që shkon në dëm të të akuzuarëve është se nuk egziston asnjë mbykqyrje ndaj bisedimeve dhe ata zhvillohen në linjë prokurorë – mbrojtës.** Duke pasur parasysh këta rethana shtrohet pyetja: A nuk është në presion psikik i akuzuari?.

Disa teoreticien amerikanë, marrëveshjen në procedurë penale e ekuivalentojnë me marrëveshjen dypalëshe obligative (obligacione)<sup>35</sup> në të cilën palët e kontestit me shkathtësitë e tyre imponojnë lëshime (kompromis) të ndërsjella, për të arritur një marrëveshje të kënaqshme për të dy palët. Pasi që gjykimi para porotës sjell pasiguri interes i të dy palëve është të arrijnë një marrëveshje.

Shtrohet pyetja, a është i mundur një krahasim i tillë të ketë mangësi dhe si qëndron çështja me barazinë e palëve në procedurë penale, në veçanti duke pasur parasysh faktin se prokurori publik, dozon lëshimet gjegjësisht favoret ndaj të akuzuarit varësisht nga mundësia e shqiptimit të aktgjikimit dënues në gjykim para porotës. Në këtë mënyrë i akuzuari nuk ka pozitën e palës së barabartë, sepse me veprimet e tija nuk mund të ndikojë tek vullneti i prokurorit publik.

Problemi i **barazisë së palëve** nuk dë të egzistonte, nëse nuk egziston faktori “befasi”, i cili ka të bëjë me pamundësinë e të akuzuarit ti dij dëshmitë e aktakuzës gjatë kontraktimit të marrëveshjes. Prokurori publik nuk do ti zbulojë të akuzuarit me çfarë dëshmi disponon, që të akuzuarin e vëndos në pozitë të pa lakmueshme dhe pamundëson edhe në kontekst hipotetik të vlerësojë mundësinë e suksesit të tij<sup>36</sup>.

Procesi i negociimit të fajësisë ka qenë u **kritikuar për mundësimin e tepërt të diskrecionit të prokurorit** në krahasim me gjyqtarët, të cilët u janë përmbajtur udhëzimeve koncize të dënimit (Burke, 2007; Finkelstein, 1975; Ma, 2002). Janë regjistruar raste në të cilat prokurorët kanë përdorin kërcënime për të detyruar të pandehurit të pranojnë fajësinë (Finkelstein, 1975). Në këtë kontekst, disa studiues kanë vënë në dukje se paragjykimet prokuroriale mund të ndikojnë në procesin e marrëveshjes për fajësinë sepse prokurorëve u jepet gjerësi e madhe gjatë zvogëlimit të akuzave ndaj kryerësve të veprave penale (Burke, 2007)<sup>37</sup>.

Diskrecioni i prokurorisë gjithashtu ka rezultuar me dënime më të ashpra te të pandehurit që zgjidhnin të shkojnë në gjyq, në vend që të pranojnë fajësinë. Shumë studiues kanë zbuluar se ato që shkojnë në gjyq, kanë më shumë gjasa të marrin dënime më të ashpra, se ata që pranojnë fajësinë (Albonetti, 1991; Britt, 2000; Dixon, 1995; Engen dhe

---

<sup>35</sup> Easterbrook, Frank H., Plea Bargaining as Compromise, The Yale Law Journal, vol. 101, br. 8/1992, Symposium: Punishment, str. 1969-1978, Burimi: vonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34.

<sup>36</sup> Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Pravni vjesnik 2012 -34. fq. 161.

<sup>37</sup> Plea and Charge Bargaining Research Summary, Bureau of Justice Assistance U.S. Department of Justice January 24 ,2011, fq.2, PleaBargainingResearchSummary.pdf.

Gainey, 2000; Kurlychek dhe Johnson, 2004; Steffensmeier dhe Demuth, 2000, 2001; Steffensmeier dhe Hebert, 1999; Steffensmeier et al., 1993, 1998). Për më tepër, studimet kanë gjetur se ata që u zotuan fajtorë kishin më shumë gjasa të merrnin dënime më të lehta se ato që do të kishin shkuar në gjyqi (King et al., 2005; Piehl dhe Bushway, 2007; Ulmer dhe Bradley, 2006). Kjo pabarazi ekziston sepse prokurorëve u jepet diskrecioni i gjërë për zvogëlimin e dënimit. Këto gjetje janë problematike, sepse ato demonstrojnë se nëse një i pandehur zgjedh të thirret në Amendamentin e Gjashtë - të drejtën për gjykim nga juria, ai ose ajo ka mundësi të ketë rezultat më të pafavorshëm<sup>38</sup>.

Një nga të drejtat themelore të akuzuarve në SHBA është **e drejta e mbrojtësit**, e garantuar me Amendamentin e VI të Kushtetutës. Pa dallim llojit të veprës penale, e drejtë absolute e të dyshuarit është të bëj zgjedhjen e mbrojtësit. Në këtë situatë avokati-mbrojtës njësor sikurse edhe prokurori publik tenton të sigurojë dëshmi të përshtatshme për të akuzuarin, **që të mund të krijojë sado pak një baraspeshë** në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit.

Ky institut siguron favore të shumta për prokurorin publik. Duke bërë marrëveshje prokurori publik tejkalon një fazë të tërë dhe shumë të rëndësishme të procedurës penale, me faktin që shmang gjykimin para porotës ku nuk do të dihet rezultati. Nga ana tjetër, përshpejton zgjedhjen e çështjeve dhe shpenzon kohë për tu përgaditur për lëndët që shkojnë para porotës. Rëndësia e veçantë e këtij instituti është se prokurori publik, nuk duhet të dëshmojë fajësinë e të pandehurit jashtë dyshimit të arsyeshëm, gjë që duhet bërë para porotës. Në këtë rast prokurorit i nevojitet një standard më i ulët i egzistimit të dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale.

**Pozicioni i gjykatës.** Rregullat federale të procedurës penale parashikojnë që bisedimet për pranimin e fajit të zhvillohen ekskluzivisht në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit (mbrojtjes). Në mënyrë eksplicite është parashikuar se gjykata nuk ka asnjë të drejtë dhe mundësi të ndikojë në vendimin e palëve gjatë bërjes së marrëveshjes (11c, 1FRCP)<sup>39</sup>. Roli i gjykatës është, vetëm të vërtetojë se prononcimi për fajësi është i vullnetshëm, i vetëdijshëm dhe i bazuar në fakte. Përveç fakteve të lartpërmendura, gjykatësi është i obliguar të kontrollojë, se a e ka kuptuar i akuzuari aktakuzën dhe a është i njohtuar për të gjitha elementet e veprës penale. Dhe, edhe më me rëndësi, gjykata duhet të vërtetohet se i akuzuari është i vetëdijshëm për të drejtën e tij kushtetuese për gjykim para porotës si dhe llojin e sanksionit penalo-juridik<sup>40</sup>.

---

<sup>38</sup> Ibid, fq.2-3.

<sup>39</sup> In some jurisdictions, prosecutors and defendants can work with judges to predetermine what sentence the defendants will get if the defendants accept plea bargains. In most jurisdictions, however, judges' role in plea bargaining is limited. For example, federal judges retain final authority over sentencing decisions, and are not bound by prosecutors' recommendations, even if the recommendations are part of plea bargains. Similarly, federal judges may not be directly involved in plea bargain negotiations. [https://www.law.cornell.edu/wex/plea\\_bargain](https://www.law.cornell.edu/wex/plea_bargain).

<sup>40</sup> Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34.

Në sistemin Federal të Shteteve të bashkuara numri mu i madh i lëndëve zgjidhen me marrëveshje për pranimin e fajit<sup>41</sup>. Por, për dalim nga kjo, gjykatat federale në SHBA me vëmendje të veçantë i shqyrtojnë marrëveshjet për fajin dhe të njejtat mund ti refuzojnë dhe nga avokatët dhe prokurorët mund të kërkojnë që të gjejnë zgjidhje të reja për pranimin e fajit. Në parim të akuzuarit në këto procedura marrin dënime më të vogla<sup>42</sup>.

Një nga problematikat e cila më së shumti frekuenton është fakti, se a ka ndikim pranimi i fajit në shqiptimin e dënimit. Në sistemin Federal egzistojnë dy situata në të cilat i akuzuari do të fitojë dënim më të ulët nëse vjen deri te marrëveshja për pranimin e fajit.

I. Në disa sisteme, zgjedhja e hershme e lëndës ose i ashtuquajtur i veprim në procedurë të shkurtuar mundëson zvogëlimin e dënimit ndaj të akuzuarit. **Procedura e shkurtuar** ishte një program i cili parësisht ishte miratuar për nevojat e prokurorisë gjatë kufirit Jugperëndimorë të Shteteve të bashkuara të Amerikës, për shkak se prokurorët dhe gjykatat federale të këtij rajoni, ishin të stërbushura me një numër të madh të lëndëve. Në atë kohë, Prokurori publik kryesorë (John Ashcroft), kishte përgaditur një program në bazë të cilit prokurorëve u është lejuar të pranojnë marrëveshje të caktuara për fajin me qëllim që lëndët të zgjidhen në mënyrë më efikase<sup>43</sup>.

Ky plan parashikonte kritere të caktuara, si parakusht që në gjykata kompetente të aplikohen programe për procedurë të shkurtuar, dhe ata ishin:

1). Hapësira gjyqësore duhet të përballet me një numër të madh të veprave penale konkrete dhe mungesa e procedurës së shkurtuar në mënyrë të konsiderushme do ta rëndonte punën e prokurorisë dhe resurset gjyqësore, ose hapësira gjyqësore patjetër të ketë ndonjë karakteristikë të veçantë lokale ose specifike, ndaj disa kategori të lëndëve që do ta arsyetonte veprimin në procedurë të shkurtuar. 2). Është e pamundur ose jo e përshtatshme lëndët të dorëzohen për ndjekje dhe veprim në nivel shtetërorë 3). Lëndët në fjalë, në mënyrë të vazhdueshme përsëriten dhe në numër më të madh bëhet fjalë për raste me rethana të njejtë materijale 4). Lëndët ndaj të cilave veprohet në procedurë të shkurtuar nuk mund të vlerësohen si “vepra penale të dhëna” nga Prokurori publik kryesorë.

Sipas plani të prokurorit John Ashcroft, programet në zonat e ndryshme kompetente do të miratohen për aplikimin e procedurës së shkurtuar, nëse i plotësojnë këto kushte:

1) I akuzuari **duhet ta pranojë fajin** në një “kornizë kohore të arsyeshme” për veprën për të cilën akuzohet. 2) Duhet të **përgaditet marrëveshje** e shkruar për fajin, në të cilën do të theksohen të gjitha faktet dhe do të përshkruhen elementet e veprës së kryer, ndërsa përfaqësuesit juridik patjetër duhet të pajtohen të terheqin të gjitha kërkesat dhe shkresat e parashtruara deri atëherë, ndërsa i akuzuari duhet të heq dorë nga e drejta për ankesë ose kontestim të aktgjykimit gjykues në bazë zë habeas corpus. 3) Nëse i akuzuari pajtohet,

<sup>41</sup> Sipas Byrosë së Statistikave të Drejtësisë (2005), në vitin 2003 ka pasur 75.573 raste regjistruara në gjykatën federale të rrethit me gjykim ose lutje, Nga këto, rreth 95 përqind ishin mbaruar me anë të pranimit të fajësisë.

<sup>42</sup> Lydia Brashear Tiede, An Analysis of Macedonian Sentencing policy and recommendations for future S directions: Towards a more uniform system, OSCE, Mission to Skopje, dhjetor 2012, fq.30.

<sup>43</sup> Ibid, fq.31

**prokurori mund ta zvogëlojë dënimin**, por ajo nuk mund të jetë më shumë se 4 vite ose nivele më të ulëta nga dënimi i parashikuar në Rregulla për matjen e dënimit<sup>44</sup>.

II. Mënyra e dytë që mundëson zvogëlimin e dënimit është kur gjykatësi e zvogëlon dënimin për të akuzuarin, nëse ai **në mënyrë të konsiderueshme bashkëpunon gjatë hetuesisë**, ndërsa paraprakisht prokurori ka kërkuar një zvogëlim të tillë. Nëse i akuzuari bashkëpunon, prokurori do të kërkojë nga gjykatësi zvogëlim të dënimit nëpërmjet marrëveshjes për pranimin e fajit në bazë të **kriterit- sigurim të bashkëpunimit të konsiderueshëm**. Gjykatat i trajtojnë marrëveshjet për pranimin e fajit si kontratë ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit. Nëse një i akuzuar thyen marrëveshjen për pranimin e fajit, kjo është e ngjashme me një shkelje të kontratës e cila do të rezultojë që prokurori të mos i përmbahet detyrimit të tij nga marrëveshja. Kjo situatë ka të bëjë me **shkelje të marrëveshjes për pranimin e fajësisë - violating a plea bargain**.

Nëse një prokuror refuzon marrëveshjet për pranimin e fajësisë, të pandehurit mund të kërkojnë lehtësim nga gjyqtari. Nuk është e pazakontë që, ata që janë akuzuar për krim të pranojnë fajin por më vonë të pendohen, të **tërheqin pranimin e fajësisë (Withdrawing a Guilty Plea)**, pavarësisht nëse është për shkak të një dënimi të ashpër të paparashikueshëm ose "pendimit të blerësit". Shumë të pandehur besojnë me të drejtë ose gabimisht, se ata kanë arritur një marrëveshje jo të përshtatshme<sup>45</sup>.

Pranimi i fajit që rezulton me një marrëveshje të miratuar nga gjyqtari dhe me një dënim penal, është ekuivalente me atë që do të ishte pas një gjykimi. Potenciam edhe më lartë se dënimi i shqiptuar në këtë mënyrë do të shfaqet në dosjen penale të të pandehurit (rap sheet). Si pasojë e kësaj i pandehuri humb çdo privilegj që dë ta kishte humbur nëse dënohej në procedurë të rregullt, siç është e derjta e votës dhe privilegje të tjera. Varësisht nga natyra e dënimit dhe veprimeve tjera të pandehurit ndaj ligjit ai mund të shlyej dosjen penale. Që don të thotë nga aspekti i pasojave juridike, pozicioni i të akuzuarit është i njëjtë pavarësisht llojit të procedurës që zhvillohet ndaj tij.

Praktika gjyqësore shumvjeçare në SHBA, ka krijuar standarde relevante për pranimin e fajit si institut i veçantë penalo juridik.

**I. Rasti Robert M. Brady V. United States**<sup>46</sup>. Nëse shihen faktet e rastit, Robert M. Brady u deklarua i pafajshëm për rrëmbim. Pasi mësoi se një i bashkë-akuzuar rrëfeu dhe do të ishte i gatshëm për të dëshmuar kundër tij, Brady e ndryshoi deklarinimin dhe pranoi fajin. Për këtë vepër penale ish parashikuar dënim maksimal me vdekje por një Ligj i SHBA e lejonte këtë dënim vetëm nëse ai rekomandohehet nga vendimi i një jurie.

Gjykatësi e dënoi atë me 50 vjet burg, ndërsa më vonë dënimi u ul në 30 vjet. Pas 8 viteve, Brady kërkoji lehtësim në Gjykatën e Qarkut të SHBA për Distriktin e Nju Meksikës,

---

<sup>44</sup> Ibid,

<sup>45</sup> <https://www.nolo.com/legal-encyclopedia/criminal-lawyers>

<sup>46</sup> U.S. Supreme Court, Brady v. United States, 397 U.S. 742 (1970), Brady v. United States, No. 270, Argued November 18, 1969, Decided May 4, 1970, 397 U.S. 742.

duke pretenduar se pranimi i fajit nuk ishte dhënë vullnetarisht sepse mundësia e dënimit me vdekje e detyroi pranimin e tij.

Gjykata e rrethit e refuzoi lehtësimin, ndërsa Gjykata e Apelit e SHBA për Qarkun e X-të, ate e vërtetoi, duke gjetur se Brady e ndryshoi deklaratën e tij për shkak të veprimeve të bashkëpandehurve. Gjykata iu referua vendimit *United States v. Jackson* i cili e konsideron dënimin me vdekje si jokushtetues, sepse ai imponon një barrë të palejueshme mbi të drejtën e të akuzuarit për të mos pranuar fajësinë (Amendamentit V) dhe të drejtën për gjykim nga juria (Amendamenti VI).

*Nga kjo për trupin gjykues u parashtruan pyetjet:*

1). A duhet që *United States v. Jackson* të zbatohet në mënyrë retroaktive për pranimin e fajit para këtij vendimi?

2). A e inkurajoi pa nevojë dënimi me vdekje Brady-n të pranonte fajin me shkelje të Amandamentit të Pestë?

Gjykatësit e trupit gjykues miratuan këtë konkluzion:

*Jo. Gjykatësi Byron R. White, duke shkruar për pesë anëtarë të gjykatës, pohoi: Gjykata e Lartë vendosi se United States v. Jackson nuk kërkon që çdo pranim fajit të rrëzohet kur frika nga vdekja ishte një faktor për pranimin e fajit. Vullnetariteti i pranimit të fajit përcaktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse. Ndërsa Brady, mund të ketë qenë pjesërisht i motivuar nga dëshira për të shmangur dënimin me vdekje. Pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht me këshillën e avokatit kompetent.*

*Gjykatësi Hugo L. Black u pajtua me aktgjykimin dhe opinionin në tërësi, por shprehu besimin e tij se United States v. Jackson kishin vendosur gabimisht. Gjykatësi William J. Brennan, Jr. u pajtua me vendimin sepse nuk kishte prova se frika nga dënimi me vdekje luajti rol thelbësor në vendimin e Brady. Gjykatësi Brennan u shpreh se metoda e analizës së gjykatës ishte e paqartë, ndërsa gjykatësi William O. Douglas dhe Thurgood Marshall iu bashkuan këtij opinionit.*

II. Në rastin U.S. Supreme Court, “*Nagelberg v. United States*”, 377 U.S. 266 (1964), (*Nagelberg v. United States* No.785, Decided May 25, 1964, 377 U.S. 266), Gjykata e apelit për Qarkun qarkun e dytë shpreh opinionin se Gjykata e Qarkut ka diskrecion për të lejuar **tërheqjen e pranimit të fajësisë** kur Qeveria planifikon të hedhë poshtë aktakuzën dhe të zëvendësojë atë me akuza më të vogla<sup>47</sup>.

Hulumtimi i lartëpërmendur<sup>48</sup> dhe shumë teoreticien nxjerrin në pah anët negative të marrëveshjes në procedurë penale në SHBA, siç është **diskrecioni i tepruar i prokurorit**, nevoja e kufizimit të marrëveshjes për **pranimin e fajit në disa lloje të akuzave** siç janë krimet më pak të rënda dhe nevoja e përfshirjes së gjykatësit dhe mbrojtjes në negocimin e

---

<sup>47</sup> <https://supreme.justia.com/cases/federal/us/377/266/#tab-opinion-1944938>. Në këto rrethana, ne besojmë se gjykata ka diskrecionin për të lejuar tërheqjen e pranimit. Shih Kercheval kundër Shteteve të Bashkuara, 274 U. S. 220, 274 U. S. 224 (1927).

<sup>48</sup> Plea and Charge Bargaining Research Summary, Bureau of Justice Assistance U.S. Department of Justice January 24 ,2011, fq.1,PleaBargainingResearchSummary.pdf.

akuzës në mënyrë që të ketë një **ekuilibër** në mes të gjithë pjesëmarrësve ligjorë (Bibas, 2004). **Në përgjithësi fokusi i reformave dhe e ardhmja e këtij instituti shihet në nevojën për të adresuar pabarazitë brenda sistemit dhe definimin e pozicionit të pjesëmarrësve gjatë marrëveshjes në procedurë penale.**

### 2.1.2 Britania e madhe dhe Uells

Marrëveshja për pranimin e fajit është e prezente edhe në sistemin juridik Anglez. Udhëzimet e Këshillit Britanik për politikë ndëshkimore janë që marrëveshja për dënimin të përcaktohet në bazë të kohës së prononcimit dhe pa ndikimin e ndonjë faktori tjetër. Udhëzimet potencojnë se sa më parë të pranohet fajësija, aq më i madh duhet të jetë zvogëlimi i dënimit. Zvogëlimi maksimal është 1/3 për marrëveshje në fazën më të hershme. Pranimi i fajit i bërë në ditën e parë të gjyqimit mundëson zvogëlimin e dënimit për 1/10. Zvogëlimi ndonjëherë mund të përfshijë edhe ndërimin e llojit të dënimit siç është ndërimi i dënimit me burg me punë në dobi të përgjithshme. Në krahasim me Shtetet e bashkuara në Britani të madhe, marrëveshja për pranimin e fajit aplikohet më rrallë. Kur aplikohet marrëveshja gjykatësit mund ta marrin parasysh atë gjatë matjes së dënimit, por vetëm nëse paraprkishtë edhe ata i shqyrtojnë faktet relevante<sup>49</sup>.

Britania e madhe këtë çështje e ka rregulluar në mënyrë të detajuar duke i parashikuar kushtet e aplikimit të këtij instituti penalo juridik, procedurën dhe në veçanti rolin e palëve dhe të gjykatës, duke përpunuar edhe kompetencën lëndore të gjykatave gjatë zbatimit të këtij instituti. Këta aspekte parashikohen me Rregullat e procedurës penale për gjykatat e larta të Anglisë dhe Uells<sup>50</sup>.

Sipas Seksionit, 9.8 nga Rregullat e procedurës penale për gjykatat e larta të Anglisë dhe Uells dhe gjykatat e magistratëve i pandehuri i madhorë mund të bëjë kërkesë për pranimin e fajit. Ky rregull zabohet kur i pandehuri është 18 vjeç ose më shumë dhe kur gjykata vendos se një çështje është më e përshtashme të gjykohe në gjykatën e magistraturës apo në gjykatën mbretërore.

Në këtë rast gjykata duhet ta njohtojë të akuzuarin për pretendimet që kanë të bëjnë veprën e kryer, dhe ti shpjegojë termet juridike që i pandehuri ti kuptojë, nëse ka nevojë edhe me mjete ndihmëse përveç nëse pretendimi është i shpjegueshëm. Gjykata duhet të njohtojë (ti bëjë me dije) të akuzuarin se vepra penale mund të gjykohe në gjykatën e magistraturës ose në gjykatën mbretërore, si dhe për të drejtën e pranimin të fajit. Njëkohësisht do të njohtojë të akuzuarin, se nëse përgjegja është “po” atëherë gjykata atë do ta trajtojë si pranim të fajit dhe do ti shqiptojë dënim, ose ta dërgojë në gjykatën mbretërore për të shqiptuar dënimin<sup>51</sup>. Nëse i pandehuri nuk përgjigjet ose përgjigja është

<sup>49</sup> Lydia Brashear Tiede, An Analysis of Macedonian Sentencing policy and recommendations for future S directions: Towards a more uniform system, OSCE, Mission to Skopje, dhjetor 2012, fq.30.Fq, 31

<sup>50</sup> The Criminal Procedure Rules 2020, UK Statutory Instruments 2020 No, 759 (L. 19), <https://www.legislation.gov.uk/uksi/2020/759/contents/made>

<sup>51</sup> Për pranimin e fajit, shih: Altin Shegani, E drejta penale e krahasuar, Tiranë 2002, fq.178.

“jo” atëherë gjykata vendos nëse do tia dërgojë çështjen gjykatës së magjistraturës ose gjykatës mbretërore për gjykim. Vlera e përfshirë mund të përcaktojë që gjykata të urdhërojë gjykim në një gjykatë të magjistraturës për gjykim. Nëse ndodh kjo i pandehuri ka mundësi të kërkojë gjykim në gjykatën mbretërore.

**Pranimi i fajit të pandehuri madhorë.** Kjo situatë zbatohet kur zbatohet Seksioni 9.8 nga Rregullat e procedurës penale për gjykatat e larta të Anglisë dhe Uels dhe gjykatat e magjistrateve dhe kur i pandehuri ka për qëllim të pranojë fajin. Në këtë rast gjykata duhet të ushtrojë kompetencën e saj për të trajtuar çështjen në një gjykatë të magjistraturës, në përputhje me seksionin 24.11.

Në bazë të Seksionit 9.10 i pandehuri mund të deklarohet i pafajshëm, kjo zbatohet kur aplikohet Seksioni 9.8 dhe atëherë kur i pandehuri tregon gadishmëri për tu deklaruar i pafajshëm ose nuk jep asnjë tregues për pranimin e synuar. Në këtë situatë kur vepra është ajo për të cilën zbatohet Seksioni 22 i Aktit të gjykatave të Magjistraturës 1980<sup>52</sup>, gjykata duhet të pandehurit ti shpjegojë termat që ai të mund ti kuptojë. Pastaj ajo vlerëson, nëse vlera e përfshirë është më pak se 5.000 £, do të urdhërojë gjykim në një gjykatë të magjistraturës. Nëse gjykata nuk mund të përcaktojë se kjo vlerë është më e madhe ose më e vogël se 5.000 £ atëherë, do të pyes nëse i pandehuri pranon të gjykohet në gjykatën e magjistraturës. Kur përgjigja për këtë pyetje është “po” atëherë gjykata duhet të urdhërojë gjykim dhe nëse i pandehuri dënohet atëherë dënimi është i kufizuar. Nëse i pandehuri nuk i përgjigjet kësaj pyetje ose përgjigja është “jo” ose nëse kjo vlerë është qartësisht më shumë se 5.000 £ zbatohet paragrafi 2 (e), dhe sipas kompetencës gjykata do të dërgojë çështjen për gjykim duke marrë parasysh: përshtatshmërinë e kompetencave dënuese të gjykatës së magjistraturës, propozimet nga palët dhe Udhëzimet e Këshillit për dënime (Këshillit dënues). Këta norma rregullojnë çështjen e kompetencës lëndore të gjykatës duke u bazuar mbi vlerën e lëndës dhe prononcimin e të pandehurit.

Më pastaj gjykata do të ftojë prokurorin që të prezentojë pretendimet që mund ti marrë parasysh gjykata, të deklarohet rreth mënyrës se si gjykata duhet ta ndajë çështjen për gjykim duke u prononcuar edhe për vlerën e përfshirë dhe të ftojë të pandehurin të bëjë deklaratatë tilla.

Këshilli Dënues mund të nxjerrë Udhëzime për ndarje të çështjeve sipas nenit 122 të Aktit të Drejtësisë 2009. Udhëzuesi përfundimtar i alokimit i cili hyri në fuqi më 1 mars 2016 parashikon:

(1) Veprat penale duhet të gjykohen në procedurë të bashkuar, përveç nëse rezultati do të ishte një dënim që tejkalon kompetencat e gjykatës për veprën në fjalë, pasi të merret parasysh zbutja personale dhe çdo reduktim i mundshëm për pranimin e fajit ose për arsye të kompleksitetit të pazakontë ligjor, procedural ose faktik, çështja duhet të gjykohet në Gjykatën e Mbretërore. Ky përrjashtim mund të zbatohet në rastet kur një gjobë më e lartë

---

<sup>52</sup> Sipas nenit 22 të Aktit të vitit 1980, disa vepra të cilat mund të gjykohen në gjykatën e magjistraturës ose në Gjykatën mbretërore, duhet të gjykohen në gjykatën e magjistraturës në rrethanat e përshkruara me këtë akt. Dënimet të cilat gjykata mund ti marr parasysh janë ato të percaktuara në nenin 19 të Aktit të vitit 1980.

është dënim i mundshëm. Rrethanat e tjera ku do të zbatohet ky përjashtim janë të rralla dhe specifike për rastin.

(2) Në rastet pa komplikime faktike ose juridike, gjykata duhet të ketë parasysh kompetencën e saj për të shqiptuar dënimin pas një gjykimi dhe mund të ruajë juridiksionin, pavarësisht se dënimi i mundshëm mund t'i tejkalojë kompetencat e saj.

(3) Çështjet mund të gjykohen në mënyrë të bashkuara edhe kur i pandehuri është subjekt i një urdhri dënimi të pezulluar nga Gjykata Mbretërore ose Urdhëri i Komunitetit.

(4) Gjykata duhet t'u kërkojë të gjitha palëve të prononcohen nëse çështja është e përshtatshme për gjykim të shkurtuar. Në këtë rast, gjykata duhet t'u referohet udhëzimeve përfundimtare për të vlerësuar dënimin e mundshëm për veprën, në dritën e fakteve të pretenduara nga çështja e prokurorisë duke marrë parasysh të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë ato të ngritura nga mbrojtja, duke përfshirë çdo zbutje personale të cilës mbrojtja dëshiron t'i referohet. Kur gjykata vendos se çështja është e përshtatshme për tu trajtuar në gjykatën e magistraturës, njëkohësisht ajo paralajmëron të pandehurin se të gjitha opsionet e dënimit mbeten të hapura dhe nëse i pandehuri pranon një gjykim të shkurtuar dhe dënohet nga gjykata ose pranon fajësinë mund të dërgohet në Gjykatën mbretërore për dënim.

Seksioni 11.1 zbatohet për procedurat në Gjykatën e mbretërore sipas shtojcës 17 të Aktit për Krimet dhe Gjykatat 2013. Sipas kësaj '**marrëveshje**' do të thotë, marrëveshje për **shtyrje (pezullim) të ndjekjes** penale sipas paragrafit 1 të kësaj Shtojce. '**Prokuror**' do të thotë, një prokuror i caktuar nga ose sipas paragrafit 3 të kësaj Shtese dhe "**I pandehur**" nënkupton ortakërinë ose shoqatën, me të cilën prokurori propozon të lidh ose lidh një marrëveshje.

Sipas Shtojcës 17 të Ligjit për Krimet dhe Gjykatat 2013, një prokuror i caktuar mund të bëjë **marrëveshje për shtyrje të ndjekjes penale** me një të pandehur, të cilin prokurori po shqyrton ta ndjekë penalisht për një shkelje ose vepra të renditura në atë listë. Sipas një marrëveshje të tillë i pandehuri pranon të respektojë kushtet e saj ndërsa prokurori pajtohet që Gjykata mbretërore të miratojë ato kushte. Në atë rast prokurori do të dorëzojë propozim -aktakuzë që e ngarkon të pandehurin për veprën penale ose për veprat objekt të marrëveshjes. Nëse arrihet marrëveshja **ndjekja penale do të pezullohet** dhe ky pezullim nuk mund të hiqet gjatë kohës që marrëveshja është në fuqi, që don të thotë se **askush nuk mund ta ndjekë penalisht të pandehurin** për veprën ose veprat e akuzuara gjatë kohës që marrëveshja është në fuqi, ose pas skadimit të saj, nëse i pandehuri e respekton atë. Kjo paraqet një moratorium të ndjekjes penale deri sa është në fuqi kjo marrëveshje<sup>53</sup>. Me propozim të prokurorit publik gjykata vendos nëse i pandehuri i ka përmbushur kushtet e marrëveshjes dhe egziston mundësia që gjykata ta shfuqizojë marrëveshjen (Seksioni 11.2).

Seksioni 11.3 parshikon që prokurori publik ti propozojë gjykatës të miratojë propozimin për të lidhur marrëveshjen. Për këtë prokurori duhet të bëjë aplikim me shkrim pas fillimit të negociatave ndërmjet palëve, por përpara se të zgjidhen kushtet e

---

<sup>53</sup> Kodi për prokurorët i nxjerrë sipas paragrafit 6 të kësaj Shtojce përmban udhëzime për ushtrimin e funksioneve të ndjekjes penale në lidhje me një marrëveshje të shtyrë të ndjekjes penale.

marrëveshjes dhe të dorëzojë aplikacionin gjykatës dhe të pandehurit. Propozim – marrëveshja (aline 3) përmban palët e marrëveshjes, aktakuzën që përmban kualifikimin e veprës penale, përshkrimin i veprës penale përfshi edhe dëmin material – financiar, informacione – karakteristika që kanë të bëjnë me të akuzuarin me rëndësi për përcaktimin e sanksionit, datën e skadimit të marrëveshjes, kushtet e marrëveshjes të detajuara, ndëshkimi monetar që duhet ta paguaj i pandehuri dhe koha, kompenzimi, identiteti i marrësit të pagesës dhe koha e pagesës, dorrëzimin e përfitimeve tjera financiare nga i pandehuri, marrëveshja që do të bëhet për menaxhimin e biznesit të pandehurit, bashkëpunimi i kërkuar nga i pandehuri në çdo hetim që lidhet me veprën ose shkeljet, veprime të tjera të kërkuara nga i pandehuri, marrëveshje për të monitoruar respektimin e afatit nga i pandehuri, pasojat e dështimit të pandehurit për të respektuar një kusht, shpenzimet e ndjekjes penale që duhen paguar nga i pandehuri dhe kohën brenda së cilës duhet të paguhet këto shpenzime.

Çdo udhëzues dënimi ose rast që zbatohet, përmban pëlqim me shkrim nga i pandehuri për propozimin dhe shpjegon pse hyrja në marrëveshje është në interes të drejtësisë. Kushtet e propozuara në marrëveshje duhet jenë të drejta, të arsyeshme dhe proporcionale. Nëse deklarata e propozuar në lidhje me faktet përfshin pohime që i pandehuri nuk i pranon duhet të specifikohen faktet që nuk pranohen dhe të shpjegohet pse kjo është e parëndësishme për qëllimet e propozimit për të lidhur një marrëveshje.

Seksioni 11.4 parashikon, **miratimin e kushteve** të një marrëveshje kur gjykata ka miratuar një propozim për të lidhur një marrëveshje për një kërkesë sipas rregullit 11.3 dhe prokurori dëshiron që gjykata të miratojë kushtet e marrëveshjes. Aplikimit i bashkëngjitet marrëveshja dhe sqarim se në çfarë aspekti kanë ndryshuar kushtet e marrëveshjes nga ato të propozuara në aplikim sipas rregullit 11.3. Pastaj, përmban pëlqim me shkrim të pandehurit në marrëveshje, shpjegim pse marrëveshja është në interes të drejtësisë, se kushtet e marrëveshjes janë të drejta dhe proporcionale. Njëkohësisht i bashkëngjitet edhe një propozim-akuzë për veprën penale ose për veprat objekt të marrëveshjes.

**Nëse i pandehuri nuk u përmbahet kushteve të marrëveshjes, pasi që ajo të mirratohet nga gjykata**, prokurori publik mund të bëjë aplikim për shkelje të marrëveshjes (Seksioni 11.5). Me këtë aplikim prokurori është i bindur se i pandehuri nuk i ka përmbushur kushtet e marrëveshjes dhe dëshiron që gjykatësi të vendosë për këtë.

**Nëse gjykata i vërteton këto pohime do të shfuqizojë marrëveshjen**, ose do ti ftoj palët të bien dakord për propozimet për të korrigjuar atë dështim. Aplikimi duhet të specifikojë çdo aspekt për të cilin prokurori beson se i pandehuri nuk ka përmbushur kushtet e marrëveshjes, dhe të shpjegojë arsyet e pretendimeve të tija dhe të bashkëngjitet nga një kopje të çdo dokumenti që përmban prova në të cilat mbështet prokurori. Si rezultat i kësaj kompetence të prokurorit (në seksionin 11.6), është parashikuar mundësia për miratimin e ndryshimit të kushteve të marrëveshjes, kur për këtë janë dakord palët. Kjo mund të bëhet në dy situata: Atëherë kur në një kërkesë sipas Seksionit 11.5 gjykata i ka ftuar ata ta bëjnë këtë ose kur ndryshimi i marrëveshjes është i nevojshëm për të shmangur dështimin e të pandehurit për të përmbushur kushtet e saj, në rrethana që nuk ishin dhe nuk mund të ishin parashikuar nga asnjëra palë në kohën kur u bë marrëveshja. Seksioni 11.7 parashikon

**mundësinë për heqjen e pezullimit të ndjekjes penale**, kur gjykata përfundon një marrëveshje përpara datës së skadimit të saj dhe prokurori kërkon që gjykata<sup>54</sup> të heqë pezullimin e ndjekjes penale që zbatohet kur gjykata miratoi kushtet e marrëveshjes. Gjkata mund të shkurtojë ose zgjas afatin kohorë. Pala që dëshiron zgjatje të kohës duhet gjatë dorëzimit të aplikacionit të shpjegojë vonesën.

Për të **pandehurit nën 18 vjeç**, aplikohet Seksioni 24.1 që zbatohet në gjykatën e magjistraturës, kur gjykata gjykon një çështje ose i pandehuri pranon fajësinë<sup>55</sup>. Kompetencat e gjykatës varen nga klasifikimi i veprës penale.

Për trajtimin penal juridik të kësaj kategorie aplikohen procedura dhe institute të veçanta penal juridike. Sipas nenit 45 të Ligjit për Fëmijët dhe të Rinj 1933 dhe sipas Rregullave të Gjykatësve të Paqes 2016, gjykatën për të rinjë e përbëjnë gjykatës për të rinj antëtarë të asja gjykate. Seksioni 59 i Aktit për Fëmijët dhe të Rinjtë 1933 kërkon që shprehjet “dënim” dhe i “dënuar” të mos përdoren nga gjykata e magjistraturës, që merret me një të pandehur nën 18 vjeç. Referenca legjislative për një të pandehur që është dënuar dhe dënim i tij, duhet të lexohet si një i pandehur që është shpallur fajtor për një vepër, një shpallje fajësie ose një urdhër të dhënë për konstatimin e fajësisë, këtë duke pasur parasysh pozitën specifike të personave nën 18 vjeç.

I akuzuari nën 18 vjet mund të deklarohet se nuk është fajtor ose nuk ka paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar (për pranimin e fajësisë - Seksioni 24.3). Nëse në një rast të mëparshëm është bërë deklarimi i pafajësisë, këshilltari ligjor i gjykatësve ose gjykata duhet t'i kërkojë të pandehurit ta konfirmojë atë. Ndërsa procedurën për pranimin e fajësisë e parashikon rregulli 24.7. Ky rregull zbatohet nëse i pandehuri pranon fajësinë, ndërsa gjykata është e bindur se pranimi i fajësisë paraqet një pranim të qartë të fajit. Në këtë rast gjykata mund ta dënojë të pandehurin pa marrë prova.

**Deklarimi i fajësisë me shkrim** është një rregull i veçantë (24.8) dhe zbatohet kur vepra penale e pretenduar mund të gjykohet vetëm në gjykatën e magjistraturës dhe nuk është e specifikuar në Seksionin 12 (a) të Aktit të Gjykatave të Magjistraturës 1980(30). Gjithashtu i pandehuri është të **paktën 16 vjeç** ndërsa prokurori i ka dërguar të pandehurit thirrje ose kërkesë, materijalin mbi të cilin i mbështet faktet, materijalet që përmbajnë informacione të rëndësishme për dënimin, njohtim se zhvillohet një procedurë e tillë dhe një njohtim drejtuar të pandehurit nëse ai dëshiron ta pranojë fajin pa marrë pjesë në gjykatë. **I pandehuri që dëshiron të pranojë fajin pa marrë pjesë në gjykatë**, duhet që përpara datës së seancës të përcaktuar në thirrje ose në kërkesë t'i dorëzojë zyrtarit të gjykatës një njohtim për pranimin e fajit i cili përmban çdo pretendim që gjykata duhet ta marrë parasysh, dhe një deklaratë të pasurisë së pandehurit dhe rethana tjera financiare. **I pandehuri që dëshiron të tërheqë një njoftim** të tillë, duhet të njoftojë me shkrim nëpunësin e gjykatës përpara datës së seancës. E drejta dhe procedura për tërheqjen e pranimit të fajit parashikohet në rregullin 24.10. Ky rregull zbatohet kur i pandehuri dëshiron të tërheq pranimin e fajësisë. Për ta bërë këtë, i pandehuri duhet të aplikojë sa më shpejt që të jetë e

<sup>54</sup> Seksioni 11.11 pashikon kompetenca e gjykatës për të ndryshuar kërkesat sipas kësaj pjese

<sup>55</sup> Për procedura për personat e rinj, shih, Altin Shegani, E drejta penale e krahasuar, Tiranë 2002, fq.182

mundur, pasi të jetë bërë i vetëdijshëm për arsyet dhe para se të shqiptohet dënimi. Me përjashtim të rasteve kur gjykata urdhëron ndryshe, kërkesën duhet ta dorëzojë i pandehuri me shkrim. Aplikimi duhet të shpjegojë pse do të ishte e pa drejtë të mos lejohej të tërhiqet pranimi i fajësisë, duke u thirur në dëshmitarë dhe prova tjera për veprën penale<sup>56</sup>.

## **2.2 Panimi i fajit në procedure penale te sistemet juridike kontinentale.**

### **2.2.1 Gjermania.**

Në Gjermani një kohë të gjatë është zhvilluar debat, se a duhet të ju mundësohet palëve në procedurë penale të kontraktojnë ose jo me qëllim të përshpejtimit të procedurave, duke pasur parasysh **parimin e nevojës së verifikimit të fakteve dhe parimin e hulumtimit të së vërtetës materijale.**

Hapat e para janë bërë me novelën e vitit 1975 me aplikimin e institutit penalo juridik, ndërprerje të **ndjekjes penale me kusht**, për veprat penale të lehta (§ 153a StPO)<sup>57</sup>. Më vonë vijuan disa përpjekje tjera, por reforma e vitit 2009 e mundësoi marrëveshjen në procedurë penale. Në këtë kontekst duhet të theksohet se procedura penale në Gjermani kryesisht është e rregulluar me Ligjin për procedurë penale të viti 1877, i cili është ndëruar dhe plotësuar disa herë.

Ligji për procedurë penale i Gjermanisë ka një strukturë specifike. Pjesen e parë e përbëjnë rregullat e përgjithshme, pjesa e dytë përmban procedurën e shkallës së parë dhe përcillet rrjedha kronologjike e procedurës penale nga fillimi i hetuesisë.

Procedura e shkallës së parë në Ligjin për procedurë penale ndahet në tre faza: procedura paraprake (neni 151-177); inter procedura (nga neni 198-211) dhe shqyrtim kryesorë (nga neni 213-295). Kaptina e tretë mban titullin mjetet ankimore (nga neni 296-358). Përsëritja e procedurës e përbën kaptinën e katërt. Pjesmarja e të dëmtuarit në procedurë e përbën kaptinën e pestë. Kaptina e gjashtë përmban llojet e veçanta të procedurave penale me theks të veçanët mbi procedurën e shkurtuar (417-420). Procedura e shkurtuar mund të zhvillohet para gjykatësit dhe këshillit me gjykatës porotë, me kërkesë të prokurorit publik dhe në ata raste gjendja faktike duhet të jetë e thjeshtë dhe më e qartë. Në këto procedura nuk mund të shqiptohet dënim me burg më i lartë se 1 vit. Kaptina e shtatë ka të bëjë me egzekutimin e sanksioneve, ndërsa e teta përmban norma për shfrytëzimin e informatave për qëllime jashtë procedurale.<sup>58</sup>

---

<sup>56</sup> The Criminal Procedure Rules 2020, UK Statutory Instruments 2020 No, 759 (L. 19), <https://www.legislation.gov.uk/uksi/2020/759/contents/made>

<sup>57</sup> Shih, Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34, fq.166.

<sup>58</sup> Закон за кривична постапка на Сојузна Република Германија, 7 prill 1987, Gazeta zyrtare federale I, fq.1074 ndërimi 16 korik 2007 Gazeta zyrtare federale I fq. 1327, ИПЗ – Македонија, 2009 , fq. xvi -xix

Ligji i procedurës penale nga miratimi i tij i është nënshtruar shumë novelave me të cilat rregullohen institute të veçanta, me theks mbi parimet themelore, pozicionin e palëve dhe aspekte tjera. Në fillim duhet ta notojmë të ashtuquajturën Reformë të vogël të vitit 1964, pastaj atë të vitit 1968 dhe viteve 1972, 1975, si dhe novelat e mëvonshme. Me Ligjin për lehtësimin e përkujdesjes për drejtësi nga 11.01.1993 viti, përsëri zgjërohen mundësitë prokurorit publik për ndërprerjen e procedurës penale<sup>59</sup>.

Në Ligjet dhe literaturën Gjermane, deri në shkurt dhe mars të viti 2008 mund ta hasim edhe kontratën në procedurë penale në mes organeve për ndjekje penale dhe të akuzuarit, më qëllim që të arrihet fundi i procedurës paraprakisht të kontraktuar. Kështu, kontrata sot konsiderohet si institut i pavarur i së drejtës penale procedurale gjermane i cili nuk mendohet të hudhet nga praktika pa dallim kritikave të mëdha.

Kontrata (marrëveshja) përmban premtimin për zvogëlimin e dënimit nga gjykata përkundër deklaratimit të pranimit të plotë ose pjesërisht të fajit nga i akuzuari. Te situatat faktike të komplikuar, ndikimi për përshpejtim të procedurës vlerësohet në mënyrë të veçantë. Mirëpo nuk duhet të injorohet fakti, se kjo formë e procedurës **“praeter legem”** – parçialisht dhe gjithashtu **“contra legem”** (kundërligjore) – tejkalon përcaktimin e parimit të nevojës së verifikimit të fakteve dhe parimin e hulumtimit të së vërtetës materijale, dhe për atë qëllim është hudhur kjo bindje në pajtueshmëri me parimin e shtetit juridik. Kontrata gjithashtu në vete përmbante një rrisht të madh për pjesmarësit në procedurë dhe mu për atë kërkohej një ligj, njëkohësisht duke u paraqitur propozime të ndryshme që diskutoheshin<sup>60</sup>.

Në këtë periudhë egzistojnë dilema praktike dhe teorike të shprehura nëpërmjet parimeve ligjore bazë. Kundërshtarët e marrëveshjes prokurorin dhe të akuzuarin edhe më tej e konsiderojnë si objekt të procedurës, para se gjithash në situata kur prokurori publik nuk i përmbahet premtimit. Mosmbajtja e premtimit vëndohet në kontekst të kritikave për gjykim të drejtë, për shkak të shkatërrimit të besimit të fituar te adresati. Në këtë kontekst vëndohet edhe cenimi i parimit të ligjshmërisë (legalitetit), atëherë kur apstinimi nga kompetenca gjyqësore penale e vërtetuar në rast individual, ndërlidhet me qasjen e organeve për ndjekje penale. Diskutabile është kur jashtë kufijve të parimit të oportunitetit (neni 153), parashikohen pasoja juridike për vepra penale të rënda, të cilat janë në dis-harmoni me kundërshtimin kundër aktakuzës<sup>61</sup>.

Përveç kësaj sipas teoreticientëve gjerman, me këtë institut penalo juridik vihet në pikëpyetje edhe i ashtuquajturi **“parimi i hetuesisë gjyqësore”**, në mënyrë që ka rezik që gjykata të bazohet te pranimi i fajit, a nga ana tjetër edhe më tutje egziston dyshim për kryerjen e veprës penale dhe fajin e të akuzuarit me qëllim që të evitohet nxjerja e dëshmive. Më këtë çënohet edhe obligimi i gjykatës për arsyetimin e vendimit<sup>62</sup>. Gjithashtu

---

<sup>59</sup> Njësoj fq.xxiii

<sup>60</sup> Д-р Вернер Бојлке, Закон за кривична кривична постапка, 2009 fq. .251-252.

<sup>61</sup> Д-р Вернер Бојлке, Закон за кривична кривична постапка, 2009 fq. 253

<sup>62</sup> Ibid,

kjo mënyrë e veprimit, mund të jetë në kontraditë me parimin e ndërtimit të lirë të mendimit gjyqësorë (neni 261 LPP). Autori konsideron se aplikimi i kontratës jashtë shqyrtimit kryesorë mban rezikun që të cënohen të drejtat për pjesmarje dhe bashkëveprimet, të pjesmarësve në procedurë penale, veçanërisht kur të gjithë pjesmarësit në procedurë nuk janë përfshirë në marrëveshje.

Pika nisëse e një marrëveshje është supozimi për fajin e të akuzuarit, kështu që ai është nën presion ta inkriminojë vetëveten. Në këtë situatë kemi cënimin e parimit **prezumim i pafajësisë, parimin nemo-tenetur dhe parimin in dubio pro reo**. Në vazhdim, nuk është e qartë nëse pranimi i fajit nga i akuzuari është i dobishëm apo ai rrjedh si rezultat i presionit ndaj tij, për gadishmërinë për bashkpuni sipas nenit 136-a i LPP. Në fund egziston dyshim se me kontratë në procedurë penale, mund të vijë në shprehje anshmëria sepse gjykatësi nëpërmjet kontratës, lehtësisht bëhet i anshëm dhe nuk mund të krijojë fotografi objektive.

Ky konfrontim praktik dhe teorik që zhvillohet në kuadër të parimeve themelore dhe instituteve të ndryshme të Ligjit, debaton çështje me relevancë për të drejtat dhe garancitë minimale të akuzuatve që i nënshtrohen një poçesi të tillë siç është marrëveshja, por edhe pozicionin e prokurorisë, përfitimet procesuale të palëve, gjithashtu edhe rolin dhe pozicionin e gjykatës në këtë drejtim, si dhe komunikimi me palët gjatë dhe jashtë shqyrtimit kryesorë në kontekst të kontratës.

Theks të veçantë vihet mbi kundërshtimin e kontratës në rast se organet e ndjekjes nuk i përmbahen premtimit dhe në këtë rast kritikohet cënimi i parimit për gjykim të drejtë dhe fer, për shkak të cënimit të besimit të fituar. Gjatë egzistimit të njohurive të reja dhe gjatë shpalljes së fakteve relevante ose aspekte juridike, të cilat kanë egzistuar gjatë krijimit të marrëveshjes për aktgjykimin gjykata mund të tërhiqet nga premtimi i tij, por në këtë rast duhet të jep rekomandim juridik sipas nenin 265 nga normat e proceurës penale.

Gjatë veprimit prakti, janë zhilluar disa parime që kanë të bëjnë me pranimin e fajit në procedurë penale, siç janë: komunikimi i gjykatës me pjesmarësit prosedural jashtë shqyrtimit kryesorë; zbutja e dënimit në rast të pranimit të fajit; parimi i ashtuquajtur “tregëti me drejësi” që don të thotë se gjykata nuk mund të jep premtim të përhershëm për lartësinë e dënimit; të akuzuarit ti mundësohen shërbime të cilat janë në raport real me kundërshtërbimin e gjykatës dhe parime të tjera që meren si bazë për funksionimin praktik në këta rethana normative. Egziston praktikë relevante që ka të bëjë edhe me situatat kur kemi kontraktim të pasuksesshëm si dhe situata kur i akuzuari apstenon nga mjetet juridike si lëndë e marrëveshjes për aktgjykim<sup>63</sup>. Aspektet e lartëpërmendura flasin për një praktikë 30 vjeçare të marrëveshjes edhe pse ajo nuk ishte e rregulluar me ligj, viteve të 70 të shekullit XX.

---

<sup>63</sup> Shih, Д-р Вернер Бојлке, Закон за кривична кривична постапка, 2009 fq. 254-258.

Në vitin 1975 është aplikuar instituti **ndërprerje e ndjekjes penale me kusht**, që konsiderohet si një pikënisje e marrëveshjes në procedurë penale<sup>64</sup>. Si shkas për aplikimin e marrëveshjes në procedure penale gjermane, potencohet rritja e vazhdueshme e numrit të veprave penale dhe nevoja gjegjësisht dëshira e prokurorisë për një zgjedhje më të shpejtë dhe ekonomike.

Kjo tendencë hapi debatin për legjitimitetin e marrëveshjes deri atëherë të mbajtur në fshehtësi (deri në vitin 1982), kur avokati i njohur Gjerman Dahs botoi një artikull anonim me titullin “Detlef Deal”, në të cilin në mënyrë të detajuar është përshkruar praktika e zhvillimit të kontraktiveve joformale deri atëherë të panjohura për opinionin. Kjo nxiti një debat të ashpër për ligjshmërinë dhe moralitetin e bisedimeve në mes gjykatës, të akuzuarit dhe prokurorisë. Në periudhën mes viteve 1986-1987 një hulumtim nxjer në pah se 30% e rasteve penale janë zgjedhur nëpërmjet **marrëveshjeve joformale**.

Ky institut penalo juridik gjen mbështetjen ligjore shumë më vonë, në vitin 2009<sup>65</sup>. Këta marrëveshje joformale, për dallim nga sistemi amerikan janë zhvilluar me **pjesëmarjen e palëve dhe gjykatës. Këtu gjykatësi ka rol aktiv, por nuk mund të detyrojë të akuzuarin të pranojë fajin për të fituar favore**. Edhe pse këta biseda janë joformale, në brendi përmbajnë pranimin e fajit. Këta kontraktive zakonisht inicohen nga mbrojtësi i të akuzuarit dhe mund të fillojnë para ngritjes së aktakuzës, në relacion i akuzuar prokurorë publik. **Ndërsa gjatë shqyrtimit kryesorë edhe gjykatësi mund të ngre çështjen e pranimit të fajit**.

Pas mbarimit të bisedimeve, marrëveshja e arritur konstatohet në procesverbal. Me rëndësi është të potencohet se në marrëveshjen **nuk mund të identifikohet dënimi konkret** që duhet ta merr i akuzuari. Para se të shpall fajtor me aktgjykim, gjykatësi duhet në seancë publike të vërtetojë nëse pranimi është i vullnetshëm dhe autentik. Duke u nisur nga parimi i kërkimit të së vërtetës materijale, gjykata ka të drejtë të kërkojë që pranimi i të akuzuarit të mbulohet edhe me ndonjë dëshmi tjetër.

Pas shpalljes së artikullit të avokatit Dahs dhe eskalimit të debatit teorik dhe praktik në lidhje me këtë institut penalo juridik, në vitin 2005 Gjykata supreme Gjermane mori vendim në të cilin e ftoi ligjdhënësin të kuptojë seriozitetin e problemit dhe të manifestoj seriozitet, në përpilimin e propozim ligjit me të cilin do të rregullohet marrëveshja mes palëve dhe kështu do ti jepet fund pasigurisë juridike. Pas shumë iniciativave Parlamenti Gjerman në vitin 2009, miratoi Ligjin për marrëveshje në prokurorë penale<sup>66</sup>, me të cilin parashihet mundësia e kontraktimit në mes gjykatës, të akuzuarit dhe prokurorit publik, si rezultat i së cilës mund të vijë **deri tek zbutja e dënimit**.

Baza e këtij rregullimi ligjor është neni 257, sipas të cilit gjykata mund të kontaktojë me pjesëmarësit në procedurë penale “për mbarrëvajtjen e mëtutjeshme dhe rezultatet e

---

<sup>64</sup> Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34, fq.166.

<sup>65</sup> Ibid

<sup>66</sup> BGH, 3.3. 2005 - GSSt 1/04 : \* Absprachen im Strafprozess - Wirksamkeit eines Rechtsmittelverzichts, Neue Juristische Wochenschrift, no.20/2005.

procedurës”, si dhe për pasojat juridike që do ti gjykoj gjykatësi, poashtu edhe masat tjera që kanë të bëjnë me sjelljen në procedurale të palëve.

**Gjykata mund të jep propozim, ku do të theksohet kufiri më i ulët dhe ai më i lartë i sanksionit. Ndërsa deri te marrëveshja vjen atëherë kur prokurori publik do ta pranojë propozimin e gjykatës.** I akuzuari duhet të informohet për pasojat juridike<sup>67</sup>. Sipas këtij ligji gjykata ka rol aktiv në bërjen e marrëveshjes me kompetenca konkrete procesuale që në njërin anë garantojnë të drejtat e të akuzuarit, ndërsa në anën tjetër janë garantë të interesit publik, të cilin e përfaqëson prokurori publik.

**Sipas ligjit marrëveshja mund të arrihet në cilën do fazë to procedurës penale.** Bazë e marrëveshjes është pranimi i fajit nga i akuzuari që mund ti sjell favore konkrete në procedurë penale. Ligji i ri e pamundëson apstenimin paraprak të akuzuarit nga e drejta e ankimit dhe mjeteve tjera juridike, pas bërjes së marrëveshjes.

### 2.2.2 Italia

Reforma e procedurës penale e vitit 1989 promovoi risi radikale në procedurën penale Italiane, veçanërisht në procedurën paraprake në të cilën rol kryesorë deri atëherë kishte gjykatësi hetues, karakteristikë e sistemit Françez. Përveç instituteve tjera me këtë reformë pranohet negociimi në procedurë penale për fajësinë dhe sanksionin sipas modelit amerikan – plea bargaining. Italia bëhet një nga vendet e para e cila implementon elemente të ndryshme akuzatore në procedurën e saj penale. Një tiparë kryesorë i sistemit të drejtësisë Italiane është fakti se prokurorët publik janë pjesë e sistemit gjyqësorë jo e atij egzekutiv<sup>68</sup>.

Një nga arsyt kryesore për miratimin e Ligjit të ri për procedurë penale ish përshpejtimi i procedurës penale deri atëherë shumë i ngadalsuar. Më këtë ligj u miratuan institute të reja për përshpejtimin e procedurës dhe zmadhimin e efikasitetit. Kështu në sistemin e sotëm Italian egzistojnë: 1) alternativa të dënimeve në situata kur i akuzuari pendohet 2) marrëveshje të palëve për llojin e procedurës: gjykim i shkurtuar (giudizio abbreviato), urdhëresa dënuese (decreto penale), 3) aplikimi i dënimit me kërkesë të palëve (l'applicazione della pena su richiesta delle parti)<sup>69</sup>. Alternativë e parë e gjykimit është “procedimento për dekret penal” ose procedimet me dekret penal, që në fakt është një ofertë e njëanshme nga prokurori publik për të zgjedhur çështjen me një gjobë të zbritur. I

---

<sup>67</sup> Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34, fq.169.

<sup>68</sup> Theme: Reform, Change Management, Criminal Procedure And Public Prosecution Reform In Italy: A Flash Back By Marco Fabri, Senior Researcher - Research Institute on Judicial Systems, National Research Council, Bologna, Italy, file:///C:/Users/user/Downloads/Criminal\_Procedure\_and\_Public\_Prosecution\_Reform\_i.pdf, fq.1

<sup>69</sup> William T. Pizzit and Luca Marafiotif, The New Italian Code of Criminal Procedure: The Difficulties of Building an Adversarial Trial System on a Civil Law Foundation, The Yale Journal of International Law Volume 17, Number 1, Winter 1992, <https://digitalcommons.law.yale.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1585&context=yjil>, fq.21.

pandehuri është i lirë të pranojë ose refuzojë ofertën. Kjo mundësi është në dispozicion vetëm për krime të lehta.

Në raste të tilla, prokurori publik mund të kërkojë nga gjyqtari dënimin e drejtpërdrejtë të të pandehurit, duke rezultuar në një ulje prej pesëdhjetë për qind të gjobës. Nuk ka seancë paraprake por shqiptim të drejtpërdrejtë të e gjobës. Nëse i pandehuri është i pakënaqur me gjobë ose dëshiron një gjykim për arsye të tjera, ai ka të drejtë të kërkojë gjykim në afat brenda pesëmbëdhjetë ditëve, pas vendosjes së gjobës nga gjyqtari. Një dënim me dekret penal nuk është një procedurë e re në Itali. Sipas Kodit të vjetër këtë institut e përdorin gjykatat më të ulëta që gjykojnë krime të vogla të dënueshme me gjobë.

Risitë e Kodit të ri përfshijnë kërkesën që prokurori të iniciojë dekretin penal dhe fiks pesëdhjetë për qind zbritje në gjobë. Edhe pse dekreti penal mund të përdoret vetëm për çështje të lehta penale ai është i rëndësishëm për të gjithë sistemin Italian si një mekanizëm për të shpejt zgjidhjen e këtyre rasteve<sup>70</sup>.

Teoreticentët William T. Pizzit and Luca Marafiotif janë të mendimit se edhe Italia ka miratuar një formë të butë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në Kodin e ri.

Nga tre procedurat konsensuale të cilat i njeh Codi Italian për procedurë penale, **aplikimi i dënimit me kërkesë të palëve është më i aplikuari dhe i preferuari**, dhe paraqet një shembull klasik i implementimit të elementeve akuzatore në procedurë penale, të tipit të përzier. Sipas kësaj procedure, para se të fillojë gjykimi prokurori publik dhe mbrojtësi mund të merren vesh për dënimin që do të shqiptohet dhe kërkojnë nga gjyqtari që ta shqiptojë të njejtën. Dënimi mund të ulet deri në një të tretën. Prokurorët mund të bëjnë negociata për ta shtyrë dënim deri në dy vjet. Instituti i aplikimi të dënimit me kërkesë të palëve joformalisht emërohet si “patteggiamento” dhe është parashikuar në dy modalitete të cilat mes veti dallohen duke unë nisur nga fakti se për cilën kategori të kryerësve të veprave penale ka të bëjë<sup>71</sup>.

Forma e parë e dënimit me kërkesë të palëve mund të aplikohet nëse bëhet fjalë për vepër penale për të cilën dënimi i parashikuar i zvogëluar për një të tretën nuk kalon dënimin 2 vjet burg, edhe atë si dënim i bashkuar ose së bashku me dënimin në të holla.

Forma tjetër aplikohet ka të bëjë me vepra penale për të cilat dënimi i parashikuar i zvogëluar për 1/3, sjell deri te dënimi me burg nga 2 deri 5 vite burg<sup>72</sup>.

**Nëse negociatat janë pozitive atëherë palët së bashku do të paraqesin kërkesë me shkrim teri tek gjykata për të shqiptuar dënimin me burg të zvogëluar.** Kërkesën mund ta paraqesin palët së bashku ose njëra palë me pajtueshmëri të palës tjetër. Në rastin e parë egziston interes i përbashkët (pajtueshmëria e të akuzuarit ose të pandehurit) dhe nuk mbahet shqyrtim kryesorë. Nga ana tjetër nësa kërkesën e paraqet vetëm i akuzuari, do të

---

<sup>70</sup> Ibid,

<sup>71</sup> Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34, fq.175.

<sup>72</sup> Nicola Canestrini Useful Information Italian criminal trial, <https://canestrinilex.com/en/readings/trial/>, 2018.

vijë deri te mbarimi i procedurës vetëm nëse prokurori publik jep në mënyrë plotësuese pajtueshmëri. Nëse prokurori publik nuk e bën atë procedura kalon nëpër të gjitha fazat e veprimit, por gjykatësi mund të pranojë kërkesën e të akuzuarit që vullnetarisht ti bindet dënimit. Në ato raste gjykatësi do të përmbush kërkesën e të akuzuarit nëse vërteton se vendimi i prokurorit që mos ti bashkanjgjetet marrëveshjes ka qenë i pa bazë dhe deri te mos bërja e marrëveshjes nuk ka ardhur me faj të akuzuarit.

Në këtë mënyrë **është venduar kontrolli gjyqësorë** ndaj vendimeve të prokurorit që të mund të pengohet (menjanohet) diskriminimi dhe mbrojtja e parimit të barabarësisë të të gjithë qytetarëve para ligjit gjegjësisht veprim i paanshëm i prokurorit.

Pas paraqitjes së kërkesës gjykatësi do të konvokojë seancë në të cilën do të vendos për kërkesën, në të cilën duhet të kontrollojë egzistimin e parakushteve ligjore për të vendosur për kërkesën. Pas egzaminimeve formale, gjykatësi do të kontrollojë kualifikimin e veprës penale, veçoritë që i kanë paraqitur palët dhe përshtatshmërinë e dënimit të propozuar dhe pastaj do të shqiptojë dënimin me aktgjykim, duke theksuar se vendimi është mirratuar me kërkesë të palët. Nëse gjykatësi konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e parashikuara do të refuzojë marrëveshjen e palëve për shkak të mos egzistimit të kushteve ligjore ose nëse gjykatësi konsideron se dënimi i propozuar është joadekuat, mund të miratojë akgjykim lirues nëse vepra penale nuk egziston gjegjësisht nëse mungon ndonji parakusht procesual. Nëse gjykata ka refuzuar marrëveshjen e palëve atëherë do të konvokojë shqyrtim kryesorë, duke pasur parasysh se nuk mund pa seancë kryesore të shqiptojë dënim të ndryshëm nga ai që është kontraktuar nga palët<sup>73</sup>. Nëse një gjyqtar pranon propozimin e prokurorit dhe të pandehurit, vendimi mund **të apelohe**t vetëm përpara Corte di Cassazione, gjykata më e lartë italiane (e cila vendos vetëm për procedurën dhe interpretimin e drejtë të ligjit).

**Gjykatësi ka një rol specifik në modelin Italian.** Për dallim nga modeli gjerman ai është pasiv dhe nuk ka ndikim tek palët gjatë kontraktimit. Më fjalë të tjera, gjykatësi fiton statusin e pjesëmarrësit aktiv pasi që palët të kenë bërë marrëveshjen në të cilin kanë formuluar kërkesën e tyre për shqiptimin e dënimi të caktuar<sup>74</sup>.

Edhe pse negociatat për pranimin e fajësisë të modelit Italian mund të duken të ngjashme me pranimin e fajësisë së SHBA pazarllëkut ose patteggiamento, dallon nga gjykatat amerikane<sup>75</sup>. Në sistemin italian prokuroria publike dhe i pandehuri nuk bëjnë pazare për natyrën e krimit për të cilin i pandehuri do ta pranojë fajin. Qëllimi i Kodit Italian është të bëjë ulje dënimi për të gjithë të pandehurit që dëshirojnë të pranojnë marrëveshjen, pa dallim nëse është apo jo prokurori dakord. Por, kjo marrëveshje pasqyron

---

<sup>73</sup> Shih, Nicola Canestrini Useful Information Italian criminal trial, <https://canestrinilex.com/en/readings/trial/>

<sup>74</sup> Ibid, fq.176

<sup>75</sup> Për rolin e Gjykatësit te modeli Italian i marrëveshjes shih: Zvonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34fq. 176.

mosbesimin tradicional të ligjit civil për diskrecionin e prokurorisë dhe angazhimin për trajtimin uniform të të pandehurve<sup>76</sup>.

Dallimi përfundimtar mes marrëveshjeve për pranimin e fajit në SHBA dhe Itali është më shumë nga forma se sa nga substanca. Varianti italian nuk përfshin asnjë pretendim aktual për tu deklaruar fajtor. Kodi italian nuk e pranon kërkesën për pranimin e fajësisë sepse hartuesit kishin frigë se pranimi i fajit do të minonte prezumimin e pafajësisë i garantuar për të gjithë të pandehurit me Kushtetutën Italiane. Fakti që një person mund të shkojë në burg deri më dy vjet pa asnjë pranim dhe as një konstatim zyrtarë të fajit, ilustron vështirësitë e Italisë konform marrëveshjes për pranimin e fajit me traditën e saj të së drejtës civile<sup>77</sup>.

Sipas, Nicola Canestrini<sup>78</sup> marrëveshje për pranimin e fajësisë (patteggiamento), kemi atëherë kur i pandehuri pretendon se dënimi që do ti jepet, do të jetë më pak se pesë vite burg. Në këtë rast ai shpërblehet me ulje dënimi dhe ka avantazhe tjera (nuk paguan harxhimet e procedurës penale). Pazaret nuk janë për akuzat, por për dënimin, i cili ulet në një të tretën.

### 2.2.3 Holanda

Në sistemin penalo juridik Hollandez mund të vërehet tendenca për zgjidhje jashtëgjyqësore të rasteve penale. Tradicionalisht në Hollandë rastet penale mund të zgjidhen jashtë gjykatës më ndihmën e të ashtuquajturit “transakcion” (transactie): **marrëveshje jashtëgjyqësore** në të cilën i dyshuari/akuzuari pajtohet për të plotësuar disa kushte (shembull të paguajë dënim në të holla ose ta kompenzojë viktimën), me qëllim që ti shmanget gjykimit. Nga kjo shihen elemente të qarta të së drejtës restorative që njihet në më shumë institute penalo juridike edhe në vendet në rajon, por jo si marrëveshje<sup>79</sup>.

Transakcioni nuk përfshin pranimin e fajit, nuk kërkon as miratim nga gjykata. **Ai është marrëveshje konsensuale në mes dy palëve për të shmangur gjykimin penal, pa u njohtuar gjykata.** Nëse oferta për marrëveshje jashtëgjyqësore refuzohet ose injorohet nga i akuzuari,

---

<sup>76</sup> William T. Pizzit and Luca Marafiotif, The New Italian Code of Criminal Procedure: The Difficulties of Building an Adversarial Trial System on a Civil Law Foundation, The Yale Journal of International Law Volume 17, Number 1, Winter 1992, <https://digitalcommons.law.yale.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1585&context=yjil>, fq.23.

<sup>77</sup> Theme: Reform, Change Management, Criminal Procedure And Public Prosecution Reform In Italy: A Flash Back By Marco Fabri, Senior Researcher - Research Institute on Judicial Systems, National Research Council, Bologna, Italy, [file:///C:/Users/user/Downloads/Criminal\\_Procedure\\_and\\_Public\\_Prosecution\\_Reform\\_i.pdf](file:///C:/Users/user/Downloads/Criminal_Procedure_and_Public_Prosecution_Reform_i.pdf), fq.12.

<sup>78</sup> Nicola Canestrini, Useful Information Italian criminal trial, <https://canestrinilex.com/en/readings/trial/>, 2018.

<sup>79</sup> Criminal proceedings and defence rights in the Netherlands, February 2014 <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Criminal-Proceedings-and-Defence-Rights-in-the-Netherlands.pdf>

prokurori publik duhet të ngre aktakuzë dhe i akuzuari të nxiret para gjykatës. Me qëllim që të shmangen stërgajtjet në zgjidhjen e çështjeve penale nga viti 2008 Prokurorija publike (Openbaar Ministrye), ka autorizim autonom të ofrojë **marrëveshje jashtëgjyqësore** të llojeve të ndryshme (jokonsensual), siç është Urdhëresa dënuese (strafbeschikking).

**Urdhëresa dënuese është vendim i njëanshëm i prokurorit publik i cili nuk kërkon konsensus** në mes prokurorit dhe të akuzuarit. Të pandehurit, prokurori publik njëanshëm mund ti shqiptijë urdhëresë dënuese pa pajtueshmëri nga ai. Me qëllim që i akuzuari ta shfrytëzojë të drejtën e tij që të gjykohet nga gjykata e pavarur dhe e paanshme, e formuar në bazë të ligjit (neni 6 i Konventës Europiane për të drejtat e njeriut), ai nuk duhet të jetë i pa interesuar ndaj Urdhëresës dënuese. Ai duhet në mënyrë aktive ta kundërshtojë Urdhëresën ndëshkuese, me atë që vetë do të inicojë procedurë. Nëse i akuzuari e injoron dënimin, Urdhëresa bëhet e plotëfuqishme pas 2 javëve dhe mund të egzekutohet nga shërbimi i prokurorit publik Hollandez. Duke pasur parasysh se Urdhëresa ndëshkuese mund të shqiptohet vetën nga prokurori publik kur egzistojnë dëshmi të mjaftueshme për veprën në fjalë, ndërsa pala tjetër nuk e kundërshton atë, (ose respekton e urdhëresën), **kjo merret si pranimit i fajit nga ana e të akuzuarit**. Si rezultat i kësaj Urdhëresa ndëshkuese do të bëhet e plotëfuqishme dhe ka status të njejtë si vendimi gjyqësorë me të cilën i akuzuari është shpallur fajtor sipas aktakuzës.

Së bashku me këta zhvillime, para një kohe prokuroria publike Hollandeze u fokusua në zhvillimin e “kartës udhëtuese”, për zgjidhje më të shpejtë të rasteve penale. Qëllimi i kësaj është mbarim i shpejtë e rasteve penale, të cilat nuk duhet të zgjidhen patjetër nga gjykata penale por atë mund ta bëjë prokuroria publike, në mënyrë jashtëgjyqësore me një kuadër të caktuar kohorë (afat sa më të shkurtër).

Në Hollandë kjo kartë udhëtuese, është e njohur si “ZSM”, me domethënie: “Zo Snel, Slim, Selectief, Simpel, Samen en Samenlevingsgericht Mogelijk”. Për këtë nuk mund të gjindet një përkthim adekuat, por ka një domethënie në kuptimin: “Të shpejta, mendjemprehta, selektive, të thjeshta, njëri me tjetrin dhe të orientuar kah shoqëria si të jetë e mundur”.

Sipas kësaj procesi është i orientuar kah zgjidhjet e shpejta e rasteve të cilat nuk kërkojnë shqyrtim nga gjykata, por shpejtësia nuk është qëllimi i vetëm. Në vend të kësaj, qëllimi oficial i procesit është të zgjidhen deliktet e shpeshta penale, të cilat kryhen në mënyrë të shpejtë, selektive, të thjeshtë dhe të orientuar kah bashkësia, duke i kushtuar vëmendje të merituar interesit të pandehurit, viktimës dhe bashkësisë. Kjo ka të bëjë më tepër për vendosjen e “fatit të të akuzuarit” në afat prej 7 ditëve pas arrestimit, mundësisht në afat më të shkurtër<sup>80</sup>.

Sistemin penalë juridik Hollandez e karakterizon parimi i ligjshmërisë. Në këtë sistem prokurori është dominus litis. Ai mund të vendosë nëse do të akuzojë të dyshuarin për një

---

<sup>80</sup> Burimi: Pauline Jacobs and Petra van Kampen - Dutch ‘ZSM Settlements’ in the Face of Procedural Justice: The Sooner the Better?  
file:///C:/Users/user/Downloads/291-754-1-PB%20(1)%20(1).pdf;https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\_id=2529959.

vepër më pak serioze, duke mos përfillur rethanat rënduese përveç kur egzistojnë prova të mjaftueshme për të ngarkuar të dyshuarin për një krim serioz. Gjyqtari në një rats të tillë s'ka asnjë kontrollë mbi përmbajtjen e aktakuzës<sup>81</sup>.

## **2.3 Aspektet rajonale të pranimit të fajit në procedurë penale.**

### **2.3.1 Republika e Kroacisë.**

Instituti marrëveshje në procedurë penale sipas përmbajtjes dhe përfshirjes, fillimisht është regulluar me LPP të Republikës së Kroacisë (2008), si një institut i ri në legjislacionin kroat. Instituti në fjalë duhet të shqyrtohet nga aspekti i transparencës së hetuesisë, obligimit për ndjekje penale kur për ate imponojnë rezultatet e hetuesisë, doktrinën e perceptcionit të jashtëm për pavarësinë dhe paanshmërinë e hetuesisë dhe gjykimit, dhe në veçanti rivlerësimin e normave për përmbajtjen dhe kuadrin e kontrollit gjyqësorë të marrëveshjes.

**Ky ligj lejon marrëveshjen për gjith veprat penale.** Sipas ligjit është e mundur që të gjykosh ndonjë person për vrasje, dhunim dhe shumë vepra tjera të rënda pa shqyrtim kryesorë, vetëm në bazë të marrëveshjes të arritur me prokurorin publik. Praktika e deritanishme ka treguar se marrëveshja për veprat më të rënda nuk aplikohet dhe një veprim i tillë do të ish në kundërshtim me funksionin publik të procedurës penale, rolit dhe funksionit të gjykatës si dhe pritshmërive të publikut. Për këtë shkak, kur është fjala për vepra të rënda penale për të cilat është përjashtuar shfrytëzimi i institutit “dëshmitarë kryesorë” (neni 39 ZUSKOK), duhet të përjashtohet secila formë e marrëveshjes ose heqjes dorë nga ndjekja penale sipas parimit të oportunitetit<sup>82</sup>.

Ligji i procedurës penale i Republikës së Kroacisë parashikon marrëveshjen për pranimin e fajit dhe dënimit në mes prokurorit dhe të akzuarit<sup>83</sup>. Kjo mundësi parashihet edhe në Ligjin për prokurori publike, kur flitet për autorizimin e prokurorit<sup>84</sup>.

Rol kyç për aplikimin e këtij instituti ka prokurori kryesorë shtetërorë, i cili në bazë të nenit 82 jep Udhëzime për aplikimin e ligjeve. Në vitin 2010 prokurori publik ka nxjerrë “Udhëzim për veprim gjatë marrëveshjes me të dyshuarin/të akzuarin, në të cilat sqarohen kushtet për pranimin e fajit dhe sanksionin. Këta udhëzime janë udhërfyës për prokurorët në kuadër të prokurorisë së përgjithshme të Kroacisë.

---

<sup>81</sup> Shih, Altin Shegani, E drejta penale e krahasuar, Tiranë 2002, fq.209.

<sup>82</sup> Dr. sc. Zlata Đurđević, Osvrt na rezultate rada radne skupine Ministarstva pravosuđa za uskladivanje zakona o kaznenom postupku Ustavom Republike Hrvatske, fq.19  
[https://www.pravo.unizg.hr/\\_download/repository/1\\_Djurjdevic.pdf](https://www.pravo.unizg.hr/_download/repository/1_Djurjdevic.pdf)

<sup>83</sup> Neni 38 alineë 4 pika 7, (NN 1152/08; 76/09; 80/11; 121/11; 91/12; 143/12;56/13; 145/13; 152/14; 70/17)

<sup>84</sup> NN 67/18 , 01.09 2018 , <https://www.zakon.hr/z/140/Zakon-o-dr%C5%Beavnom-odvjetni%C5%A1tvu>.

Procedura, fillimi, mënyra e udhëheqjes dhe lidhjen e marrëveshje për pranimit e fajit dhe sanksioni, detalisht i parashikon Ligji për procedurë penale i Republikës së Kroacisë duke filluar nga propozimi i prokurorit publik për marrëveshje si dhe aktivitet fillestare konform nenin 74 alinea 1 pika 1 - 6 të Ligjit për prokurori publike. Prokurori publik e informon të akuzuarin/mbrojtësin për planin dhe qëllimin për negociata dhe njëkohësisht përgadit shkresë zyrtare deri te Prokurori publik Shtetërorë. Nëse prokurori shtetërorë ose zavendësi i tij konsiderojnë se nuk ka kushte për marrëveshje, përgaditin shkresë zyrtarë në kuadër të shkresave të çështjes dhe do ta informojnë të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij.

**Mënyra e zhvillimit të bisedava dhe informimi për mbarëvajtjen e tyre.** Sipas dispozitave të LPP i **dëmtuari dhe viktimë kanë të drejtat e tyre të veçanta në procedurë penale. Sipas nenin 43 i Ligjit për procedurë penale<sup>85</sup> viktimë dhe i dëmtuari kanë të drejtë të jenë të informuar për të drejtat e tyre.** Me informimin e viktimës dhe të dëmtuarit mund të evitohen reagimet negative dhe njëkohësisht kjo mund të paraqet një test për reagimin e tyre të mundshëm në kuptimin, se sa viktimë ose i dëmtuari është i ndjeshëm për këtë marrëveshje.

Mënyra e zhvillimit të negociatave pasqyrohet në disa faza dhe paraqet një procedurë të detajuar të cilën duheta ta kalojnë palët dhe në fund edhe gjykata. Propozimi për fillimin e negociatave është hapi i parë që shënon fillimin e procedurës për marrëveshje për pranimit e fajit dhe dënimit. Ky propozim mund të vij nga prokurori dhe nga i akuzuari ose mbrojtja e tij. Faza tjetër është informimi i të dëmtuarit gjegjësisht viktimës që është obligim i prokurorit publik. Shënimi zyrtarë (shkresa zyrtare) për egzistimin e kushteve për marrëveshje dhe procesverbal për rrjedhën e negociatave, është aktiviteti i rradhës që ndërmer prokurori publik në pajtueshmëri me nenin 74 alinea 2 e Ligjit për prokurori publike<sup>86</sup>. Faza e ardhshme është sigurimi i avokatit mbrojtës.

Mënyra e udhëheqjes së negociatave dhe në veçanti kompetencat e prokurorit publik më detajisht janë parashikuar në Udhëzimin e Prokurori shtetërorë<sup>87</sup>, të miratuar në bazë të nenit 82 të Ligjit për prokurori shtetërorë<sup>88</sup>. Në nenin 83 të këtij Ligji potencohet se Prokurori shtetërorë miraton Udhëzim të përgjithshëm për marrëveshje me të akuzuarin, dënimit dhe masat tjera. Me këto udhëzime rregullohet mënyra e udhëheqjes së bisedimeve, forma dhe përmbajtja e marrëveshjes, mënyra e llogaritjes së zvogëlimit të dënimit që duhet të aplikohet në rastin konkret. Me urdhëresë mund të parashihen edhe rastet kur prokurorët shtetërorë nuk mund të bëjnë marrëveshje për miratim të akgjykimit në bazë të marrëveshjes me palët.

Ligji i ri i procedurës penale i Republikës së Kroacisë parashikon **mundësinë** që palët të mund të bisedojnë për kushtet e pranimit të fajit dhe marrëveshjes për sanksion (neni 360 i LPP). Ndërsa neni 38 alinea 2 pika 8 e LPP përcakton se në lëndët penale të cilat ndiqen

---

<sup>85</sup> NN 145/13, 70/17,

<sup>86</sup> Ibid,

<sup>87</sup> Prokuroria shtetërore e Republikës së Kroacisë, Nr 0-2/09, 2010.

<sup>88</sup> NN 67/2018 , 25.07.2018,

sipas pozitës zyrtare prokurori publik, **ka të drejtë dhe obligim për negocim dhe marrëveshje** më të akuzuarin për pranimin e fajit dhe sanksionit. Duke pasur parasysh se negocimi me të akuzuarin për pranimin e fajit dhe sanksionin dukshëm dallohen nga mundësitë e deritanishme për sjellje të aktgjykimit në hetuesi, në neni 75 alinea 1 të Ligjit për prokurori shtetërore është parashikuar që Prokurori kryesorë shtetërorë të jep Udhëzime për marrëveshje për sanksionin me të akuzuarin. Qëllimi i kësaj Urdhërese është transparenca që ju mundëson pjesëmarrësve në negociata të dijnë se çka mund të presin nga rrjedha e bisedave, dhe për çka është i autorizuar prokurori shtetërorë ose zavendësi i tij që negocon, gjegjësisht kur deklaratat e tij e obligojnë Prokurorinë shtetërore<sup>89</sup>.

Ligji definon edhe procedurën në rast të **ndërprerjes së negociatave**, duke definuar veprimet konkrete të paleve dhe në veçanti prokurorit publi, i cili ka për obligim gjendejn e tillë ta paraqës në shkresë zyrtare ku do të potencohen edhe shkaqet e një situate të tillë.

Marrëveshja gjithnjë ka formë të shkruar dhe përmbajtje të percaktuar me LPP. Marrëveshja përmban përshkrimin veprës penale lëndë e aktakuzës dhe kualifikimin e veprës penale.

Rëndësi të veçanë ka mënyra e llogaritjes së zbutjes së dënimit në rast se pranohet marrëveshja. Në situata kur me marrëveshjen pretendohet të arrihet shkurtimi i procedurës gjegjësisht mbrohen viktimat dhe dëshmitarët e ndjeshëm nga pasojat negative, prokurori publik ose zavendës prokurori publik është përgjegjës për politikën ndëshkuese dhe duhet të mbajë llogari për atë. Ndërsa në situata kur marrëveshja arrihet për tu mundësuar zbulimi i veprave tjera dhe kryerësve tjerë të veprave penale, prokurori publik ka interes të bëj marrëveshje edhe në kushte të marrëveshjes për sanksion në kufijtë më të ulët të tij, i cili me zbutje për atë vepër mund të aplikohet. Por sanksioni i zvogëluar nuk mund të jetë më i ulët se 2/3 nga sanksioni i pritur gjegjësisht dënimit që prokurori publik konsideron se mund të arrihet në procedurë të rregullt.

Praktika gjyqësore në Kroaci **veçon raste për të cilat nuk duhe të bëhet marrëveshje** siç janë: krimet e rënda ku kemi traumatizim të jashtëzakonshëm të viktimës ose ajo ka humbur jetën, ose kur bëhet fjalë për fëmijë dhe të mitur dhe pritet që marrëveshja të ketë ndikim negativ; lëndët për të cilat ka interes të veçantë oponenti, kur ai pret të miratohet aktgjykim për fajsi dhe marrëveshja mund të merret si favor për të akuzuarin; raste kur kemi keqpërdorime të mëdha; raste kur prokurori publik disponon me dëshmi të mjaftueshme për dëshmimin e veprës penale, ndërsa i dyshuari/akuzuari kërkon zvoglim të dukshëm të dënimit. Gjithashtu njihen edhe situta kur marrëveshja nuk është e arsyeshme<sup>90</sup>.

---

<sup>89</sup> Državno odvjetništvo Republike Hrvatske (dorh.hr).

<sup>90</sup> Shih, Alternativni kazneni postupa u politici kaznenog procesuiranja u Jugoistočnoj Europi, Bosna i Hercegovina, Parlamentarna skupština Bosne i Hercegovine, Sekretarijat/Tajništvo Zajednička služba – Istrazivački sektor, fq 17, Alternativni kazneni postupak u politici kaznenog procesuiranja\_1.pdf

Normativisht, marrëveshja në procedurë penale buron nga normat e Ligjit për procedurë penale të Republikës së Kroacisë<sup>91</sup>. Neni 64 i LPP, (NN 76/09,143/12,145/13,70/17), Kaptina VI - I akuzuari dhe mbrojtësi, alinea 1 pika 11, parasheh mundësinë që i akuzuari të **bëj marrëveshje për dënimin** dhe masat tjera sipas nenit 360 alinea 4 pika 3 e këtij Ligji. Neni 206 - C (NN 145/13, 70/17) mundëson që në rast të pajtueshmërisë së viktimës ose të dëmtuarit, prokurori shtetërorë të **anulojë ose të tërhiqet nga ndjekja** penale edhe pse egziston dyshim i arsyeshëm së është kryer veprë penale e cila ndjeket zyrtarisht, dhe për të cilën është parashikuar dënim me të holla ose me burg deri në 5 vjet, nëse i dyshuari ose i akuzuari i pranon obligimet si vijojnë, duke u bazuar në parimin e oportunitetit.

Neni 350 (NN76/09, 145/13, 126/19), alinea 6 - Procedura para këshillit për vlerësimin e aktakuzës. Në këtë procedurë “I akuzuari mund të jep deklaratë për pranimin e fajit, për të gjithë apo disa nga pikat e aktakuzës”.

#### **Deklarimi i të akuzuarit për fajtor dhe marrëveshja për dënimin dhe masa tjera.**

Neni 359 (NN 143/12, 145/13), Nëse i akuzuari **para këshillit ka deklaruar së është fajtorë** (neni 350 alinea 6) dhe nuk është arritur marrëveshje për dënimin dhe masa tjera nga neni 360 alinea 4 pika 3 i këtij Ligji, këshilli do ta vërtetojë aktakuzën dhe shkresat do të dërgojë në arkivën gjyqësore për të caktuar shqyrtim kyesorë, nëse nuk egzistojnë shkaqet nga neni 355 dhe 356 të këtij Ligji.

Sipas neni 360 (NN76/09, 145/13, 126/19), Palët mund të negociojnë për kushtet e pranimit të fajit dhe marrëveshjes për dënimin dhe masat tjera nga neni 360 alinea 4 pika 3 e këtij Ligji. I akuzuari gjatë negociatave duhet të ketë avokat-mbrojtës. Në këtë rast Këshilli mund të anulojë seancën më së shumti për 15 ditë, që të mund palët të mbarojnë negociatat. Nëse para fillimit së seancës ose gjatë seancës së këshillit, prokurori publik dhe mbrojtësi nënshkruajnë deklaratë për miratimin e aktgjykimit në bazë të marrëveshjes së palëve, ja dorëzojnë deklaratën këshillit menjëherë pas fillimit të seancës.

Deklarata nga alinea 3 e këtij neni përmban: Përshkrimin e veprës penale lëndë e aktakuzës; deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajit për atë veprë penale; marrëveshje për llojin dhe lartësinë e dënimit, vërejtjes gjyqësore, dënimit me kusht, obligimet e posaçme, mbykëqyrjen mbrojtëse, sendet e mara dhe harxhimet procedurale; deklarimi i të akuzuarit për kërkesën pronësore- juridike dhe nënshkrim. Pas nënshkrimit të deklaratës nga alinea 3, prokurori njohton të dëmtuarin ose viktimën.

Nëse bëhet fjalë për veprë penale kundër jetës dhe trupit për të cilën është parashikuar dënim me burg më i rëndë se 5 vjet, prokurori publik është i obliguar të sigurojë **pëlqimin e viktimës për marrëveshjen**. Nëse viktimë ka vdekur ose është e pa-aftë të jep pëlqim, pajtueshmëri do të kërkohej nga personat nga neni 55 alinea 6 e këtij Ligji.<sup>92</sup>

---

<sup>91</sup> Ligji për procedurë penale – teksti i spastruar, NN 152/08, 76/09, 80/11, 121/11, 143/12, 56/13, 145/13, 152/14, 70/17, 126/19.

<sup>92</sup> <https://www.zakon.hr/z/174/Zakon-o-kaznenom-postupku>.

Në bazë të Ligjit për procedurë penale<sup>93</sup> **Gjykata supreme e Kroacisë** në Aktgjykimin I Kz Us 41/2012, nga 12.09.2013 viti, konstaton se: Aktgjykimi në bazë të marrëveshjes mes palëve nuk është i ligjshëm në pjesën e vendimit për marrjen (konfiskimin) e të mirave materiale të përfituara nga vepra penale dhe për atë gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur ta pranojë atë marrëveshje, për shkak se të mirat materiale janë marrur nga persona të ndryshëm fizik, ndërsa gjykata shumat e posaçme të përfituara nga i akuzuari dhe persona të tjerë i ka mbledhur dhe kështu ka ardhur deri te forma e kualifikuar e vepër penale, pasi që në këtë mënyrë ka fituar shumën më të cilën dobia materiale mer formën e sasisë së konsiderueshme dhe për këtë arsye gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të pranojë marrëveshjen. Si rezultat i këtij vendimi të Gjykatës supreme, obliogohet gjykata e shkallës së parë edhe njëherë të vlerësojë ligjshmërinë e marrëveshjes dhe **njëherit të ju mundësojë palëve të ndërojnë marrëveshjen në pajtueshmëri me mangësitë e konstauara** nga kjo gjykatë.

Nëse palët nuk e ndërojnë marrëveshjen ose tërhiqen nga ajo, gjykata e shkallës së parë do të caktojë seancë për gjykim duke marrë si bazë aktakuzën e vërtetuar<sup>94</sup>. Kjo e fundit paraqet një situatë, kur pas shfuqizimit të vendimit të gjykatave më të ulta palët nuk përkrahin marrëveshjen. Viteve të fundit Republika e Kroacisë manifeston aplikim të qëndrueshëm të marrëveshjes në procedurë penale duka u udhëhequr nga mundësitë normative dhe praktikata e deritanishme<sup>95</sup>

### 2.3.2. Republika e Sërbisë

Marrëveshja për pranimin e fajit është një nga reformat e fundit e vendeve në rajon dhe bëhet fjalë për një institut, që për bazë ka negocimin për pranimi e veprës penale në mes të akuzuarit dhe prokurorit publik dhe në fund duke u finalizuar me pranimin ose jo të marrëveshjes nga gjykatësi. Ky institut aktualizohet në ndërimet dhe plotësimet e Ligjit për procedurë penale të Republikës së Sërbisë, nga viti 2009<sup>96</sup>.

Sipas profeor Stanko Bejatoviç asnjë debat profesional në Serbi dhe më gjërë nuk ka vënë në pykëpyetje rëndësinë penalo-juridike të këtij instituti juridik. Të kundërtën, ky institut për një kohë të shkurtë manifestoi arsyeshmërinë e tij<sup>97</sup>. Nga ana tjetër insistimi i

---

<sup>93</sup> NN 152/08, 76/09, 80/11, 91/12 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të R së Kroacisë, 143/12, 56/13, 145/13, LPP në përgjithësi.

<sup>94</sup> Gjykata supreme e Kroacisë, Aktgjykimin I Kz Us 41/2012, nga 12.09.2013 viti, Shih në Vrhovni sud Republike Hrvatske, IZBOR ODLUKA 1/2014, Narodne Novine.

<sup>95</sup> Shih, <http://www.dorh.hr/dorh29042021>, Izvješće Glavnog Drzavnog Odvejtника Republike Hrvatske o radu Drzavnih Odvjetnistava u 2020 godini, Zagreb, Travanj 2021; Izvješće Glavnog Drzavnog Odvejtника Republike Hrvatske o radu Drzavnih Odvjetnistava u 2019 godini, Zagreb, Travanj 2020.

<sup>96</sup> Pojednostavljene forme postupanja u krivičnim stvarima, Rgionalna krivičnoprocesna zakonodavstva i istkustva u primeni, Obse misija u Surbiji, Fq,16, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>.

<sup>97</sup> Shih, Prirucnik za postupanje advokata u krivicnom postupku, Beograd 2019, fq.67, prirucnik-za-postupanje-advokata-krivicnom-postupku.pdf.

opinionit shkencorë për aplikimin e këtij instituti ç’do ditë e më shumë e pranon praktika. Për dallim nga Ligji për procedurë penale në fuqi i Republikës së Serbisë, ligjet e vendeve në rajon njohin tre lloje të marrëveshjes: marrëveshje për pranimin e veprës penale, marrëveshje për dëshmim të akuzuarit dhe marrëveshje për dëshmim të gjykuarit<sup>98</sup>.

Marrëveshja në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit për **pranimin e një ose më shumë veprave penale** për të cilat ngarkohet i pandehuri, zakonisht bëhet për të **arritur deri te dënimi më i ulët** (neni 313 i LPP), ndërsa prokurori publik nuk do të humb koh për të grumbulluar dëshmi shtesë për në shqyrtim kryesorë të cilit nuk i dihet rezultati. Nga ana tjetër, viktima nuk dë të vëndohet në pozitë të palakmushme me ardhjen e tij në gjykatë. Inicijativa për negociim dhe bërje të marrëveshjes mund të vijë nga prokurori publik, nga i akuzuari dhe mbrojtja e tij, ndërsa gjykata nuk ka kompetenca që kanë të bëjnë me iniciativën, procesin e bisedimeve dhe bërjen e marrëveshje<sup>99</sup>.

Proçesi i negociimit në parim ka dy modalitete: Negocim për fajësinë që nënkupton analizë të fakteve me të cilat paraqiten palët, të cilat i prezenton prokurori publik i akuzari dhe mbrojtja e tij. Dhe negociim për sanksionin. Gjatë procedurës së negociimit prezenca e mrojtjes është obligative (neni 313 alinea 2). Mbrojtja fokusohet të kualifikimi ligjorë i veprës penale dhe sanksioni që duhet ta marrë klienti i tij.

Me rëndësi është të theksohet se së pari duhet të bëhet marrëveshja në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit, për atë se cilën gjendje faktike do ta pranojë dhe nëse prokurori me atë pajtohet atëherë aktakuza sipas nevojë ndërrohet, që të jetë në pajtueshmëri me pranimin e fajësisë duke pasur parasysh se pranimi duhet të jetë i “plotë”, shikuar nga prizmi i aktakuzës së ndëruar. Në çdo rast nuk është e mundur që me marrëveshjen për pranimin e veprës penale i dyshuari të pranojë diçka që dallohet nga qëndrimi definitiv i prokurorisë, i paraqitur në akatakuzë që figuron në marrëveshje<sup>100</sup>.

Marrëveshje për pranimin e veprës penale, prokurori publik dhe i akuzuari mund ta arrijnë **deri sa të miratohet Urdhëresa për zbatimin e hetuesisë**, si dhe deri tek mbarimi i **shqyrtimit kryesorë**<sup>101</sup>. Marrëveshjen për pranimin e veprës penale në formë të shkruar prokurori publik deri në vërtetimi u aktakuzës e dorëzon tek gjykatësi i procedurës paraprake, pas saj deri te kryetari i këshillit (neni 313 alinea 3). Për marrëveshjen për pranimin e fajit vendos gjykatësi i procedurës paraprake. Nëse marrëveshja është dorëzuar gjykatës pas vërtetimit të aktakuzës – kryetarit të këshillit. Vendimi për pranimin e veprës

---

<sup>98</sup> Për mënyrën, kushtet dhe procedurën e marrëveshjes në Serbi, shih: Pojednostavljene forme postupanja u krivičnim stvarima , Regionalna krivičnoprocesna zakonodavstva i istakustva u primeni, Obse misija u Srbiji, Fq,11-24 , <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>.

<sup>99</sup> S. Bejatović, Sporazum o priznanju krivice (novi ZKP Srbije i regionalna komparativna analiza)”, Savremene tendencije krivičnog procesnog prava u Srbiji i regionalna krivičnoprocesna zakonodavstva, 2012, fq. 109.

<sup>100</sup> Prirucnik za postupanje advokata u krivicnom postupku, Beograd 2019, fq.72,

<sup>101</sup> Zakonik o krivičnom postupku, („Sl. glasnik RS“, br. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013 i 55/2014), dostupno na: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik\\_o\\_krivicnom\\_postupku.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik_o_krivicnom_postupku.html), neni 313 alinea 1.

penale miratohet në seancë në të cilën ftohet prokurori i akuzuari dhe mbrojtësi i tij (neni 315 alinea 1-2).

Një marrëveshje e tillë duhet të **përmbajë** përshkrimin e veprës penale, pranimin e të akuzuarit, marrëveshje për llojin dhe lartësinë e dënimit, si dhe deklaratën për heqje dorë nga e drejta për ankim kundër vendimit me të cilin gjykata në tërësi e pranon marrëveshjen (neni 314). Gjykata me aktgjykim do të pranojë marrëveshjen për pranimin e veprës penale dhe do të shpall të akuzuarin fajtorë, nëse për atë egzistojnë kushte (neni 317) ose me vendim do ta refuzojë marrëveshjen nëse për atë nuk egzistojnë kushte ligjore. Kundër vendimit me të cilin marrëveshja për pranimin e veprës penale refuzohet ankesë nuk lejohet (neni 319 alinea 2). Ndërsa **kundër aktgjykimit me të cilin pranohet marrëveshja** për pranimin e veprës penale, **mund të dorëzohet ankësë** në afat prej 8 ditëve (neni 319 alinea 3).

Marrëveshja për **dëshim të të akuzuarit** (neni 320-326), si lloj i veçantë i marrëveshjes mund të përmbajë obligim që i akuzuari të dëshmojë për ndonjë nga veprat penale të numëruara në nenin 162 të LPP, kundër të bashkë-akuzuarve për të cilat ka njohuri<sup>102</sup>. Në marrëveshjet e tilla prokurori publik mund të propozojë që i akuzuari të lirohet nga dënimi (neni 321 LPP). Një marrëveshje e tillë mund të bëhet edhe më të gjykuarin i cili është në vuajtje të dënimit me burg – **Marrëveshje për dëshim të dënuarit** (neni 327-330 LPP RS)<sup>103</sup>.

LPP i RS i vitit 2011 bën një përpunim më të detajuar të marrëveshjes në procedurë penale, por edhe më tej ky institut lë hapësirë për debat shkencorë në lidhje me arsyeshmërinë e tij. Profesor Bejatoviç, konsideron se egziston arsyeshmëri e plotë kriminalo-politike për normimin e marrëveshjes për pranimin e fajit në procedurë penale, por shpreh rezervë për disa nga zgjedhjet e normuara<sup>104</sup>. Edhe përkundër aktivitetit të bujshëm normativ dhe praktikës gjyqësore, rezerva të shumta shprehin edhe autorë tjerë si dhe praktika gjyqësore duke filluar nga aspekte formale dhe ata përmbajtësore që kanë të bëjnë me aplikimin konkret, pozicionin e palëve dhe të drejtat dhe liritë e të akuzuarëve<sup>105</sup>. Ndërsa nga disa autorë edhe më tutje analizohet ndikimi i devalvimit të parimit të së vërtetës në ligjin e ri për procedurë penale<sup>106</sup>.

Çështje e rëndësishme për këtë institut penalo juridik është, mundësia e shfrytëzimit të deklaratës për pranimin e fajit në procedurë që zhvillohet ndaj personave të tjerë. Më

---

<sup>102</sup> Më gjërësisht shih: Prirucnik za postupanje advokata u krivicnom postupku, Beograd 2019, fq.77,

<sup>103</sup> Ibid, fq. 78.

<sup>104</sup> Shih, Pojednostavljene forme postupanja u krivičnim stvarima, Regionalna krivičnoprocesna zakonodavstva i istkustva u primeni, Obse misija u Srbiji, Fq, 21-24, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>.

<sup>105</sup> Приручник за примену Законика о кривичном поступку, уредници: проф.др Станко Бејатовић, проф др Милан Шкулич, др Горан Илић, Мисија ОЕБС у Србији, fq.23- 27, /prirucnik.zkr.novi.pdf.

<sup>106</sup> Shih prof dr. Milan Skulic, Odnos nacela istine i pojednostavljenih formi krivicnog postupka, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>, fq. 75.

saktësisht çka mund të jetë dëshmi në procedurë tjetër, vetë marrëveshja ose aktgjykimi i miratuar në bazë të marrëveshjes. Duhet të theksohet se Prokuroria për krim të organizuar zakonisht propozon që si dëshmi të lexohet aktgjykimi i miratuar në bazë të marrëveshjes. Edhe pse në praktikë egziston dilema, është plotësisht e qartë që si dëshmi eventualisht mund të shfrytëzohet vetëm marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe asesi aktgjykimi i miratuar në bazë të marrëveshjes. Aktgjykimi i miratuar në këtë mënyrë nuk është dëshmi, por vlerësim i marrëveshjes gjegjësisht vlerësim për ligjshmërinë dhe cilësinë e marrëveshjes. Aktgjykimi i tillë mund të jetë dëshmi vetëm në lidhje me një marrëveshje të caktuar, në aspekt se udhëhiqet procedurë, kush ka qenë pjesmarës i asaj procedure dhe si janë sjellur ata, kur është realizuar procedura dhe pyetje të njëgjajshme. **Me një aktgjykim të tillë nuk mund të dëshmohet fakte nga marrëveshja** që to të ish lëndë e gjyqimit me bashkë të akuzuarit<sup>107</sup>.

Çështje tjetër e rëndësishme është fakti, se a mundet personi që ka bërë marrëveshje për pranimin e veprës penale të jetë dëshmitarë në procedurë që zhvillohet kundër - bashkë të akuzuarëve të cilët nuk kanë bërë marrëveshje për pranimin e fajit. Pasi që me LPP nuk është përjashtuar kjo mundësi, nuk mund të jetë kontestuese se është e lejuar (mudshme)<sup>108</sup>. Ky institut sikurse edhe pushimi i ndjekjes penale (parimi i oportunitetit), sjell deri tek zvogëlimi i mbingarkimit të gjykatave dhe zvogëlimin e harxhimeve. Dallimi kryesorë është së në rast të oportunitetit padia penale hudhet ndërsa në rast të marrëveshjes miratohet aktgjykim i cili hyn në evidencën dënuese. Aplikimi i këtij instituti problematizohet nga aspekti i shqiptimit të sanksioneve pasi që shpeshherë shqiptohen dënime të cilat janë shumë të buta ose nuk shqiptohet dënim me burg që të dëmtuarit nuk i jep një satisfacion adekuat<sup>109</sup>.

Përveç marrëveshjes për pranimin e fajit, një nga format tjera me të cilën mund të thjeshtësohet procedura penale është **seanca për shqiptimin e sanksionit** që në disa vende të rajonit njihet si procedurë për shqiptimin e sanksionit (LPP i Malit të zi). Ndërsa LPP i Republikës së Kroacisë e njeh si nxjerrje të Urdhëresës penale. Ky institut në Republikën e

---

<sup>107</sup> Prirucnik za postupanje advokata u krivicnom postupku, Beograd 2019, fq.73. Në kontekst të këtij qëndrimi, autorët iu referohen disa lëndëve gjyqësore: Gjykata e lartë në Beograd, Reparti i veçantë, K Po1 273/10, procesverbal nga seanca kryesore nga 13 shkurt 2012 viti, fq. 40, dhe lënda K Po1 37/2012 procesverbal nga seanca kryesore nga 5 nëntorë 2012, fq. 16. Një qëndrim identik ka marrë edhe Gjykata e apelit në Beograd. Shih: „Priznanje“ tuđeg krivičnog dela, <http://misamajic.com/>. Qëndrim se akgjikimi i miratuar në bazë të marrëveshjes për pranimin veprës penale nuk është dëshmi ka marrë edhe Gjykata e apelit në Novi Sad, në vendimin KŽ1 broj 325/18 od 23 maja 2018, me të cili shfuqizon aktgjykimin e shkallës së parë.

<sup>108</sup> Prirucnik za postupanje advokata u krivicnom postupku, Beograd 2019, fq.74.

<sup>109</sup> Shih, Milan Filipovic, Monitoring suđenja u krivičnim postupcima – priručnik za novinare, YUCOM – Komitet pravniku ya ljudska prava & American bar association- ABA fq.23-24, Monitorin Krivicnih postupaka.pdf .

Sërbisë ka emër tjetër, më një sasi tjetër aplikimi dhe me një formë tjetër të përpunimit normativ - Senacë për shqiptimin e sanksionit<sup>110</sup>.

Për vepra penale për të cilat si dënim kryesorë mund të shqiptohet dënim në të holla dhe dënim me burg deri më 5 vite, prokurori publik mund që në propozim - akuzë të kërkojë të mbahet seancë për shqiptimin e sanksionit. Këtë kërkesë prokurori publik mund ta bëjë nëse konsideron se nuk ka nevojë për mbajtje të shqyrtimit kryesorë, duke u bazuar në natyrën e lëndës, dëshmitë e grumbulluara dhe veçanërisht në rast të arrestimit të akuzuarit gjatë kryerjes së veprës penale ose pranimit se ka kryer veprën penale<sup>111</sup>

Këtë institut mund ta gjejmë te disa norma të Ligji për procedurë penale nga viti 2001, që më vonë merren si bazë e ndërimeve dhe plotësimeve të vitit 2004, që kanë të bëjnë me thjeshtësimin e procedurës penale<sup>112</sup>. LPP i Republikës së Sërbisë i vitit 2004 zgjëroi mundësinë e dënimit pa mbajtur shqyrtim kryesorë për vepra penale për të cilat është parashikuar dënim deri me tre vite burg, dhe njëkohësisht zgjërohet lepeza e sanksioneve që mund të shqiptohen. Por tendenca reformuese normative vazhdon me LPP e viti 2011 me të cilin zgjërohet mundësia e aplikimit të këtij instituti. Kështu, në raste kur prokurori në bazë të peshës së lëndës dhe dëshmitë të grumbulluara e në veçanti pas privimit nga liria të pandehurit gjatë kryerjes së veprës penale, ose pranimit se ka kryer vepër penale konsideron se mbajta e shqyrtimit kryesorë nuk është i nevojshëm, **mund të propozojë seancë për shqiptimin e sanksionit**. Kjo mund të aplikohet te veprat penale për të cilat është parashikuar dënim në të holla ose dënim me burg defri në 5 vite, me një kusht që sanksioni i propozuar nga prokurori publik të mund të arrij më së shumti 1/3 e dënimit të parashikuar.

Ky është një institut i cili mund të aplikohet vetëm **nëse për këtë pajtohet gjykata**. Seanca fillon me eksplorimin e prokurorit për dëshmitë me të cilat disponon dhe llojin dhe lartësinë e sanksionit që propozon. Pas kësaj gjykata fton të akuzuarin të prononcohet, por paraprakisht njohtohet për pasojat, nëse ai pajtohet me prononcimin e prokurorit dhe në veçanti njohtohet se nuk mund të parashtrojë vërejtje dhe ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykatësi menjëherë pas mbarimit të seancës shqipton dënimin ose përcakton senacë për shqyrti kryesorë. Rrjedha e kësaj procedure në mënyrë të detajuar rregullohet në nenet 512-518 LPP të RS<sup>113</sup>.

---

<sup>110</sup> Zakonik o krivičnom postupku, („Sl. glasnik RS“, br. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013 i 55/2014), neni 512-518.

<sup>111</sup> Më detajisht shih, Приручник за примену Законика о кривичном поступку, уредници: проф.др Станко Бејатович, проф др Милан Шкулич, др Горан Илич, Мисија ОЕБС у Србији, fq.409 – 410, /prirucnik.zkp.novi.pdf

<sup>112</sup> Shih, Dragan Novosel, Načelo svrsishodnosti(oportuniteta) – zakonska resenja i rpimjena, fq.43-61, Savremene tendencije krivičnog procesnog prava u Srbiji i regionalna krivičnoprocesna zakonodavstva (normativni i praktični aspekti)., OSCE Srbija.

<sup>113</sup> Ibid, fq.27

### 2.3.3 Republika e Kosovës.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë është një institut i rëndësishëm nëpërmjet të cilit mundësohet që i akuzuari të pranojë fajin, dhe në këmbim të kësaj të përfitojë favore të caktuara në lidhje me dënimin, përkatësisht sanksionin penal. Kështu, sipas nenit 233 paragrafi 1 të Kodit për procedurë penale të Republikës së Kosovës (KPPK)<sup>114</sup>, në çdo kohë **pas ngritjes së aktakuzës** prokurori i çështjes dhe avokati mbrojtës mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i akuzuari pranon fajësinë në shkëmbim për: 1) Pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e parashikuar me ligj, ose minimumin për të cilin do të flitet më poshtë në kuadër të kësaj tematike, ose 2) Konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi.

Mirëpo sipas KPP të ri, prokurori tani mund të iniciojë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë jo vetëm **pas ngritjes së aktakuzës por edhe para këtij momenti**. Një tipar tjetër i kodit të ri është mundësia që prokurori të rekomandojë dënim më të butë deri në masën e lejuar varësisht nga koha kur është arritur marrëveshja: gjatë shqyrtimit kryesor, para shqyrtimit kryesor, apo pandehuri mer pjesë në cilësi e **dëshmitarit bashkëpunëtor**<sup>115</sup>. Marrëveshja e negocuar mbi pranimin e fajësisë është alternativa më e rëndësishme ndaj gjykimit<sup>116</sup>.

Për nevojat e lehtësimeve aplikative nga njëra anë dhe barabarësija e palëve nga ana tjetër, Kryeprokurori i shtetit së bashku me Kryeprokurorin e EULEX-it në nëntor të vitit 2013 i kanë nxjerr Udhëzimet në lidhje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Përveç tjerave, këto udhëzime janë nxjerr me qëllim të kanalizimit të aktiviteteve të prokurorit në lidhje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Udhëzimet tregojnë se çka duhet të përmbajë marrëveshja e shkruar mbi pranimin e fajësisë dhe çka prokurori mund (dhe nuk mund) të ofrojë si pjesë e procesit të negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Udhëzimet i trajtojnë edhe përgjegjësitë e prokurorëve ndaj palëve të dëmtuara si pjesë e procesit të negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe detyrat e tyre në lidhje me çështjen e konfiskimit të objekteve dhe përfitimit material të krimit<sup>117</sup>. Në kontekst të aplikimit të këtij

---

<sup>114</sup> Kodi i procedurës penale të Kosovës Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.37/28 dhjetorë 2012, Prishtinë

Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës penale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861>.

<sup>115</sup> Shih: Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri procedurës penale në Kosovë, osbe, Misioni në Kosovë, qershor 2016 <https://www.osce.org/files/f/documents/b/c/243981.pdf>, fq. 26. Neni 233(7) i KPP-së parasheh që prokurori i shtetit të mund të rekomandojë dënim më të butë se minimum i mundshëm i burgimit i vendosur me Kodin Penal. Varësisht nga faza e procedurës, propozimi mund të shkojë nga 90% të minimumit (nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë arrihet në shqyrtimin kryesor), 80 për qind, 60 për qind apo edhe deri 40 për qind për të pandehurit të cilit i jepet statusi i "dëshmitarit bashkëpunues"

<sup>116</sup> Ibid, Udhëzuesi për KPP-në, f 30 dhe 62. Shih edhe komentare për KPP-në, (shënimi 41 më lart) f 571-605 .

<sup>117</sup> Udhëzimet për Marrëveshjet mbi Pranimin e Fajësisë, Zyra e Kryeprokurorit të Kosovës dhe Kryeprokurorit të EULEX-it, 13 nëntor 2013, adresuar të gjithë prokurorëve në Republikën e Kosovës, [http://www.pshks.net/repository/docs/Instructions\\_on\\_guiltiness\\_plea\\_agreements.pdf](http://www.pshks.net/repository/docs/Instructions_on_guiltiness_plea_agreements.pdf). Shih:Shqyrtimi i

instituti dhe sigurimin e një qasje uniforme në matjen e dënimeve dhe plotikën ndëshkuese, Gjykata supreme e Republikës së Kosovës në vitin 2018, ka mirratuar një Udhëzues për politikën ndëshkimore në Kosovë<sup>118</sup>.

Në fakt, në rastet kur i akuzuari dëshiron të arrijë marrëveshje për pranimin e fajësisë, avokati mbrojtës i të pandehurit ose i pandehuri nëse nuk përfaqësohet nga avokati mbrojtës, do të kërkojë nga prokurori një takim paraprak për të filluar negociimin për marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Në të gjitha negociatat e tilla i pandehuri duhet të jetë i përfaqësuar nga avokati mbrojtës i tij, (paragrafi 3 i nenit 233 të KPPK)<sup>119</sup>.

Pas pranimit të kërkesës për takim paraprak, prokurori do ta informojë kryeprokurorin e zyrës së tij përkatëse i cili do të jep autorizim me shkrim për mbajtjen e takimit për diskutim për pranimin e fajësisë, në të cilin deklaratave të akuzuarit do t'i jepet imunitet i kufizuar siç parashihet në paragrafin 11 të këtij neni. Procedurën e negociimit më detajisht e regullon Prokurori i Shtetit me Udhëzim për negociimin e Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë<sup>120</sup>, i nxjerrur në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.3 /L-225 për Prokurorinë e shtetit. Kjo mundësohet me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe aplikimin e ndërmjetësimit si procedurë alternative, me qëllim të zbatimit unik të praktikave pas ndryshimeve në Kodin penal të Republikës së Kosovës.

Përkundër udhëzimit të lartpërmendur Prokurori i shtetit ka nxjerrë një udhëzim të veçantë - "Udhëzim për mosdërgim në ndërmjetësim të rasteve të dhunës familjare, A.nr/163/2021<sup>121</sup>, si përjashtim të mundësisë për marrëveshje. Egzistojnë edhe udhëzime tjera, që paraprakisht e rregullojnë këtë çështje, tani më të shfuqizuara<sup>122</sup>.

---

zbatimit të kodit të ri procedurës penale në Kosovë, osbe, Misioni në Kosovë, qershor 2016 <https://www.osce.org/files/f/documents/b/c/243981.pdf>

118

[https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore\\_Shkurt%202018.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf)

119 Fazat e procedurës penale – për Avokatët, fq.70,

[http://www.brrln.org/uploads/documents/335/Priracnik\\_za\\_krivicna\\_postapka\\_KOS\\_2\\_3-final.pdf](http://www.brrln.org/uploads/documents/335/Priracnik_za_krivicna_postapka_KOS_2_3-final.pdf)

120

[https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Udhezim%20nr.%20160\\_2021%20per%20Negocim%20e%20marreveshjes%20mbi%20pranimin%20e%20fajesise.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Udhezim%20nr.%20160_2021%20per%20Negocim%20e%20marreveshjes%20mbi%20pranimin%20e%20fajesise.pdf), A.nr.160/2021, nga 27.05.2021;

121

[https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Udhezim%20nr.%20163\\_2021%20per%20mos%20dergim%20ne%20ndermejetesim%20te%20rasteve%20te%20](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Udhezim%20nr.%20163_2021%20per%20mos%20dergim%20ne%20ndermejetesim%20te%20rasteve%20te%20)

122 Udhëzime mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë, 12 nëntor 2013, tashmë e shfuqizuar, [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Anudhza%20dmn/Udhezim%20per%20pranim%20e%20marreveshjes%20se%20fajesise-Shfuqizuar\(1\).pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Anudhza%20dmn/Udhezim%20per%20pranim%20e%20marreveshjes%20se%20fajesise-Shfuqizuar(1).pdf), Udhëzim për rastet e dhënës në familje (Që të mos dërgohen në ndërmjetësim), A.nr,360/16, 29 qershor 2016.

Të gjitha marrëveshjet mbi fajsinë duhet të jenë në formë të shkruar dhe të pranuar nga kryeprokurori i zyrës së prokurorisë përkatëse, para se formalisht t'i ofrohen të pandehurit (paragrafi 4 i nenit 233 të KPPK). Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajit mund të përfshijë dispozicionin, që prokurori të kërkojë nga gjykata dhënie të urdhrin për të shpallë të akuzuarin si **“dëshmitarë bashkëpunues”**. Kështu, nëse i pandehuri i tillë jep asistencë si dëshmitar bashkëpunues, prokurori i çështjes do t'i rekomandojë gjykatës një dënim më të butë që do të reflektojë nivelin e ndihmës dhe bashkëpunimit të dhënë nga i akuzuari, duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale (paragrafi 6 i nenit 233 të KPPK). I akuzuari dhe avokati mbrojtës duhet të jenë prezent gjatë takimeve mbi negociimin e pranimit të fajësisë, dhe duhet të pajtohen me kushtet e marrëveshjes me shkrim mbi pranimin e fajësisë, përpara se ajo t'i prezantohet gjykatës.

Prokurori i shtetit duhet të **informojë palën e dëmtuar** mbi marrëveshjen e arritur pasi që ajo të marrë formën përfundimtare. Kur pala e dëmtuar ka kërkesë pasurore juridike që rrjedh nga vepra penale, marrëveshja mbi fajësinë duhet ta trajtojë kërkesën e palës së dëmtuar dhe prokurori duhet të njoftojë atë se i pandehuri kërkon të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. **Palës së dëmtuar duhet t'i jepet rasti që të deklarohet para gjykatës mbi kërkesën pasurore juridike para se gjykata ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë (paragrafi 8 i nenit 233 të KPPK).**

**Sipas zgjidhjeve në fuqi, gjykata nuk do të marrë pjesë në negociimin e pranimit të fajësisë, por mund të caktojë afate të arsyeshme, jo më të gjata se 3 muaj për përfundimin e negociatave në mënyrë që të pengohet zvarritja e procedurës.**

Në fakt, në çdo kohë përpara se gjykata ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, Prokurori i shtetit ose i pandehuri **mund të refuzojnë marrëveshjen** mbi pranimin e fajësisë dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, do të caktojë seancën për shqyrtim gjyqësor.

Në qoftë se prokurori i shtetit dhe avokati mbrojtës apo i pandehuri dështojnë të arrijnë marrëveshje mbi pranimin e fajit, ose në rast se marrëveshja nuk pranohet nga gjykata, deklaratat e të pandehurit të dhëna në takimin paraprak të mbajtur, për të negociuar marrëveshje mbi pranimin e fajit, **do të jenë prova të papranueshme në shqyrtim gjyqësor** ose ndonjë procedurë tjetër të ndërlidhur (paragrafët 10 dhe 11 të nenit 233 të KPPK).

Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajit duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes dhe duhet të jetë e nënshkruar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse, avokati mbrojtës dhe i pandehuri, dhe e njëjta është detyruese për të gjitha palët nënshkruese.

Marrëveshja mbi fajësinë, sipas paragrafit 12 të nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale, duhet së paku të përfshijë: 1) Pikat e aktakuzës për të cilat i akuzuari pranon fajësinë; 2) Nëse i pandehuri pranon të bashkëpunojë; 3) Të drejtat nga të cilat hiqet dorë; 4) Përgjegjësia e të pandehurit për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar dhe konfiskimi i të gjitha të mirave, pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit. Marrëveshja me shkrim poashtu mund të përfshijë dispozitë me të cilën palët **pajtohen për kufijtë e dënimit** që do të propozohen nga ana e Prokurorit të shtetit, nëse i pandehuri **bashkëpunon substancialisht**.

Ndërsa, nëse gjykata shqipton dënim i cili dëmton njëri palë, pala do të ketë të drejtë **ankesë kundër vendimit** mbi dënimin, (paragrafi 13 i nenit 233 të KPPK).

Marrëveshja me shkrim duhet të prezantohet në gjykatë në seancë të hapur publike, përveç rasteve kur i akuzuari është pajtuar që të jetë dëshmitar bashkëpunëtor dhe kur masat mbrojtëse të zbatuara ndaj tij e kërkojnë një gjë të tillë (paragrafi 14 i nenit 233 të KPPK). Gjykata do ta pranojë apo refuzojë marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësisë, në varësi të rastit konkret dhe vlerësimit të rrethanave që kanë të bëjnë me të kuptuarit e pasojave të pranimit të fajit nga i akuzuari dhe vlerësimit të rrethanave tjera të specifikuar sipas adresimit që bën kjo dispozitë.

Më në fund, marrëveshja e arritur midis palëve do të fillojë të prodhojë efektet e saj gjegjësisht gjykata do të fillojë të veprojë sipas saj, vetëm atëherë kur ajo të evidentohet në procesverbalin e saj, me ç'rast konsiderohet se marrëveshja është pranuar zyrtarisht nga gjykata (paragrafi 16 i nenit 233 të KPPK).

Nëse i pandehuri pranon të jetë dëshmitar bashkëpunëtor dhe kur masat e parapara mbrojtëse i janë siguruar atij, pas kërkesës së cilësdo palë gjykata mund të urdhërojë një seancë dëgjimi për të shqyrtuar marrëveshjen për pranim të fajësisë, që do të jetë e mbyllur për publikun dhe mund të urdhërojë që marrëveshja për pranim të fajësisë me shkrim të jetë e mbyllur (paragrafi 17 i nenit 233 të KPPK).

Gjatë shqyrtimit, nëse duhet pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë gjykata, sipas paragrafit 18 të nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale, duhet ta dëgjojë personalisht të pandehurin, avokatin mbrojtës dhe prokurorin e shtetit, dhe të përcaktojë nëse: 1) I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. 2) Pranimi i fajësisë është bërë me vullnet nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, nëse i pandehuri ka avokat mbrojtës, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar me forcë që të deklarojë fajësinë ose i shtrënguar në çfarëdo mënyre tjetër. 3) Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat i përmban aktakuza, apo prova materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri si dhe me dëshmi tjera, siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të prezantuara nga prokurori ose i pandehuri dhe 4) Nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara për hedhje poshtë të aktakuzës<sup>123</sup>.

Nëse gjykata nuk është e bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara për pranimin e saj, ajo do të **refuzojë pranimin** e fajësisë dhe rasti do të vazhdojë në gjykim të rregullt (paragrafi 20 i nenit 233 të KPPK). Nëse gjykata është e bindur se të gjitha kushtet janë përmbushur, ajo mund **ta pranojë marrëveshjen** për pranimin e fajësisë dhe do të urdhërojë që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë.

Gjykata do të caktojë një datë kur palët do të **japin deklaratat e tyre lidhur me dënimin**, pas së cilës gjykata do të shqiptojë dënimin. Megjithatë, kjo datë mund të shtyhet në mënyrë që i pandehuri të shërbejë si dëshmitarë bashkëpunues, (paragrafi 21 i nenit 233

---

<sup>123</sup> Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri procedurës penale në Kosovë, osbe, Misioni në Kosovë, qershor 2016 <https://www.osce.org/files/f/documents/b/c/243981.pdf>, fq. 72

të KPPK). Pasi që gjykata të ketë pranuar marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë, por para se të shqiptohet dënimi mund të mos i lejojë të pandehurin ose prokurorit të tërheqin marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, përveç nëse gjykata gjen se ndonjë nga kushtet e parapara në marrëveshje nuk përmbushet. Pala e cila **kërkon të tërhiqet nga marrëveshja** e ka barrën e të provuarit, gjatë parashtrimit të asaj kërkesë në gjykatë, (paragrafi 22 i nenit 233 të KPPK)<sup>124</sup>.

**Aplikimi i marrëveshjes në procedurë penale.** Në Raportin i punës së Prokurorit të shtetit, gjashtëmujori i parë, 2021<sup>125</sup> prokurori potencon se trajtimi i rasteve me procedurë alternative synon dhënien e drejtësisë në kohë sa më të arsyeshme dhe shkarkimin e prokurorëve nga barra e numrit të madh të lëndëve.

Në këtë funksion, është edhe **procedura e veçantë për dhënien e Urdhërit ndëshkimor**. Prokurori i shtetit në këtë mënyrë ka zgjedhur 1109 raste, me 1808 persona, gjatë gjashtëmujorit të parë, të vitit 2021; 52 raste me 59 persona me pezullim të përkohëshëm të procedurës (neni 230); 5 raste me 5 persona, sipas kushteve kur ndjekja nuk është e detyrueshme (neni 231); 842 raste me 1488 persona, në procedurën e ndërmjetësimit (neni 232); 210 raste me **256 persona me aktakuzë për marrëveshjen e pranimit të fajësisë** (neni 233).

Nga një hulumtim për sasinë e aplikimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajit në procedurë penale në praktikë, konstatohet se palët ende rrallëherë e negociojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Gjithsej 61 përqind e gjyqtarëve që janë përgjigjur në pyetësor kanë theksuar që ata “rrallëherë apo asnjëherë” nuk kanë parashtruar marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Përkundër kësaj 45 për qind e avokatëve dhe 51 përqind e prokurorëve që kanë thënë “rrallëherë apo asnjëherë” nuk i negociojnë marrëveshjet e tilla. Sipas statistikave të pranuar nga KGJK marrëveshjet e negociuara mbi pranimin e fajësisë janë përdorur në vetëm 3 për qind të rasteve që janë trajtuar nga prokuroritë në tërë Kosovën ndërmjet prillit dhe qershorit 2015<sup>126</sup>.

Monitorimi i OSBE-së ka treguar se një numër domethënës i të pandehurve pajtohet që ta pranojnë fajësinë por nuk e bënë këtë përmes marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. **Në vend të kësaj, të pandehurit e pranojnë fajësinë gjatë procedurës së rregullt.** Për shembull, 408 shqyrtime fillestare produktive janë monitoruar në **departamentin e përgjithshëm** dhe atë të krimeve të rënda. Fajësinë e kishin pranuar 101 nga të pandehurit (25 për qind e seancave). Në krahasim me këtë, vetëm në tetë raste të monitoruara gjatë periudhës raportuese pranë dy departamenteve, ishin **marrëveshje të shkruara** mbi pranimin e fajësisë të arritura ndërmjet palëve. Në dy raste tjera, palët kanë bërë përpjekje për të arritur marrëveshje por pa ndonjë rezultat. Statistikat e mara nga KGJK (Këshilli

<sup>124</sup> Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri procedurës penale në Kosovë, osbe, Misioni në Kosovë, qershor 2016 <https://www.osce.org/files/f/documents/b/c/243981.pdf>, fq. 73.

<sup>125</sup> <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Publikime/Raporti%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit-gjasht%C3%ABmujori%20i%20par%C3%AB%202021.pdf>, fq.29.

<sup>126</sup> Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri procedurës penale në Kosovë, osbe, Misioni në Kosovë, qershor 2016 <https://www.osce.org/files/f/documents/b/c/243981.pdf>, fq. 26.

gjyqësorë i Kosovës) gjithashtu tregojnë që numri i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë të arritura ndërmjet palëve është i ulët: vetëm 171 marrëveshje janë arritur ndërmjet prillit dhe qershorit 2015 nga 5925 raste të proceduara nga shtatë prokuroritë<sup>127</sup>.

Nga 11 prokurorë që janë intervistuar gjatë periudhës raportuese, pesë nga ata e kanë shprehur ngurrimin e tyre në përdorimin e kësaj alternative, pasi që është proces i ngarkuar. Prokurori për shembull, kërkohet që ta njoftoj kryeprokurorin e prokurorisë së tij, i cili duhet të jep autorizim me shkrim për takimin preliminar me qëllim të fillimit të negociatave për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Prokurorët me sa duket e kanë anashkaluar faktin që mund të përfitojnë nga iniciimi i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë, sipas nenit 233 të KPP-së. Në fakt bashkëpunimi me të pandehurin mund t'i avancoj hetimet<sup>128</sup>.

Një arsye tjetër përse ka numër të vogël të marrëveshjeve mbi pranimin të fajësisë, me sa duket është që të pandehurit që e pranojnë fajësinë gjatë procedurave të rregullta edhe ashtu pranojnë dënime të ulëta, apo edhe nën minimumin e paraparë me ligj<sup>129</sup>. Për këtë arsye, të pandehurit mund të mos kenë motivim për të negociuar marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë me shkrim. Raporti i konsoliduar i KGJK-së e ka potencuar se kur të pandehurit e pranojnë fajësinë gjatë gjykimit, gjykatat “mjaftë shpesh” u shqiptojnë dënim nën minimumin e paraparë ligjor, duke u arsyetuar se ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese në rast. Ai më tutje rekomandon që gjykatat duhet t'i rishikojnë politikat tyre me qëllim të rritjes së numrit të rasteve në të cilat do të arrihet marrëveshje e negociuar mbi pranimin e fajësisë<sup>130</sup>.

Gjithashtu, në rastet e monitoruara gjatë së cilave palët kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, apo kanë shprehur vullnet për atë, aktakuza tashmë ishte ngritur. Kjo tregon që nuk është duke u zbatuar as dispozita e re e KPP-së e cila u lejon palëve që ta negociojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës. **Raporti i konsoliduar i KGJK-së thekson që “shumica e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë janë arritur pas ngritjes së aktakuzave”**

Një çështje tjetër që është vërejtur është se gjykatat shpesh **dështojnë që të vendosin afate për negociatat**. Vetëm tetë për qind e avokatëve të anketuar kanë thënë që gjykata “shpeshherë” vendos afate për negociimet; 16 për qind e prokurorëve të anketuar kanë dhënë të njëjtën përgjigje; dhe vetëm gjashtë për qind e gjyqtarëve e kanë pranuar këtë fakt.

---

<sup>127</sup> Ibid, fq.26, Implementimi i Procedurave Alternative, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, f.7.

<sup>128</sup> Ibid, fq. 27, Udhëzuesi për KPP-në, f. 23.

<sup>129</sup> Pranimi i fajësisë është me të vërtetë faktor që duhet marrë në konsideratë nga gjykata kur të vendos për dënimin (neni 73(3.6) KP). Shih edhe raportin e OSBE-së Vlerësimi i joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykata (korrik 2010), <http://www.osce.org/kosovo/70907>. Nga, Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri procedurës penale në Kosovë, osbe, Misioni në Kosovë, qershor 2016, fq. 27.

<sup>130</sup> Ibid, Raporti i konsoliduar i KGJK-së (shënimi 9 më lart), f.3

Neni 233(10) i KPP-së ua **ndalon gjyqtarëve pjesëmarrjen në negociatat** për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, por ua lejon atyre që të “caktojnë afat të arsyeshëm kohor, jo më të gjatë se tre (3) muaj, për përfundimin e negociatave në mënyrë që të pengohet zvarritja e procedurës”. Në tri raste të monitoruara nga OSBE-ja gjykata nuk e ka vendosur afatin, por e ka caktuar datën për fillimin e shqyrtimit gjyqësor duke pritur nga palët që të arrijnë marrëveshje në ndërkohë. Një vendim i tillë nuk duket të jetë vendimi i duhur sepse nëse palët nuk arrijnë marrëveshje gjatë asaj periudhe kohore, gjykimi do të filloj pa ia dhënë të pandehurit mundësinë e shfrytëzimit të drejtës së tij/saj, të parashtrimit të kërkesës për hudhjen e aktakuzës apo për t’i kundërshtuar provat para fillimit të shqyrtimit gjyqësor<sup>131</sup>. Të dhëna relevante përmbajnë edhe Raportete tjera të Prokurorit të Shtetit<sup>132</sup>.

**Para ngritjes së aktakuzës**, kur është e përshtatshme dhe në interes publik prokurorët duhet ta marrin parasysh përdorimin e alternativave ndaj gjykimit të parapara në nenin 229 të KPP-së. Janë katër lloje të alternativave. Lloji i parë është - marrëveshja mbi **pranimin e fajësisë**, që është alternativa më e rëndësishme. Prokurorët e kanë mundësinë edhe të **pezullimit të përkohshëm** të procedurës (neni 230 i KPP-së), **heqjes dorë nga ndjekja** kur ajo nuk është e detyrueshme (neni 231 i KPP-së), apo **referimit të rastit në ndërmjetësim** (neni 232 i KPP-së).

Në praktikë, këto alternativa ndaj gjykimit, rrallëherë shfrytëzohen nga prokurorët. Vetëm tre për qind e prokurorëve të anketuar kanë thënë që “shpesh” e **kanë pezulluar** ndjekjen e veprave penale në bazë të nenit 230 të KPP-së, dhe 70 për qind e tyre janë përgjigjur që e bëjnë këtë “rrallëherë apo asnjëherë”. Ngjashëm me këtë, vetëm shtatë për qind e tyre kanë thënë që “shpesh” i referojnë rastet për ndërmjetësim dhe 76 për qind janë përgjigjur që e bëjnë këtë “rrallëherë apo asnjëherë”. Gjithsej 85 për qind e avokatëve të anketuar kanë thënë që ata kanë marr pjesë “rrallëherë ose asnjëherë” në raste ku prokurori e ka pezulluar ndjekjen e një veprave penale në bazë të nenit 230, dhe 86 për qind janë përgjigjur që kanë qenë të përfshirë “rrallëherë apo asnjëherë” në rastet e dërguara nga prokurori për ndërmjetësim.

Sipas statistikave të marra nga KGJK, alternativat ndaj gjykimit (me përjashtim të marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë) janë përdorur në vetëm **gjashtë për qind** të rasteve të cilat i kanë trajtuar prokuroritë në tërë Kosovën, ndërmjet prillit dhe qershorit 2015. Në këtë aspekt, OSBE-ja dëshiron t’i theksoj përpjekjet pozitive të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për rritjen e përdorimit të procedurave alternative në tërë Kosovën, përmes një serie

---

<sup>131</sup> Ibid, Neni 246 thotë që gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri vendos që të mos e pranojë fajësinë, ai/ajo duhet ta ketë të drejtën që të parashtrij kundërshtim ndaj provave dhe të kërkojë hudhjen e aktakuzës. Sipas nenit 254(5) të KPP-së, gjyqtari cakton shqyrtimin gjyqësor nëse kundërshtimet apo kërkesat e tilla janë duke u shqyrtuar. Shih edhe nenin 255(5) i KPP-së thekson që, gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marr aktvendim mbi kundërshtimet e paraqitura nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi.

<sup>132</sup> Republika e Kosovës, Prokurori i Shtetit, Raporti i punës 2020, shkurt 2021, <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files>

të trajnimeve në shtator të vitit 2015, të mbështetura nga OSBE-ja për të gjitha prokuroritë në tërë Kosovën për përdorimin e këtyre procedurave alternative ku është avokuar në masë të madhe për përdorim më të madh të këtyre procedurave nga të gjithë prokurorët.

### 2.3.4 Republika e Shqipërisë

Marrëveshja mbi pranimin e fajit në Republikën e Shqipërisë parashikohet me Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit për procedurë penale (KPP) të viti 2017<sup>133</sup>. Sipas novelës së vitit 2017 palët mund të paraqesin marrëveshje për pranim të fajit dhe përcaktimin e dënimit para gjykatës në **procedurë paraprake**, në bazë të nenin 332c alinea 4 e KPP. Në këtë situatë, gjykatësi i cili udhëheq procedurën paraprake pasi të dëgjojë deklaratat e palëve merr vendim për të dërguar çështjen gjykatës kompetente<sup>134</sup>.

Procedura për marrëveshje për pranimin e fajit dhe përcaktimin e dënimit, parshihet në kaptinën IV të KPP – Gjykimet e veçanta dhe rregullojnë përmbajtjen e marrëveshjes, miratimin, rafuzimin e marrëveshjes si dhe ankesën. Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, **nuk ka dispozita për pezullimin e përkohshëm të ndjekjes penale**.

Karakteristikë e këtij instituti juridik është fakti se marrëveshja për pranimin e fajit mund të arrihet vetëm për vepra penale për të cilat është parashikuar dënim me burg deri 7 vite, por ky kufizim nuk ka të bëjë me bashkëpunëtorët e drejtësisë.

Marrëveshja ka një përmbajtje univezale (neni 406 i KPP – përmbajtja e marrëveshjes), sa u takon aspekteve të cilat ajo i përmban. Në fund të negociimeve prokurori publik duhet ta informojë viktimën ose pasardhësin e tij, për kushtet dhe efektet e marrëveshjes duke i dërguar edhe një kopje të saj.

Gjykata mund ta miratojë ose të refuzojë marrëveshjen. Kjo procedurë është e rregulluar në nenin 406 - e dhe 406 - ë të Ligjit për procedurë penale. Ankimi i vendimt gjyqësorë nuk është i lejuar. Paditësi mund të **anjojë vetëm vendimin e gjykatës që ka të bëjë me hudhjen** (refuzimin) e lëndës. Kjo çështje është normuar në nenin 407 të KPP.

Ligji i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë parasheh mundësinë e një kategorie tjetër të kryerësve të veprave poenale që mund të bëjnë marrëveshje me gjykatën, edhe për vepra për të cilat është **parashikuar dënim më i lartë**. Më konkretisht, kryerësit e veprave penale për të cilat është parashikuar dënim me burg së paku 7 vite. Fjala është për **bashkëpunëtorët e drejtësisë** (neni 406-d KPP). Kjo marrëveshje ka të bëjë me pranimin e fajit dhe përcaktimin e nivelit të dënimit. Mund të arrihet në cilën do fazë të procedurës penale përfshi edhe kur vendimi mer formën e prerë.

Marrëveshja është arritur atëherë kur i akuzuari dëshmon pa rezervë dhe kushte për të gjitha faktet për të cilat ka njohuri dhe për aktivitetet e tij në lidhje me veprimet

<sup>133</sup> Ligji për procedurë penale i Republikës së Shqipërisë Nr.7905/1995; Nr.7921/1995;7977/1995; Nr.8027/1995; Nr.8180/1996; Nr.8245/1997; Nr.8460/99; Nr.8570/2000; Nr.8602/2000; Nr.8813/2002; Nr.9085/2003; Nr.9187/2004; Nr.9276/2004; Nr.9911/2008; Nr.10054/2008; Nr.145/2013; Nr.21/2014; Nr. 99/2014; Nr.35/2017.

<sup>134</sup> Neni 332 – Vendimi i gjykatësit të procedurës paraprake.

kriminale. Nga ana tjetër dëshmimi i tij duhet të jetë dëshmi kryesore, për faktet dhe kryerësit e veprave penale, i rëndësishëm për parandalimin e veprave të rënda penale si dhe sanimin e dëmit të shkaktuar.

Sipas KPP, Marrëveshja për bashkëpunim tërhiqet nëse bashkëpunëtori i drejtësisë i thyen kushtet e bashkëpunimit, msheh të dhëna për fakte të cilat janë të rëndësishme për akçjykimin ose jep dëshmi të rreme<sup>135</sup>. Kur kontrata për bashkëpunim është arritur gjatë egzekutimit të vendimit, kërkesën e paditësit e shqyrton trupi gjykues që ka mirratuar vendimin ose gjykata në vendin e egzekutimit të vendimit.

Kodi për procedurë penale i Republikës së Shqipërisë njeh edhe një institut tjetër që ka të bëjë me përshpejtimin dhe ekonomizimin e procedurës penale. Fjala është për **gjykimin e shkurtuar**, i cili i jep mundësinë të akçzuarit për përshpejtimin e procesit të gjykimit dhe për të përfituar një ulje dënimi me 1/3 (neni 406/1), duke pranuar të gjykohet nga provat e paraqitura nga akuza. Pas ndryshimeve të fundit të KPP të cilat hynë fuqi me 1 gusht 2017, ligji nuk e lejon kërkesën për gjykim të shkurtuar, vetëm për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm<sup>136</sup>. Kjo procedurë fillon me kërkesën për gjykim të përshpejtuar që parashihet në nenin 403 /1 të KPP. Gjykata shqyrton kërkesën dhe merr vendimin për ta pranuar ose jo gjykimin e çështjes në formë të përshpejtuar, bazuar mbi aktet e sjella nga Prokuroria.

Një element i rëndësishëm procedural i gjykimit të shkurtuar sipas intepretimit të gjykatës ishte edhe **dhënia e konsensusit të prokurorit**. Duhet cilësuar se dhënia e mendimit nga prokurori është një e drejtë procedurale që buron nga parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, por nuk është kusht për pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Ky element është rrëzuar me ndryshimet e KPP në vitin 2017. Ligji nuk ishte shumë i qartë në këtë drejtim pasi termi i përdorur në KPP ishte se prokurori “shfaq mendimin për kërkesën e të pandehurit”. Pra gjykata ishte e detyruar të marrë mendimin e prokurorit por jo domosdoshmërisht konsensusin e tij (neni 405/6 i KPP).

Në lidhje më këtë çështje **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë** në Vendimin e tij Unifikues Nr. 2 datë 29.01.2003 ishte shprehur se: “Në interpretim të pikës 6 te nenit 404 te KPP konsensusi i prokurorit nuk është kusht i domosdoshëm që gjykata të pranojë kërkesën e të akçzuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kjo justifikon edhe të drejtën që ka prokurori për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës për pranimin e gjykimit të shkurtuar, ankim që mund të paraqitet së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar”<sup>137</sup>.

Pas ndryshimeve të fundit të KPP të cilat hynë fuqi me 1 gusht 2017, ligji nuk lejon kërkesën për gjykim të shkurtuar vetëm për veprat penale për të cilat parashikohet dënim

---

<sup>135</sup> LPP, neni 480ë.

<sup>136</sup> KPP - Ligji nr. 35/2017, neni 403 pika 2.

<sup>137</sup> Drejtësia penale në Shqipëri, Vlerësimi i përgjigjes së sistemit gjyqësor ndaj trafikut të narkotikëve, Fondacioni Shoqëria e hapur për Shqipërinë, fq. 71,

me burgim të përjetshëm<sup>138</sup>. Gjykimi shkurtuar në ndryshim nga gjykimi i zakonshëm shmanget debatimin e provave në seancën gjyqësore duke shkurtuar kështu kohën e gjykimit. Në pamje të parë procedura e gjykimit të shkurtuar duket sikur lë hapsirë për abuzivitet nga ana e të akuzuarëve për vetë uljen e konsiderueshme të dënimit, që veprat penale përfshirë dhe ato të kryera në kuadrin e bashkëpunimit të veçantë përfitojnë. Një ndër shqetësimet e ngritura në literaturë ka qënë “amerikanizimi” i gjykimit të shkurtuar në vendet europiane dhe ulja e efekteve parandaluese të gjykimit të shkurtuar në luftën kundër krimit, duke pasur parasysh se të akuzuarit për krime të rënda do të marrin dënime të reduktuara dhe do të dalin më shpejt nga vuatja e dënimit<sup>139</sup>

Por nga ana tjetër, gjykimi i shkurtuar është parë si një procedurë efektive në luftën kundër krimit duke pasur parasysh shpesh limitet që kanë agjencitë ligjzbatuese në luftën kundër krimit të organizuar dhe proceset e zgjatura për vetë natyrën e tyre komplekse që ato kanë. Njëpërmjet gjykimit të shkurtuar mendohet që numri i të dënuarve të jetë më i madh. Sidoqoftë në modelin e aplikuar nga Yehonatan Givati (2011) për të matur efektet dhe qasjen e juridiksioneve të ndryshme ndaj gjykimit të shkurtuar (guilty plea), studimi i Givati konkludon se qasja ndaj gjykimit të shkurtuar lidhet ngushtë me politikën penale të vendeve të ndryshme. Sipas tij në ato vende ku synimi kryesor i politikës penale është dënimi i fajtorit dhe jo mos dënimi i të pafajshmit, numri i rasteve të gjykimit të shkurtuar pëson rritje. Gjithashtu modeli i Givati (2011) parashikon se rritja e kriminalitetit çon në rritjen e përdorimit të gjykimit të shkurtuar<sup>140</sup>.

Kërkesën për gjykimin e shkurtuar, aprovimin, zbatimin e gjykimit të shkurtuar, statistikave dhe efektete arritura, si dhe mospranimi i kërkesave për gjykim të shkurtuar në Republikën e Shqipërisë, kanë kaluar nëpër një proces teoriko-praktik ku vërehet roli aktiv i Gjykatës së lartë nëpërmjet Vendimeve unifikuese<sup>141</sup>.

Gjykata e lartë e Republikës së Shqipërisë, ka marrë një “Qëndrim unifikues” në lidhje me gjykimin e shkurtuar<sup>142</sup>. Në këtë mendim unifikues, gjykata deklorohet për situatën, kur mund të aplikohet gjykimi i shkurtuar, konkretisht si vepron gjykata kur ka më shumë të pandehur dhe vetëm disa nga ata kërkojnë gjykim të posaçëm. Mandej situatën, kur për një të pandehur ka më shumë se një akuzë, nevojën e egzistimit të konsenzusit të prokurorit dhe të drejtës së tij për ankim dhe në fund prononcim në lidhje me mënyrën e aplikimit të

---

<sup>138</sup> KPP - Ligji nr. 35/2017, neni 403 pika 2.

<sup>139</sup> Drejtësia penale në Shqipëri, Vlerësimi i përgjigjes së sistemit gjyqësor ndaj trafikut të narkotikëve, Fondacioni Shoqëria e hapur për Shqipërinë, fq. 70, Langer, M (2004) “From Legal Transplants to Legal Translations: The Globalization of Plea Bargaining and the Americanization Thesis in Criminal Procedure”. Harvard International Law Journal, 45.1-64, [https://www.osfa.al/sites/default/files/drejtësia\\_penale\\_ne\\_shqiperi.pdf](https://www.osfa.al/sites/default/files/drejtësia_penale_ne_shqiperi.pdf).

<sup>140</sup> Ibid, fq.70

<sup>141</sup> Më detajisht shih, Drejtësia penale në Shqipëri, Vlerësimi i përgjigjes së sistemit gjyqësor ndaj trafikut të narkotikëve, Fondacioni Shoqëria e hapur për Shqipërinë, fq. 71-79.

<sup>142</sup> Republika e Shqipërisë, Gjykata e lartë, Standardet e gjykimit civil, administrativ dhe penal, përmes vendimeve unifikuese të Gjykatës së lartë 2000- 2014, 2014, fq.463-468, Vendimi nr.2 datë 29.01.2003.

dënimit, kur i pandehuri deklarohet fajtor për disa vepra penale. Në këtë raste, duhet fillimisht të caktohet dënimi për çdonjërin nga këta vepra penale dhe pasi që të aplikohet bashkimi i dënimeve sipas nenit 55 të Kodit penal bëhet zbritja nga dënimi i bashkuar me një të tretën.

**Vlerësimi i kolegjeve të bashkuara:** Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonominë gjyqësore sepse shkurton dhe thjeshtëson procedurat. Rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe si pasojë sjell një përfitim për të pandehurin, në shqiptimin e 1/3 të masës së dënimit dhe mos aplikimin e dënimit me burg të përjetshëm. Është me rëndësi të theksohet se ky përfitim nuk duhet të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë. Për këtë qëllim, gjykata kërkesën e të pandehurit e pranon vetëm atëherë kur ajo paraprakisht bindet se mund ta përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qënë nevoja për t'ia nënshtruar ato shqyrtimit gjyqësor<sup>143</sup>. Gjykimi i shkurtuar si gjykim i posaçëm në thelb ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me ato<sup>144</sup>, si dhe kërkesat lidhur me pavlevshmërinë e tyre.

### **Kapitulli III - Pranimi i fajit në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

#### **3.1 Gjenezja dhe aspektet e përgjithshme normative të pranimit të fajit në RMV.**

Me Ligjin për procedurë penale<sup>145</sup> instalohet një sistem i ri i procedurës penale i bazuar në të drejtëm anglosaksone, duke marrë si shembull Ligjin për procedurë penale të Italisë, Austrisë, Gjermanisë, SHBA -ve , Bosnjë e Hercegovinës, Koacisë dhe Sërbisë.

Idea kryesore e kësaj reforme ishte menjanimi i paternalizmit gjyqësorë gjegjësisht rolit të gjykatës në vërtetimin e gjendjes faktike, zmadhimin e efikasitetit, si dhe avancimin e të drejtave të akuzuarit. Kjo procedurë mer premisa të dukshme të një procedure akuzatore me rol të theksuar të barabarësisë procedurale dhe parimit kontardiktorë<sup>146</sup>.

Qëllimi i kësaj reforme mes tjerave ishte modernizimi i procedurës penale dhe zmadhimi i efikasitetit të sistemit penalo-juridik, mes tjerave edhe me parashikimin e marrëveshjes në procedurë penale, pranimit e fajit dhe instituteve tjera penalo-juridike.

Risi e këtij Ligji është miratimi i aktgjykimit në bazë të pranimit të fajit nga i akuzuari në fazën e seancës kryesore, kur ende nuk ka filluar procedura dëshmuuese (neni 381 i LPP), si dhe rastet tjera ku parashikohet aktgjykim në bazë të pranimit të fajit dhe marrëveshjes

<sup>143</sup> Neni 403/2 i Ligjit për procedurë penale.

<sup>144</sup> Shih, Procedura e shkurtuar LPP i RMV

<sup>145</sup> Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, 150/2010,

<sup>146</sup> Закон за кривичната постапка, Проф.д-р Гордана Калајџиев & Проф.д-р Гордана Лажетик Бужаровска, Скопје, април 2011, fq. 11.

klasike me prokurorin publik, që më von gjen verifikim nga gjykata. Aktgjykimi në bazë të pranimit të fajit, e obligon gjykatën në seancën kryesore të nxjer vetëm dëshmitë që kanë të bëjnë me sanksionin penal, jo edhe dëshmitë që kanë të bëjnë me fajin dhe përgjegjësën penale të të akuzuarit.

Ky institut penalo juridik gjenezën e saj e ka te parimi i oportunitetit, i instaluar që me Ligjin për procedurë penale nga viti 1997<sup>147</sup>. Neni 145 dhe 146 i LPP (2004) mundësojnë zgjerim të bazës tradicionale për mosndjekje për qëllime të arsyeshme, për veprat penale më të vogla dhe për mbrojtjen e interesave të të miturit i njohur si parim i **oportunitetit përkundër parimit të legalitetit**, që në kushtet e veprimit të sotëm është jo i realtë. Në të gjitha sistemet moderne kërkohen forma të ndryshme të shkurtimit të procedurës penale, përsheptim dhe thjeshtëzim të procedurës penale dhe kahëzim të procedurës penale kah format tjera alternative të zgjedhjes së lëndëve siç janë medijacioni<sup>148</sup> dhe kompenzimi i dëmit. Kjo veçanërisht ka të bëjë me veprat penale më të lehta dhe mundëson fokusim të organeve gjyqësore ndaj lëndëve ku dominon kriminaliteti i llojit të lartë, gjithsesi duke mos anashkaluar interesin publik dhe të dëmtuarit.

Ky **diskrecion i gjërë i ndjekjes penale** nuk shkon në dëm të parimit të barabarësisë. Ky përcaktim gjen mbështetje edhe në akte dhe dokumentet e Këshillit të Europës, në veçanti Rekomandimi P(87)18 i Komitetit të ministrave për thjeshtësimin e procedurës penale, që i parashikon masat si vijon: zgjerimin e aplikimit të parimit të oportunitetit në ndjekje penale; procedurë të shkurtuar për vepra minore ose vepra në masë; marrëveshje jashtëgjyqësore në mes organeve kompetente dhe organeve tjera, si këmbim për ndjekje penale; aplikimin e procedurave të thjeshtëzuara për vepra penale minore në masë (vepra penale në komunikacion, doganë, fiskale).

Ligji për procedurë penale **parimin e oportunitetit** e njeh si: anulim të ndjekjes penale me kusht dhe mos ndjekje penale gjegjësisht pushimin e procedimit. Në këtë drejtim, e drejta restorative paraqet një parapërgaditje për aplikimin e medijacionit dhe marrëveshjes në procedurë penale. Edhe pse egzistojnë definicione të ndryshme, të drejtën restorative e karakterizon reparacioni gjegjësisht vendosja e paqes, reintegrimi i kryerësit të vepërës penale në bashkësi, nëpërmjet pjesmarjes aktive dhe të drejtëpërdrejtë të dëmtuarit, kryerësit të veprës penale dhe bashkësisë me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje. Rrënjët e këtij instituti penalo juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut i gjejmë te Ligji për këshilla paqësorë (Gazeta zyrtare e RM nr. 39/77).

Novela e LPP e vitit 2004 edhe më shumë e afirmon të drejtën restorative, duke zgjeruar parimin e oportunitetit nëpërmjet institutit Urdhëresë dënuese (ndëshkuese), gjegjësisht duke parashikuar norma të veçanta për **miratimin e aktgjykimit pa shqyrtim kryesorë** dhe shqiptimin e masave alternative. Ky trend i së drejtës restorative vërehet edhe

---

<sup>147</sup> Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 15/03, neni 145-146

<sup>148</sup> Shih neni, 475 – procedura e shkurtuar (medijacioni) dhe 491-496 procedura për medijacioni i LPP i RM (2010)

te Ligji për të drejtën e të miturve<sup>149</sup> i cili e afirmon pozitën e të dëmtuarit nga njëra anë, ndërsa në anën tjetër kryerësit i jepet mundësi që në mënyrë aktive të mer pjesë në procedurë, në lidhje me pranimin e përgjegjësish dhe sanimin e dëmit si dhe resocializimin e tij<sup>150</sup>.

Në pozicion të njejtë janë edhe normat e Kodit penal (2004)<sup>151</sup>, neni 43-a; 58-a; 58-b alinea 3. Këto përcaktime ligjore mundësojnë që një pjesë e konflikteve penale të zgjidhen nëpërmjet ndërmjetësimit dhe me pjesëmarrje të kryerësit të veprës penale dhe të dëmtuarit si alternativë e së drejtës penale tradicionale, gjithnjë duke mbajtur llogari për interesin publik që është i garantuar me vetë faktin, që ky ndërmjetësim është në kuadër të kushteve ligjore, dhe në procedurë adekuate, përkundër disa pretendimeve për mundësinë e realizimit të ndërmjetësimit në mes viktimës dhe kryerësit të veprës penale para se të paraqitet vepra penale tek organet kompetente<sup>152</sup>, siç është rasti në të drejtën penale Hollandeze.

Medijacioni si model i ndërmjetësimit dhe pajtimit të viktimës dhe kryerësit të veprës penale, paraqet zgjidhje alternative të situatave kriminale dhe eviton shqiptimin e dënimeve me burg me kohëzgjatje të shkurtër. Ky institut në Republikën e Maedonisë filloi të aplikohet me miratimin e Ligjin për mediacion<sup>153</sup>. Me Ligjin për procedurës penale (2010) medijacioni aplikohet edhe në procedurë penale për veprat penale të cilat ndjeken me padi private<sup>154</sup> (neni 491 LPP), dhe i rregullon kushtet e medijacionit, procedurën deri te arritja e marrëveshjes, mbarimin e procedurës së medijacionit dhe nënshkrimin e marrëveshjes me shkrim.

Praktika gjyqësore manifeston dobite e medijacionit, si në drejtim të thjeshtëzimit të procedurës penale pashtu edhe nga aspekti i statusit të pjesëmarrësve në procedure dhe në veçanti evitimin e elementeve punitive të procedurës penale dhe humanizimin e mëtutjeshëm të saj. Egzistojnë autorë që kontestojnë këtë institut duke shprehur rezervë në aspekt të veprave penale ndaj të cilave mund të aplikohet dhe mundësisë në këtë procedurë të marrë pjesë ndonjë person i pafajshëm<sup>155</sup>.

Me Ligjin e ri për procedurë penale **parashikohet marrëveshja në procedurë penale**, në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit/mbrojtjes, si institut i veçantë penalo juridik. Në

<sup>149</sup> Gazeta zyrtare e RM, nr.87/07.

<sup>150</sup> М-р Стојанка Мирчевска, МРКПК Бр.2 2007 стр.263

<sup>151</sup> Gazeta zyrtare e RM nr.19/04

<sup>152</sup> Проф д-р Оливер Бачановиќ, Новините во положбата на оштетениот во кривичната постапка, МРКПК Бр.2, 2007, страна 219. Shih më lartë Marrëveshja jashtëgjyqësore – Hollandë.

<sup>153</sup> Gazeta zyrtare e RM nr. 60/2006; 22/2007; 114/2009 nga 14.09,2009.

<sup>154</sup> Kryesisht ka të bëj me veprat penale kundër nderit, deliktet e pasurisë dhe veprat kundër lirive dhe të drejtave të njeriut për të cilat është parashikuar dënim në të holla ose dënim me burg deri më 3 vite. Shih: Сотироски & Ѓуркова 2011, страна 92.

<sup>155</sup> Dr Zeljko Horvatić, Posebni slučajevi odustajanja od gonjenja i mirenja u krivičnim stvarima, JRKK, 1-2/82, str.176.d.

nenin 39 të LPP i cili i regullon të drejtat dhe obligimet e prokurorit publik parashikohet mundësija gjegjësisht e drejta, që ai të negociojë dhe të bëjë marrëveshje me të akuzuarin për pranimin e fajit sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj (neni 39 alinea 2 pika 8), me çka afirmohet **parimi i dispozicionit të vullnetit të palëve**, në drejtim të inicimit dhe pjesmarjes në procedurë për marrëveshje. LPP i ri, marrëveshjen e rregullon në kaptinën XXIX – Miratim të aktgjykimit në bazë të marrëveshjes me prokurorin publik dhe të akuzuarit.

LPP, karakterizohet me një koncept më të gjërë sa i takon pranimit të fajit, formave të manifestimit të tij, fazat e procedurës penale ku zhvillohet kjo procedurë, roli i palëve dhe gjykatës, si dhe forma dhe veprimet para se të miratohet aktëgjykimi.

Sipas prof d-r Gordana Buzharovska dhe Asist.d-r Gorasn Misoski normat e Ligjit të ri të procedurës penale në RM, e vëndojnë konceptin e së drejtës penale në kuadër të sistemeve eurokontinentale moderne, me elementa të shprehura akuzatore që ka për qëllim zmadhimin e efikasitetit dhe ekonomizimin së drejtës penale, si dhe obligimin për respektimin garancive për mbrojtje të të akuzuarit dhe të drejtat e të dëmtuarit.

Marrëveshja për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal mund të aplikohet në mënyrë të suksesshme në praktikë, nëse secili subjekt është mirë i udhëzuar dhe në mënyrë aktive i shfrytëton mundësitë ligjore që i mundëson marrëveshja, a ajo nënkupton inicijativitet dhe fleksibilitet të palëve dhe ndjenjë tek gjykatësi gjatë vlerësimit të propozim-marrëveshjes. E pakontestueshme është se vetëm aplikimi i drejtë i marrëveshjes në praktikë do të mundësojë procedurë penale të shpejtë dhe efikase, që nuk do të jetë në dëm të veprimit të drejtë dhe matjes së drejtë të sanksionit penal<sup>156</sup>.

Edhe pse duket se marrëveshja në procedurë penale konfrontohet me postulatet kryesore të së drejtës penale klasike që njihet për hapësirat Europiane, në më shumë vende të Europës, një kohë më të gjatë ky institut është i parashikuar dhe shënon praktika të pasura për shqiptimin e sanksioneve në bazë të propozimit të palëve. Procedurat e thjeshtëzuara në të drejtën komparative (Gjermani, Itali, Francë, Norvegji, Hollandi, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe Sërbi), janë rezultat i përpjekjeve për përsheptimin dhe efektuimin e së drejtës penale procedurale, a me atë edhe të drejtës penale. Zgjidhjet e reja me të cilat thelbësisht reformohet veprimi procedural në bazën e tij kanë institute anglosaksone, të cilat kanë një traditë shumvjeçare në shtetet e common law, me një adaptim të tyre përkundër praktikave juridike europiane.

E drejta penale tradicionale dhe praktika gjyqësore karakteristike për hapësirat europiane, vite të tëra kundërshton marrëveshjen në procedurë penale gjësisht të drejtën konsensuale, duke u bazuar në përcaktimin se reagimi ndëshkues është përcaktuar në mënyrë decide me ligj dhe nuk njihet dialog, kompromis, as marrëveshje, duke pasur parasysh faktin se qëllimi kryesorë është mbrojtja fundamentale e vlerave sociale. E drejta kontaktuese duhet të kuptohet si mënyrë për adaptimin e procedurës ndaj veçorive të rastit. Ajo nxit inicijativitet të palëve dhe gadishmëri të tyre për të pranuar propozimin e palës

---

<sup>156</sup> Prof d-r Gordana Buzharovska dhe Asist.d-r Gorasn Misoskiojednostavljene forme postupanja kao bitno obelezje reformi krivicnog procesnog zakonodavstva yemalja regiona, Osce Misija u Srbiji, Beograd 2013, fq. 214.

tjetër, për të negociuar, dhe për të gjetur zgjidhje kompromisi në kuafidër të autorizimeve të palëve në pajtim me ligjin<sup>157</sup>

### **3.2 Kushtet dhe mënyra e aplikimit të pranimit të fajit në procedurë penale ne RMV.**

Pranimi i fajit në procedurë penale të Republikës së Maqedonisë së veriut detajisht është rregulluar me Ligjin për procedurë penale (2010). Aplikimi i këtij instituti penalo-juridik, (pranimi i fajit) nuk është i kufizuar në aspekt të natyrës dhe rëndësisë së veprës penale dhe mund të përfshijë një apo më shumë vepra penale pjesë përbërëse e aktakuzës.

Ligji për procedurë penale marrëveshjen e rregullon në kaptinën XXIX – Miratim të aktgjykimit në bazë të marrëveshjes me prokurorin publik dhe të akuzuarit.

Mënyra dhe kushtet e pranimit të fajit në mënyrë të detajuar janë të regulluara në LPP, neni 381<sup>158</sup>. LPP për herë të parë parshikon mundësinë e arritjes së marrëveshjes në mes mbrojtjes dhe prokurori si institut i marë nga e drejta anglosaksone. Ky institut penalo juridik mundëson thjeshtësimin e procedurës penale në situata kur dëshmitë dhe faktet janë të pakontestueshme. Gjithashtu, mundëson një fund më të parashikueshëm të procedurës penale, rritjen e efikasitetit të procedurës penale dhe arritjes së drejtësisë penale në afat sa më të shkurtër. Këtë institut penalo juridik e karakterizon **parimin i dispozicionit të vullnetit të palëve**, në lidhje me iniciimin dhe arritjen e marrëveshjes.

Edhe pse këta janë attribute të procedurës civile, me aplikimin e këtij instituti në procedurë penale shumica e autorëve<sup>159</sup>, mendojnë se nuk bëhet privatizimi i drejtësisë penale dhe nuk humbet atributi publik i procedurës penale. Ky lloj marrëveshje gjen mbështetje edhe në Rekomandimin Nr. P (87) 18 të Komitetit të ministrave të shteteve anëtarë, për thjeshtëzimin e së drejtës penale, i cili promovon zgjidhje që tejkalojnë formalizmin dhe stërzgjatjen e procedurave penale duke përsheptuar atë, si dhe shqiptimin e sanksionit pa u vërtetuar gjendja faktike nga gjykata.

Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë varësisht nga fazat e zhvillimit të procedurës penale dhe aspektet procedurale të aktorëve procesual njihet tre forma - procedura të pranimit të fajit.

---

<sup>157</sup> Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калаџиџев, Гордан 2. Лажетик, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Делџо, страна 964,

<sup>158</sup> Gazeta zyrtare 150/10.

<sup>159</sup> Проф.д-р Гордана Калаџиџев & Проф. д-р Гордана Лажетик Бужаровска, Закон за кривичната постапка, Скопје, април 2011, fq. 68 ; Dr. sc. Zvonimir Tomičić Viši asistent Pravnog fakulteta Sveučilišta Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku Ante Novokmet, mag. iur. Asistent Pravnog fakulteta Sveučilišta Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku, Pregledni znanstveni rad UDK 343.13:343.15

Në sistemin penal procedural të Maqedonisë, deklaratat për pranimin e fajit paraqitet si parakusht i një koncepti më të gjërë të thjeshtëzimit dhe përsheptimit të procedurës penale, që identifikohet me marrëveshjen në procedurë penale dhe pranimin i fajit, si institute të veçanta penalo juridike. Kjo e fundit për herë të parë manifestohet para gjykatës varësisht fazës në të cilën ndodhet procedura penale. E përbashkët e këtyre procedurave është deklarata për pranimin e fajit. Mes këtyre dy formave të përsheptimit të procedurës penale, egzistojnë dallime procedurale – formale, që kanë të bëjë me mënyrën e ardhjes deri tek vendimi gjyqësorë pa u mbajtur shqyrtimi kryesorë dhe vërtetimi i fakteve, por e përbashkëta e të dy formave të deklarimit, është fakti që prokurori publik nuk obligohet të dëshmojë pretendimet e tija jasht dyshimit të arsyeshëm, si standard që duhet të plotësohet gjatë shqyrtimit kryesorë. Këtu vijnë në shprehje edhe dallimet nga aspekti i së drejtës për ankim.

Për dallim nga marrëveshja gjatë procedurës hetuese në të cilën deklarata për pranimin e fajit nuk është parakusht për fillimin e saj, kjo nuk është rast në fazën e vlerësimit të aktakuzës nga gjykatësi gjegjësisht këshilli për vlerësimin e aktakuzës. Në këtë stadium të procedurës, miratimi i vendimit me propozim – marrëveshje mes palëve është i mundur vetëm me iniciativë të mbrojtjes gjegjësisht pasi që i akuzuari të shpreh gadishmëri të pranojë veprën e përmbajtur në urdhëresën për zhvillimin e procedurës hetuese. Me fjalë tjera deklarata për pranimin e fajit është parakusht për realizimin e procedurës për pranimin e fajit<sup>160</sup>. Ligji për procedurë penale parashikon disa forma gjegjësisht faza të procedurës penale ku i pandehuri mund të deklarojë pranimin e fajësisë.

#### **Deklatë për pranimin e fajit pas pranimit të akt-akuzës.**

Sipas nenit 326 alinea 1 pika 2 - I akuzuari mund të paraqet deklaratë për pranimin e fajit në pajtueshmeri me nenin 329 të këtij ligji. Ky nen mban titullin – Veprimi i të akuzuarit pas pranimit të akt-akuzës.

Mundësia e parë për deklarim për pranimin e fajit nga i akuzuari është në afat prej 8 ditësh pas pranimit të aktakuzës, duke i pranuar të gjitha ose vetëm ndonjërin nga veprat penale të përmbajtura në aktakuzë (neni 330 i LPP të RM). Kjo deklarata jepet nëpërmjet mbrojtësit në prezencë të prokurorit publik në seancë gjyqësore. Në seancën për vlerësimin e aktakuzës (332-333 alinea 3) i dyshuari mund të deklarojë se ndjehet fajtorë për të gjitha ose një pjesë të veprave penale nga aktakuza. Në situata të tilla seanca vazhdon në pajtueshmëri me nenin 334 të këtij ligji.

Pas pranimit të kësaj deklarata gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës do të verifikojë (neni 334):

1) A është e dhënë deklarata për pranimin e fajit vullnetarisht, me vetëdije dhe kuptim të pasojave të veprës duke përfshirë edhe pasojat që kanë të bëjnë me kërkesa pronësore – juridike dhe shpenzimet e procedurës, 2) A egzistojnë dëshmi të mjaftueshme për fajin e të akuzuarit.

---

<sup>160</sup> Kallajxhiev, fq, 74.

Deklarata për pranimin e fajit që nuk pranohet nga gjykata konstatohet në procesverbal dhe e njejta nuk mund të përdoret si dëshmi në rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës penale. Që të garantohet kjo e drejtë procedurale gjykatësi ose këshilli për vlerësimin a aktakuzës, procesverbalin për pranimin e fajit do ta mbyll në mbështjellës të veçantë, dhe do ta ndajë nga shkresat e lëndës (neni 334 alinea 6)<sup>161</sup>.

Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës e **pranon deklaratën** për pranimin e fajit, me propozim të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ose të prokurorit publik, mund të kërkohej anulim i seancës për realizimin e procedurës për marrëveshje dhe dorëzim të propozim marrëveshjes, në pajtueshmëri me nenin 483-490 të LPP. Në këtë situatë gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës do ta anulojë seancën për 15 ditë. Propozim për anulim të seancës për vlerësimin e aktakuzës për shkak të realizimit të procedurës për marrëveshje mund të jap njëra nga palët. Nga kjo rrjedhe se për dallin nga procedura për marrëveshje në procedure hetimore e cila nuk është e kushtëzuar me koh, në fazën e vlerësimit të aktakuzës ajo është e kufizuar në 15 ditë.

Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës nuk e pranon deklaratën për pranimin e fajit, atë e konstaton në procesverbal, i informon palët e pranishme dhe vazhdon procedura për vlerësimin e aktakuzës (neni 334 alinea 5).

Nëse në seancë është paraqitur propozim – marrëveshja me elementet e parashikuara në nenin 485 të LPP, gjykata bën vlerësimin e saj. Nëse e pranon propozim marrëveshjen gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës miraton aktgjykim në bazë të nenit 490 të LPP. Ndërsa nëse nuk e pranon propozim marrëveshjen, pasi që e vlerëson si të pa pranueshme, të pa bazë ose në kundërshtim me Kodin penal, gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës sjell **vendim për mos pranimin e propozim marrëveshjes** dhe vendos në lidhje me aktakuzën (neni 335 i LPP). Edhe në këtë rast procesverbali për pranimin e fajit dhe propozim marrëveshja do të mbyllën në mbështjellës të posaçëm dhe ndahet nga shkresat dhe nuk mund të përdoren si dëshmi në procedurën e mëtutjeshme.

Kur gjykata e vlerëson si të bazuar propozim - marrëveshjen, të pranueshme dhe konform normave të Kodit penal, duke pasur parasysh edhe sanksionin e propozuar, gjykatësi ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës do të sjell akt-gjykim të bazuar mbi propozim marrëveshjen. Në këtë situatë palët nuk kanë të djetën e ankimit.

Duke u bazuar në nenin 333 alinea 3 e LPP, në seancën për vlerësimin e aktakuzës i akuzuari mund të jep deklaratë se ndjehet fajtorë, për të gjitha ose një pjesë të veprave penale nga aktakuza. Kjo situatë paraqet një **mundësi të dytë** për dhënie të deklaratës për pranimin e fajit. Kjo është parashikuar për raste kur i akuzuari pas pranimit të aktakuzës nuk ka shfrytëzuar mundësinë të paraqet deklaratë për pranimin e fajit dhe një vendim të tillë ka marrë në seancë para gjykatësit ose këshillit për vlerësimin e aktakuzës. Nëse në këtë seancë i akuzuari deklorohet i fajshëm për të gjitha ose një pjesë të veprave penale, veprimi i

---

<sup>161</sup> Shih, Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајџиев, Гордан 2. Лажетиќ, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Делџо, fq.697.

gjykatës vazhdon sipas normave të LPP që kanë të bëjnë me procedurën për seancën për vlerësimin e propozim-marrëveshjes në fazë të vlerësimit të akt-akuzës.

Me nenin 355 rregullohet procedura pas paraqitjes së propozim – marrëveshjes. Këta norma paeashikojnë se kush mund të paraqesë propozim-marrëveshje, elementet e marrëveshjes (sipas neint 485) dhe kush e vlerëson propozim marrëveshjen (gjykatësi ose këshillit për vlerësimin e aktakuzës), vendimet që mund të merren gjegjësisht të pranohet ose jo propozim marrëveshja, si dhe obligimi për ndarjen e procesverbalit për pranimin e fajit nga shkresat e lëndës, në raste kur ajo deklaratë nuk pranohet nga gjykatësi ose këshillit për vlerësimin e aktakuzës, dhe pamundësija që kjo deklaratë të përdoret gjatë procedurës së mëtutjeshme. Do me thënë, neni 335 i LPP i parashikon garancite procesuale, të drejtat dhe obligimet e palëve dhe në veçanti rolin e gjykatësit ose këshillit për vlerësimin e aktakuzës. Gjykatësi është e obliguar të vlerësojë arsyeshmërinë e propozim-marrëveshjes para se të miratojë vendimin në seancën e caktuar<sup>162</sup>.

Në kaptinën XXIV – **Shqyrtimi kryesorë**, pika 6 (fillimi i seancës kryesore) është sistemuar obligimi i trupit gjykues gjegjësisht kryetari, të njohtojë të akuzuarin për të drejtën e prononcimit për fajësi. Kështu sipas nenit 380 alinea 3, kryetari i këshillit do ta ftojë të akuzuarin të prononcohet për të gjitha veprat penale në aktakuzë, në kuptim se a ndjehet fajtorë ose jo<sup>163</sup>. **Kjo paraqet mundësinë e fundit për pranimin e fajit** edhe atë pasi që palët të japin fjalët hyrëse dhe para se gjykata të sjell vendim për fillimin e procedurës dëshmuese.

Për dallim nga procedura e vlerësimit të aktakuzës, ku i akuzuari vetë mer vendim se a do të parashtroj ankesë ose deklaratë për pranimin e fajit, në shqyrtim kryesorë në bazë të të drejtave që i ka në dispozicion i akuzuari, gjykatësi do ta ftojë atë, të deklarohe nëse ndjehet fajtorë ose jo, për të gjitha apo një pjesë të veprave penale të përfshira në aktakuzë. Vendimi për pranimin e fajit varet nga i akuzuari. Nëse ai pranon fajin gjykatësi është i obliguar të vlerësojë nëse i akuzuari është deklaruar në mënyrë vullnetare dhe është i vetëdijshëm për pasojat juridike dhe pasojat tjera.

Në këtë stadium të procedurës **nuk kemi propozim - marrëveshje**, por gjykatësi vepron pas deklaramit të akuzuarit për pranimin e fajit. Gjykatësi vepron në mënyrë të njejtë sikur në fazën e vlerësimit të aktakuzës. Nëse pranim i fajit vlerësohet si i papranueshëm, gjykata vazhdon aty ku ka ngelur gjegjësisht me realizimin e procedurës dëshmuese, nxjerjen e dëshmive të propozuara nga palët dhe të pranuar nga gjykata. Edhe në këtë situatë, gjykata është e obliguar që deklaratën për pranimin e fajit ta veçojë në mbështjellës të

---

<sup>162</sup> Shih, Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајциев, Гордан 2. Лажетиќ, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Делџо, fq.704.

<sup>163</sup> Ibid, fq. 767. Në lidhje me momentin kur i akuzuari ftohet të deklarohe për ate se a është fajtor, praktika nuk është e ndryshme. Edhe pse në ligj në mënyrë të qartë është theksuar se ajo bëhet pas fjalëve hyrëse të paditësit, shum herë ndodh që kryetari i këshillit të kërkojë që i akuzuari të prononcohet për fajin pasi që të jepen fjalët hyrëse edhe të mbrojtjes. Një praktikë e tillë është jo e drejtë pasi që deklarimin për fajin i akuzuari duhet ta bëj në fillim të seancës kryesore, pasi të jepen fjalët hyrëse të paditësit dhe pasi që gjykata ka njohtuar të akuzuarin për të drejtat e tij dhe është vertetuar se ai ka kuptuar aktakuzën dhe e din se pse akuzohet.

veçantë dhe kushtu konsiderohet se deklarata për pranimin e fajit nuk është dhënë, dhe e njejta nuk mund të përdoret në procedurën e mëtutjeshme.

Nëse deklarata për pranimin e fajit vlerësohet si e pranueshme, gjykata e fillon procedurën dëshmuese po dukshëm të racionalizuar, sa u takon dëshmive që do të nxjeren. Në këtë rast nxiren dëshmitë që kanë të bëjnë me vendimin për sanksionin, e më pas gjykata sjell aktgjykim që i përmban elementet e aktgjykimit dënues. Në këtë rast i akuzuari nuk mund të parashtrojë ankesë për gjendjen faktike<sup>164</sup>.

Më rëndësi për aplikimin e këtij instituti juridik është praktika gjyqësore, veçanërisht praktika e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në Sentencën e miratuar nga dhoma penale pranë Gjykatës supreme, në lidhje me lëndën KVP1 Nr.28/2015 potencohet si vijon:

“Pranimi i fajit nuk është i mangët dhe mbi atë mund të bazohet aktgjykimi, kur i akuzuari ka qen i udhëzuar për të drejtat e tij dhe pasojat juridike nga pranimi i faji dhe në prezencë të mbrojtjes vullnetarisht ka vendosur ta pranojë fajin”.

Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet: “Duke u nisur nga shkresat e lëndës shihet se kryetari i këshillit, në shqyrtim kryesorë ka vlerësuar se deklarata për pranimin e fajit është bërë në mënyrë vullnetare, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike, për sekuestrimin e sënëve dhe mjeteve që janë mjet i vepërs penale dhe harxhimet e procedurës penale.” “Pretendimet e të gjykuarit, se në kohën e dhënies së deklaratës për pranimin e fajit nuk ka qënë në gjendje ta kuptojë rëndësinë e veprimeve të tija dhe ti mbrojë interesat e veta, janë të pa baza për shkak se i gjykuari gjatë procedurës ka pasur avokat-mbrojtës, i cili është i obliguar ti mbroj të drejtat dhe intersat i tij dhe i njejti në fjalën përfundimtare ka theksuar se nuk ka asnjë vërejtje për mbarrëvajtjen e procedurë, as për kualifikimin juridik të veprimeve të të gjykuarit”.

Sipas kësaj, Gjykata supreme vlerëson se procedura para gjykatës së shkallës së parë është realizuar në pajtueshmëri me ligjin, në kuadër të kompetencave të gjyqit dhe Aktgjykimi në bazë të pranimi të fajit është sjellur, pasi që gjykata ka vërtetuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për sjelljen e një vendimi të tillë<sup>165</sup>.

### **Miratimi i Aktgjykimit në bazë të marrëveshjes së prokurorit publik dhe të dyshuarit – Kaptina XXIX.**

Një nga arsytet për pranimin e marrëveshjes për sanksionin penal në RM, është tendenca për shkurtimin e zgjatjes së procedurës penale, në situata kur gjendja faktike është e pakontestueshme për të dyja palët, kur prokuroria disponon me dëshmi të mjaftueshme në lidhje me rastin penalo juridik, kështu që edhe pa nxjeren e dëshmive të siguruara,

<sup>164</sup> Ligji për procedurë penale, neni 381 – Miratim të aktgjykimit në nazë të pranimi të fajit gjatë shqyrtimit kryesorë.

<sup>165</sup> Shih, Gjykata supreme e RMV, SENTENCA KVP Nr.28/2015, <http://www.vsrn.mk>. Shih më lartë, fq.19-20 Robert M. Brady V. United States,

gjykatësi do të mund të sjell akgjykim të arsyeshëm, të drejtë dhe ligjorë. Normat e kësaj kaptine aplikohen edhe gjatë vlerësimit të aktakuzës, ku si bazë për fillimin e procedurës për marrëveshje është deklarata për pranimin e fajit.

Për dallim nga modeli i marrëveshjes për të cilin u përcaktua LPP i RM, duke limituar atë **deri në fazën për vlerësimin e aktakuzës**, në një pjesë të shteteve në rajon (Bosnja e Hercegovina, Serbia), është e lejuar marrëveshja edhe gjatë shqyrtimit kryesorë para ngritjes së propozim – akuzës, për vepra për të cilat udhëhiqet procedurë e shkurtuar edhe në fazën e vlerësimit të aktakuzës<sup>166</sup>.

Ligji për procedurë penale (2010) në mënyrë të detajuar rregullon procedurën për marrëveshje në lëmin e së drejtës penale (procedurale), duke filluar nga paraqitja e propozimit për marrëveshje (neni 483), lënda e marrëveshjes (neni 484), elementet e propozim marrëveshjes (neni 485), pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës dhe të dyshuarit në marrëveshje (neni 486), mospjesmarjen e gjykatës në marrëveshje (neni 487) veprimi ndaj propozim marrëveshjes (neni 488), refuzimi i propozim marrëveshjes (neni 489) dhe sjellja e aktgjykimit bazuar në propozim marrëveshje.

Pas **ngritjes së aktakuzës** prokurori publik dhe i dyshuari mund të dorëzojnë propozim marrëveshje, me të cilën mund të kërkojnë nga gjykatësi i procedurës paraprake të shqiptojë sanksion penal të përcaktuar sipas llojit dhe dhe lartësisë, në suaza të kornizave ligjore të përcaktuara për secilën vepër penale, por jo më poshtë se kufijtë për zbutjen e dënimit të përcaktuar me Kodin penal<sup>167</sup>.

Në funksion të aplikimit të këtij instituti dhe unifikimit të politikës ndëshkuese, ligjdhënësi ndërmoi një sër akvitetesh normative. Hapi i parë u drejtua kah intervenimi në Kodin penal, nëpërmjet miratimit të Ligji për ndërimin dhe plotësimin e Kodit penal. Ndërsa më vonë si rjedhje e këtij Ligji, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë solli Rregulloren për mënyrën e matjes së dënimit, si obligim nga ndërmet dhe plotësimet e Kodit penal. Pak kohë pas miratimit të Rregullores, me propozim të Prokurorisë publike (Qeverisë) parlamenti miratoi Ligjin për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, si nevojë për aplikimin praktik të marrëveshjes në procedurë penale. Ky ligj në mënyrë të detajuar rregullon përcaktimit dhe matjen e dënimeve në procedurë penale, duke vëndosur gjykatësin në pozitë pasive.

Me Rregulloren për mënyrën e matjes së dënimit të miratuar nga Gjykata supreme e RM, ligjdhënësi pretendonte që të krijohet një bazë për avancimin dhe unifikimin e

---

<sup>166</sup> Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајџиев, Гордан 2. Лажетик, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Делџо, страна 964,

<sup>167</sup> Ligji për ndërimin dhe plotësimin e Kodit penal, Gazeta zyrtare e RM NR.28/14; Rregullore për mënyrën e matjes së dënimit, si obligim nga ndërmet dhe plotësimet e Kodit penal, Gazeta zyrtare NR 64/2014; Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta zyrtare e RM NR.199/14.

politikës ndëshkuese të gjyqeve dhe funksionimin efikas dhe të suksesshëm të modelit të ri të procedurës penale në praktikë<sup>168</sup>.

Regullorja përmban 6 pjesë, ndërsa pjesë përbërëse janë edhe dy tabela si dhe sqarime teorike për aplikimin e saj. Pjesa e peste e Regullores përmban (neni 24-26) norma për matjen e dënimit në procedurë për marrëveshje dhe pranimin e fajësisë. Këto norma e autorizojnë gjykatësin kryerësit ti ja zbutë dënimin, gjegjësisht të shqiptojë dënim ndër kufijtë e përcaktuara me ligj, të parashikuar në nenin 41 të KP ose të aplikoj një lloj më të butë të dënimit edhe atë vetëm në dy raste, **atëherë kur është paraqitur propozim marrëveshje dhe kur i akuzuari e paron fajin në shqyrtim kryesorë**<sup>169</sup>.

Me novelën e Kodit penal - dhjetorë 2014<sup>170</sup>, bëhet riformulim i nenit 39 të KP dhe në mënyrë decide është parashikuar që matja gjyqësore e dënimit të bëhet sipas normave të ligjit të posaçëm - Ligji për për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit<sup>171</sup>. Neni 20 dhe 21 e këtij ligji rregullojnë aspektet e matjes së dënimit të marrëveshjet në procedurë penale në mes prokurorit publik dhe të akzuarit. Sipas nenit 20, gjatë marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e dënimit në procedurë hetuese dhe në procedurë të shkurtuar, është parashikuar që të mos mund të bëhet marrëveshje për dënim më të vogël se 50%, nga dënimi që mund të shqiptohet sipas normave të këtij ligji në procedurë të regullt. Ndërsa gjatë marrëveshjes në fazën e vlerësimit të aktakuzës, dënimi i kontraktuar nuk mund të jetë më i vogël se 60% nga dënimi që mund të shqiptohet sipas normave të këtij ligji në procedurë të regullt. Ndërsa sipas nenit 21, dënimi i kontraktuar në situatë të pranimit të fajit gjatë shqyrtimit kryesorë nuk mund të jetë më i vogël se 70% nga dënimi që do të ish shqiptuar në procedurë të regullt<sup>172</sup>.

Në lidhje me arsyeshmërinë e këtyre intervenimeve ligjore me qëllim të unifikimit të politikës ndëshkuese gjyqësore, shih konkluzionet e shprehura në Analizën juridike "Politika

---

<sup>168</sup> Shih, Правна анализа - Практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р Џемали Саити, проф д-р Никола Тупанчевски, проф д-р Александра Деаноска, м-р Андреј Божиновски, OSCE – Мисија во Скопје, 2017, стр.6; Правна анализа I – Казнената политика на судовите во Република Македонија и практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р д-р Џемали Саити, проф д-р Беса Арифи, судија Шпенд Деваја, м-р Андреј Божиновски, Здружение на судии & US Embassy Macedonia, Скопје, 2018, стр.21.

<sup>169</sup> Shih, Правна анализа I – Казнената политика на судовите во Република Македонија и практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р д-р Џемали Саити, проф д-р Беса Арифи, судија Шпенд Деваја, м-р Андреј Божиновски, Здружение на судии & US Embassy Macedonia, Скопје, 2018, стр.26.

<sup>170</sup> Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.199/14, 30.12.2014

<sup>171</sup> Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.199/14, 30.12.2014.

<sup>172</sup> Shih, Правна анализа I – Казнената политика на судовите во Република Македонија и практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р д-р Џемали Саити, проф д-р Беса Арифи, судија Шпенд Деваја, м-р Андреј Божиновски, Здружение на судии & US Embassy Macedonia, Скопје, 2018, стр.31, страна 74-76, Заклучни согледувања.

ndëshkuese e gjykatave në Republikën e Maqedonisë dhe aplikimi praktik i Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit”<sup>173</sup>. Konform konkluzioneve të shprehura në Analizat juridike të lartëpërmendura dhe reagimit të vazhdueshëm të gjykatësve, në nëntorë rë vitit 2017 Gjykata kushtetuese e Republikës së Maqedonisë suspendoi (abrogoi) Ligjin për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit<sup>174</sup>, me arsyetimin se: “Ligji në mënyrë serioze depërton në pavarësinë e pushtetit gjyqësorë dhe cënon parimin e ndarjes së pushtetit. Me ligjin egziston përzierje të pushtetit legjdhënës dhe atij gjyqësorë që duhet të jetë i pavarur. Gjithashu ligji është në kundërshtim me të drejtën ligjore për vlerësim të lirë të dëshmimeve dhe bindjes gjyqësore.”

Pas suspendimit të këtij ligji, ligjdhënësi intervenoi në Kodin penal ne lidhje normat që kanë të bëjnë me matjen e dënimit, neni 39 – Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, neni 40 - Zbutja e dënimit dhe neni 41 - Kufijtë e zbutjes së dënimit, që kishin për qëllim rikthimin e pozicionit të mëparshëm ligjorë, sa i takon mënyrës se përcaktimit konkret të sanksioneve.

Në funksion të unifikimit dhe aplikimit të drejtë të marrëveshjes në procedurë penale, Prokurori shtetërorë i Republikës së Maqedonisë së veriut, në Rregulloren për administrim të mbrendshëm të prokurorive publike, nga 29.07.2021, A.бp.03-396/2 – rregullon edhe obligimet dhe veprimimi i prokurorëve publik që kanë të bëjnë me marrëveshjen në procedurë penale.

Sipas nenit 45 të Rregullores, gjatë lidhjes së propozim marrëveshjes për vepra penale për të cilat është parashikuar dënim me burg deri në 5 vite, ajo mund të bëhet nga prokurori publik vetëm me pajtueshmëri paraprake me shkrim nga prokurori publik i prokurorisë kompetente. Për veprat penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burg mbi 5 vite, ajo mund të nënshkruhet me pajtueshmëri paraprake me shkrim nga Prokurori publik i lartë (alinea 2) Për vepra penale në kompetencë të prokurorisë themelore për krim të organizuar dhe korupcion por të cilat është parashikuar dënim me burg deri më 5 vite, ajo mund të arrihet me pajtueshmëri paraprake nga prokurori publik i asaj prokurorie (alinea 3). Dhe për vepra penale të cilat është parashikuar dënim me burg mbi 5 vite në kompetencë të kësaj prokurorie, marrëveshja mund të arrihet vetëm me pëlqim paraprak me shkrim nga Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë<sup>175</sup>.

---

<sup>173</sup> Правна анализа I – Казнената политика на судовите во Република Македонија и практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р д-р Џемали Саити, проф д-р Беса Арифи, судија Шпенд Деваја, м-р Андреј Божиновски, Здружение на судии & US Embassy Macedonia, Скопје, 2018, стр.31, страна 74-76, Заклучни согледувања; Правна анализа - Практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р Џемали Саити, проф д-р Никола Тупанчевски, проф д-р Александра Деаноска, м-р Андреј Божиновски, OSCE – Мисија во Скопје, 2017, Заклучни согледувања стр.37-38.

<sup>174</sup> Gjykata kushtetuse e RM, У.бp.169/2016-1, 16 ноември 2017 година.

<sup>175</sup>

<https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/09/p-r-a-v-i-l-n-i-k-za-vnatreshno-rabote%D1%9Ae-na-%D1%98avnite-obvinitelstva.pdf>

**Lëndë e marrëveshjes është lloi dhe lartësia e sanksionit penal** që do të propozohet në propozim marrëveshje, ndërsa nëse egziston pajtueshmëri nga i dyshuari lëndë e marrëveshjes mund të jetë edhe kërkesa pronësoro - juridike e të dëmtuarit (neni 484). Lëndë e marrëveshjes nuk mund të jetë përshkrimi i veprës penale as kualifikimi juridik. Lëndë e marrëveshjes nuk mund të jetë edhe konfiskimi i pronës e fituar si rezultat i veprës penale, si dhe sequestrimi i sendeve sepse ata duhet të jenë përcaktuar në situatë kur janë plotësuar kushtet për përcaktimin e tyre në pajtueshmëri me nenin 97-100 të KP<sup>176</sup>.

Neni 485, parasheh elementet e propozim-marrëveshjes. Elemente kryesore mund të grupohen si vijon: Të dhënat hyrëse; lënda e marrëveshjes; deklaratat e palëve; pjesa përfundimtare (nënshkrime të palëve).

Statusi i palëve në këtë procedurë është një nga çështjet që rregullohet në mënyrë të detajuar. I dyshuari duhet të ketë avokat mbrojtës nga momenti i fillimit të procedurës për marrëveshje. Nëse i dyshuarit nuk zgjedh avokat atë e përcakton gjykata, dmth në këtë rast bëhet fjalë për mbrojtje obligative profesionale. Nga ana tjetër gjykatësi i procedurës paraprake nuk ka të drejtë të mer pjesë në procedurën për marrëveshje<sup>177</sup>.

Neni 488 i LPP normon veprimin pas dorëzimit të propozim marrëveshjes, duke filluar nga afati për konvokimin e seancës e cila është urgjente (ajo duhet të konvokohet në afat prej tre ditëve nga pranimi i propozim marrëveshjes). Segmenti i dytë është çështja e të ftuarve në seancë dhe çka vlerëson gjykata. Në seancë ftohen palët e propozim – marrëveshjes. Ndërsa në seancë vlerësohet nëse ajo është lidhur në mënyrë vullnetare, a është i dyshuari i vetëdijëshëm për pasojat juridike të marrëveshjes, për pasojat në lidhje me kërkesën pronësoro juridike dhe harxhimet e procedurës penale. Kjo duket si një çek listë, të cilën e plotëson gjykatësi nga përgjigjet e fituar nga i akuzuari.

Palët gjatë seancës gjyqësore nuk mund të paraqesin kërkesë për shqiptim të sanksionit penal të ndryshëm nga sanksioni penal në propozim-marrëveshje. Nëse palët paraqesin një kërkesë të tillë konsiderohet se janë tërhequr nga propozim-marrëveshja dhe gjykatësi i procedurës paraprake sjell vendim në kuptim të nenit 489 alinea 1 i LPP, që don të thotë se do ta refuzojë propozim - marrëveshjen dhe shkresat do ti ja japë prokurorit publik. Paraprakisht gjykatësi i paralajmëron palët për të drejtën të tërhiqen nga propozim marrëveshja, deri te miratimi i vendimit nga gjykatësi. Në këtë kuptim, nuk kërkohet nga palët të sqarojnë një vendim të tillë dhe për gjykatën janë irelevante shkaqet e tërheqjes nga propozim marrëveshjen, që edhe njëherë vërteton specifikat e këtij instituti penalo-juridik nga aspekti i dispozicionit të vullnetit të palëve.

Duke pasur parasysh faktin që pjesë përbërëse e propozim - marrëveshjes është pajtueshmëria e palëve për heqje dorë nga e drejta e ankimit, gjykatësi i procedurës

<sup>176</sup> Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајџиев, Гордан 2. Лажетик, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Делџо, страна 968,

<sup>177</sup> Shjih, Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајџиев, Гордан 2. Лажетик, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Делџо, страна 971.

paraprake është i obliguar ti njohtojë palët, se pranimi i propozim - marrëveshjes konsiderohet si tërheqje nga e drejta e ankimit të aktgjyqimit të sjellur në bazë të propozim marrëveshjes. Ndërsa palët duhet të jenë të vetëdijëshëm se tërheqja nga e drejta e ankimit nuk mund të revokohet, duke pasur parasysh nenin 412 alinea 3 e LPP.

Nëse gjykatësi vlerëson se dëshmitë e siguruar për fakte me rëndësi për zgjedhjen dhe matjen e sanksionit penal, nuk e arsyetojnë shqiptimin e propozim sanksionit ose nëse palët gjatë seancës kanë paraqitur kërkesë për shqiptimin e sanksionit të ndryshëm nga ai në propozim marrëveshje, gjykata sjell vendim me të cilin do ta refuzojë propozim marrëveshjen (neni 489 i LPP). Në rastin e parë bëhet fjalë për propozim sanksion i cili është në kuadër të ligjit, por gjykatësi vlerëson se ai është shumë e butë ose e ashpër, duke i pasur parasysh rethanat lehtësuese ose rënduese të veprës. Propozim - marrëveshja mund të refuzohet edhe atëherë kur gjykata do të vlerësojë se tek i akuzuari mungon vullneti, vetëdija, ose kuptimi për pasojat nga nënshkrimi i marrëveshjes, për shka edhe nuk mund të pranohet si i arsyeshëm sanksioni i propozuar. Gjithashtu gjykatësi do të refuzojë propozim - marrëveshjen edhe në rast kur nga dëshmitë e grumbulluara nuk rrjedh figura e veprës penale, përshkrimi i së cilës është evidentuar në propozim marrëveshje dhe nuk rrjedh se i dyshuari është kryerës i vepës penale. Në këtë rast, refuzimi bëhet për shkak se sanksioni i propozuar nuk mund të llogaritet si adekuat<sup>178</sup>. Kundër vendimit për refuzimin e propozim marrëveshjes nuk lejohet ankim.

**Akgjykim në bazë të propozim marrëveshjes** (neni 490 i LPP). Nëse gjykatësi e pranon propozim marrëveshjen miraton aktgjykim me të cilën nuk mund të shqiptohet sanksion i ndryshëm nga ai në propozim marrëveshje. Gjykatësi nuk ka kompetencë të bëjë asnjë korigjim në lidhje me sanksionin e propozuar. Nëse mendon se ajo është joadekuate, gjykatësi është i obliguar të sjell vendim për refuzimin e saj, sipas nenit 489 të LPP.

Në këtë kontekst me rëndësi të veçantë është veprimi juridik i akgjyqimit të tillë, ndaj më shumë të akuzuarëve. **Ky vendim i mirratuar në këtë mënyrë nuk mund të propozohet si dëshmi kundër të dyshuarëve tjerë të cilët nuk kanë bërë marrëveshje.** Si mundësi e vetme egziston, që i gjykuari në bazë të propozim marrëveshjes të **propozohet si dëshmitarë** në procedurë kundër të akuzuarit të mëparshëm. As gjendja faktike e përmbajtur në akgjykim i sjellur në bazë të propozim – marrëveshjes për një të dyshuar, as dëshmia që ai e ka dhënë dhe i ka paraprijë nënshkrimit të propozim marrëveshjes gjegjësisht miratimit të akgjyqimit në bazë të propozim marrëveshjes, nuk mund të shfrytëzohen në procedurën që udhëhiqet ndaj të dyshuarëve. Vetëm dëshminë e tani më të gjykuarit i cili është ftuar në cilësinë e dëshmitarit, gjykata mund ta vlerësojë dhe mbi atë të bazojë aktgjykimin. Duke u nisur nga parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe interesit të viktimës, kopje e vendimit përveç palëve të marrëveshjes i dorëzohet edhe të dëmtuarit. Nëse i dëmtuari nuk është i kënaqur me vendimin për lloin dhe lartësinë e kërkesës pronësore juridike, të drejtën e tij mund ta realizojë në procedurë civile.

---

<sup>178</sup> Shih, Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајџијев, Гордан 2. Лажетиќ, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Дељо, страна 975.

### 3.3 Efektet praktike nga aplikimi i pranimit të fajit në RMV.

Aplikimi i këtij institut penalo juridik nuk ka kufizime kur bëhet fjalë për llojin e veprave penale dhe peshën e tyre, duke u bazuar nga objekti i mbrojtjes penalo juridike dhe sanksionet e parashikuara.

Duke u nisur nga niveli i respektimit të të drejtave procedurale të akuzuarit në korelacion me apstinimin e vullnetshëm të tij nga një pjesë e garancive procedurale për fer gjykim, dhe duke pasur parasysh ndikimin i procedurave të shkurtuara, nga prizmi i ekonomizimit procedural dhe shpenzimit të resurseve gjyqësore, mund të konstatojmë se aplikimi i këtij instituti penalo juridik ka ndikim meritore ndaj perceptcionit të përgjithshëm për drejtësinë e procedurës penale. Edhe më tepër, për shkak se ndikimi i pranimit të fajit ndaj veprimeve tjera procesuale në rend të parë ndaj dëshmimeve, është drejtpërdrejtë i lidhur edhe me nivelin e efikasitetit të së drejtës ndëshkuese<sup>179</sup>.

Në gjithsejtë 280 raste të monitoruara nga lëmi i së drejtës penale në vitin 2020 nga Fondation open society Macedonia, në 50 raste të akuzuarit kanë pranuar fajin dhe procedura ka mbaruar me miratimin e **aktgjykimit në bazë të pranimit të fajit gjatë sencës kryesore**<sup>180</sup>. Nga ky monitorim vërehet se pranim të fajit më së paku kemi në gjykatën penale Shkup, vetëm në 3 raste nga 47 raste të monitoruara, ndërsa gjykatat tjera si për shembull, Manastiri, Shtipi, Strumica, kanë përfituar më shumë nga ky institut juridik. Kështu, në Manastir 15% nga 29 raste të monitoruara, 25% në Shtip nga 25 raste të monitoruara dhe 26% në Strumicë nga 28 raste të monitoruara<sup>181</sup>.

Sipas Raportit vjetorë të Prokurorisë publike të Republikës së Maqedonisë së veriut, për punën e prokurorive publike në vitin 2020<sup>182</sup>, gjatë kësaj periudhe janë paraqitur 23.696 kallëzime penale. Në bazë të nenin 288 të LPP dhe shkaqe tjera janë hudhur 7.638 kallëzime penale, ose 32,2% nga gjithsejt numri i kallëzimeve penale të paraqitura. Janë paraqitur 4.667 ose 19.7%, propozim - akuza, 8.639 urdhëresa dënuese ose 36,5%, kundër 1.404 personave ose 5,9%. Është sjellur urdhëresë për zbatim të hetuesisë kundër 1256 personave,

---

<sup>179</sup> Fondation open society Macedonia, Системски мониторинг на кривични судски постапки во 2020 година, Скопје, 2021, страна 21, Преземено од Мисоски Б., Аврамовски Д., Петровскас Н., Анализа на податоците од наблудените судски постапки во 2017 година, Коалиција, „Сите за правично судење“, Скопје 2017 г.

<sup>180</sup> Ibid,

<sup>181</sup> Ibid, shih fq 21 Grafikon.

<sup>182</sup> <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/08/izveshta%D1%98-za-2020-%D1%98o-na-rsm.pdf>. Fq 29

ndërsa **propozim marrëveshje në procedurë të shkurtuar**<sup>183</sup>, është paraqitur kundër 92 personave ose 0,4 %.

Nëse analizohen vendimet e prokurorisë publike pas zhvillimit të hetuesisë ndaj 2.460 personave, gjatë vitit 2020, hetuesia ka mbaruar për 1.485 persona ose 60,4%, prej tyre. Janë ngritur 1055 aktakuza, ndërsa për 184 persona është ndërprerë hetuesia. Për 85 persona është **paraqitur propozim marrëveshje në procedurë hetuese**, dhe 2 persona propozim marrëveshje **pas ngritjes së akt-akuzës**. Nëse shihet analiza e prokurorive të veçanta, rrjedh se Prokurorija themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korupcionit, nuk ka paraqitur asnjë propozim marrëveshje pas ngritjes së akt-akuzës dhe vetëm 10 propozim marrëveshje në procedurë hetimore<sup>184</sup>.

Sipas raportit në fjalë, instituti marrëveshje në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit sjell deri te zgjidhje pozitive në aspekt të zgjidhjes së shpejtë të lëndëve, me atë edhe përparësi tjera për të akuzuarin dhe të drejtat e tij. **Dobitë nga marrëveshja në procedurë penale janë:** zvogëlimi i harxhimeve në procedurë penale, procedurë penale efektive dhe efikase, zvogëlim i kohëzgjatjes së procedurës, kështu që nga paraqitja e fletpadisë deri te mirratimi i propozim marrëveshjes mesatarisht nevojiten 5 muaj, që flet për arsyeshmërinë e prokurorisë që sa më shumë lëndë të kryhen në këtë menyrë.

Ky institut, gjatë vitit 2020 është aplikuar gjithsejt në 179 raste, që në raport me vitin 2019 kur ishin miratuar 272 marrëveshje, do të thotë se vërehet zvogëlim për 93 marrëveshje të aplikuara. Nga 179 marrëveshje, 93 raste janë në procedurë të shkurtuar, 85 raste gjatë procedurës hetuese dhe 2 raste pas ngritjes së akt-akuzës gjegjësisht në fazë të vlerësimit të akt-akuzës<sup>185</sup>.

Sipas prokurorive: Prokuroria e lartë Shkup, në procedurë të shkurtuar ka aplikuar 55 marrëveshje, në procedurë hetimore 35, pas ngritjes së aktakuzës 2, gjithsejt 92 ose 51%. Prokuroria e lartë Manastir - 14 marrëveshje në procedurë të shkurtuar, 12 në procedurë hetimore, gjithsejt 26 marrëveshje ose 15%. Prokurorija e lartë Shtip - 9 marrëveshje në procedurë të shkurtuar, 10 në procedurë hetimore, gjithsejt 19 ose 11%. Prokurorija e lartë Gostivarë - 7 marrëveshje në procedurë të shkurtuar, 15 në procedurë hetimore, gjithsejt 22 ose 12%. Prokuroria publike për krim të organizuar dhe korrupcion, ka aplikuar 7 marrëveshje në procedurë të shkurtuar, 13 në procedurë hetuese, gjithsejt 20 ose 11%. Nga këto të dhëna rrjedh se numri me i madh i marrëveshjeve është arritur në kuadër të Prokurorisë së lartë Shkup.

Në lidhje me veprat penale për të cilat janë realizuar propozim marrëveshjet, situata është përafërsisht e njejtë sa u takon marrëveshjeve të nënshkruara në procedurë të shkurtuar, gjegjësisht për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burg deri ne 5

---

<sup>183</sup> Shihe, LPP i RM (2010) – Procedura e shkurtuar, neni 468 – 482. Procedurë e shkurtuar udhëhiqet për vepra penale për të cilat si dënim kryesorë është parashikuar dënim në të holla ose dënim me burg deri më 5 vjet.

<sup>184</sup> <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/08/izveshta%D1%98-za-2020-%D1%98o-na-rsm.pdf>. Fq 35

<sup>185</sup> Konkluzion i veçantë nga raporti për efektet e marrëveshjes në procedurë penale.

vite dhe për vepra penale për të cilat parashikohet dënim më shumë se pesë vite. Në raport konstatohet, se aplikimin i këtij instituti e mundëson sigurimi i dëshmive cilësore nga ana e prokurorive publike, pasi që të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre kërkojnë të bëjnë marrëveshje për dënimin me prokurorët publik, për veprat penale për të cilat sipas ligjit parshikohet dënim me kusht ose dënim në të holla, poashtu edhe për vepra penale që sipas ligjit mund të shqiptohet dënim me burg<sup>186</sup>.

Në këtë raport janë paraqitur edhe llojet e vendimeve të gjykatave **pas ngritjes së aktakuzave**. Kështu, gjatë vitit 2018 janë paraqitur 174 propozim marrëveshje në procedurë hetuese, 168 propozim marrëveshje në procedurë të shkurtuar, 6 propozim marrëveshje pas ngritjes së aktakuzës.

Gjatë viti 2019, janë paraqitur 129 propozim marrëveshje në procedurë hetimore, 130 propozim marrëveshje në procedurë të shkurtuar, dhe 13 propozim marrëveshje pas ngritjes së akt-akuzës.

Gjatë vitit 2020, janë paraqitur 85 propozim marrëveshje në procedurë hetimore, 92 në procedurë të shkurtuar, 2 pas ngritjes së akt-akuzës<sup>187</sup>.

Raportet e prokurorisë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut pasqyrojnë numrat dhe çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin e instituti marrëveshje në procedurë penale, duke filluar nga hapat e para të aplikimit<sup>188</sup>.

Pas realizimit të hetuesisë, janë paraqitur 129 propozim marrëveshje në procedurë hetimore dhe 13 propozim - marrëveshje pas ngritjes së aktakuzës, ndaj 13 personave.

Vendime, sipas prokurorive (2019): Nga Prokurorija publike për krim të organizuar dhe korrupsion - janë paraqitur 8 propozim marrëveshje pas ngritjes së akt-akuzës, 10 propozim marrëveshje në procedurë hetimore. Nga Prokuroria e lartë Shkup - janë paraqitur 2 propozim marrëveshje pas ngritjes së akt-akuzës, 63 propozim marrëveshje në procedurë hetimore. Prokuroria e lartë Manastir - janë paraqitur 2 propozim marrëveshje pas ngritjes së akt-akuzës, 17 propozim marrëveshje në procedurë hetimore. Prokuroria e lartë Shtip: 1 propozim marrëveshje pas ngritjes së aktakuzës, 25 propozim marrëveshje gjatë procedurës hetimore. Prokuroria e lartë Gostivarë - 4 propozim marrëveshje në procedurë hetimore.

Marrëveshja në procedurë penale në vitin 2019 është aplikuar në 272 raste, që krahasuar me vitin 2018, kur ishin realizuar 280 marrëveshje konstatohet zvogëlim për 8 marrëveshje. Prej tyre 130 marrëveshje, janë bërë në procedurë të shkurtuar, 129 raste në

---

<sup>186</sup> <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/08/izveshta%D1%98-za-2020-%D1%98o-na-rsm.pdf>. Fq 36

<sup>187</sup> Shih, <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/08/izveshta%D1%98-za-2020-%D1%98o-na-rsm.pdf>. Fq 38, Paraqitja Tabelare.

<sup>188</sup> <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelstva-na-rsm-za-2019-godina.pdf>, fq,27-28.

procedurë hetimore, dhe 13 raste pas ngritjes së aktakuzës, gjegjësisht në fazë të vlerësimit të aktakuzës<sup>189</sup>.

Statistikat aplikative, të këtij instituti juridik janë shprehur në Raportet e Prokurorisë publike të Republikës së Maqedonisë<sup>190</sup>.

Për herë të parë në Raportin e prokurorisë publike të Republikës së Maqedonisë për punën e prokurorive publike të viti 2014, paraqiten të dhëna për numrin e marrëveshjeve të propozuara. Kështu, në grafën - vendime pas realizimit të hetuesisë janë paraqitur 269 propozim marrëveshje në procedurë hetuese dhe 15 propozim marrëveshje pas ngritjes së aktakuzës<sup>191</sup>.

Ndërsa gjatë vitit 2015, për 300 individë janë paraqitur propozim marrëveshje, ose 1.3%<sup>192</sup>. Të dhënat nga vendimet sipas llojit dhe numrit të hetuesive të mbaruara japin këtë pasqyrë: Gjithsejt janë paraqitur 10 propozim marrëveshje pas ngritjes së aktakuzës, 124 propozim marrëveshje në procedurë te hetuesisë<sup>193</sup>.

Sa u takon propozim marrëveshjeve të paraqitura në raportin e viti 2015 të Prokurorisë publike të Republikës së Maqedonisë, konstatohet rritje në krahasim me vitin e parë të aplikimit të këtij instituti juridik, me 8,9% të rasteve të propozuara. Dmth, ky institut në vitin 2015 është aplikuar në 300 raste edhe atë 166 rastë në procedurë të shkurtuar, 124 rastë gjatë procedurës hetuese dhe në 10 raste pas ngritjes së aktakuzës.

Në kuadër të Prokurorisë së lartë Shkup janë aplikuar 65% të rasteve. Duhet të konstatojmë se në vitin 2015, sukses më të madh në aplikimin e marrëveshjes në procedurë penale, ka Prokuroria themelore për krim të organizuar dhe korrupcion e cila nëpërmjet marrëveshjes ka zgjidhur 15.8% të rasteve nga numri i përgjithshëm i lëndëve në vitin 2015. Edhe në këtë raport konstatohen dobisë e këtij instituti juridik<sup>194</sup>.

Nëse analizohen vendimet që dalin nga paditë penale në këtë prokurori, për 28 të dyshuar ose 6,4% të lëndëve janë zgjedhur me propozim marrëveshje në procedurë të shkurtuar. Nga propozim marrëveshjet e kësaj prokurorie në vitin 2015, nga gjykatësi kompetent i procedurës paraprake dhe këshilli për vlerësimin e aktakuzës janë pranuar gjithsejt 83 marrëveshje, edhe atë:

- 1) Propozim marrëveshje në **procedurë të shkurtuar** për 28 të dyshuar, ose 33,73%.

---

<sup>189</sup> Ibid, fq.32

<sup>190</sup>

<https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/01/godishen-izvestaj-za-raboteneto-na-javnoto-obvinitelstvo-na-republika-severna-makedonija-za-2018-godina.pdf>.

<sup>191</sup> Shih, <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Izvestaj-na-JORM.pdf> fq 11

<sup>192</sup> Raport për punën e prokurorive publike në RM, për vitin 2015, Shkup, qershor 2016, Fq,12, <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Godisen-izvestaj-2015.pdf>

<sup>193</sup> Ibid, fq.17.

<sup>194</sup> Ibid, fq, 18

2) Propozim marrëveshje në **procedurë hetuese** për 50 dyshuar, ose 60,24%

3) Propozim marrëveshje **pas ngritjes së akt-akuzës** për 5 dyshuar, ose 6.02%<sup>195</sup>.

Në këtë raport është paraqitur edhe struktura e veprave penale, lëndë e marrëveshjeve në mes të prokurorit nga njëra anë dhe të akuzuarit dhe mbrojtjes së tij në anën tjetër, si dhe lloji dhe lartësia e dënimeve<sup>196</sup>. Sa i takon struktues së veprave penale, lëndë e marrëveshjeve në procedurë penale, ky institut përfshin një spektër të gjërër të veprave penale.

Raporti vjetorë i prokurorisë publike për punën e prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, nga 20 nëntori 2017, Raporti për vitin 2017 nga 20 nëntori 2018, për vitin 2018 nga 13 janar 2020, dhe për vitin 2019, gusht 2019, sigurojnë të dhëna relevante sa i takon ecurive numerike të këtij instituti penalo juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut<sup>197</sup>.

Përveç numrave zyrtarë, monitorimi sistematik i procedurave gjyqësore penale nga Foundation open society Macedonia, për vitin 2020 përqëndrohet tek çështjet kryesore që kanë të bëjnë me pranimin e fajit **në seance kryesore**.

Për shembull, nga lëndët e monitoruara, monitoruesit kanë konstatuar se gjykata në 26% të lëndëve, nuk ka kontrolluar të gjitha atributet e veprës penale, ndërsa në 24% të lëndëve nuk është verifikuar nëse daklarata është dhënë në mënyrë vullnetare, dhe 16% të rasteve nuk është vërtetuar se deklarimi për pranimin e fajit është i vetëdijëshëm<sup>198</sup>. Këta janë disa nga obligimet kryesore të gjykatës sipas një pyetësori të sistemuar me an të cili mund të verifikojë se një deklaratë për pranimin e fajit, ka marë një verifikim meritore nga gjykata pasi që e njëjta prodhon pasoja relevante për të akuzuarin, e që garancitë për një gjë të tillë sipas ligjit duhet ti sigurojë gjykatësi.

Ndërsa nga seancat e monitoruara në vitin 2016, nga gjithsejt 450 senaca të vëzhguara në 95 seanca është bërë pranimi i fajit, nga të cilat në 78 raste ajo është bërë në procedurë të shkurtuar, ndërsa në 14 raste në procedurë të regullt. Nga ky monitorim është konkluduar prezenca e këtij instituti juridik, dhe i njëjti shihet si mjet efikas për përfundim të shpejtë, efikas dhe efektiv të procedurave penale. Ndërsa nga vëzhgimi i një viti më parë

---

<sup>195</sup> Shih, Raporti për punën e prokurorive publike në RM, për vitin 2015, Shkup, qershor 2016, Fq,12, <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Godisen-izvestaj-2015.pdf>, fq.63.

<sup>196</sup> Ibid, fq, 64.

<sup>197</sup>

<https://jorm.gov.mk/godishen-izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelstva-vo-republika-makedonija-vo-2016-godina/>; <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/01/godishen-izveshtaj-za-raboteneto-na-javn-oto-obvinitelstvo-na-republika-severna-makedonija-za-2018-godina.pdf>;  
<https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelstva-na-rsm-za-2019-godina.pdf>

<sup>198</sup> Shih, Foundation open society Macedonia, Системски мониторинг на кривични судски постапки во 2020 година, Скопје, 2021, fq. 22.

janë konstatuar 70 lëndë të pranimi të fajit, nga ana e të akuzuarve nga gjithsejt 550 seanca të vëzhguara. d.m.th gjatë vitit 2017 vërehet rritje për 1/3 e rasteve<sup>199</sup>.

Sipas lloit të veprave penale, pranimi i fajit është bërë te veprat penale kundër jetës dhe trupit, pronës dhe kundër sigurisë në komunikacionin publik. Pranim të fajit kemi edhe te veprat penale kundër pozitës zyrtare dhe kundër moralit seksual dhe lirisë seksuale. Nga këta të dhëna rrjedh përfundimi, se pranimi i fajit gjatë shqyrtimit kryesorë nuk varet nga lloji veprës penale. **Nga kjo, si përfundim plotësues imponohet teza se gadishmëria e të akuzuarve që të pranojnë fajin varet nga fakti se në çfarë mase çështja penale është hetuar nga organet e ndjekjes, gjegjësisht sa mirë është koncipuar aktakuza<sup>200</sup>.**

Analiza e të dhënave nga monitorimi i procedurave gjyqësore në vitin 2016, përmban fakte të rëndësishme që kanë të bëjnë me procedurën e pranimi të fajit, në veçanti vërtetimi i fakteve që kanë të bëjnë me pranimin e fajit, nëpërmjet parashtrimit të pyetjeve konkrete që verifikojnë vullnetin e të akuzuarit dhe pritshmëritë nga pranimi të fajit, duke përfshirë edhe obligimet që dalin nga aktgjykimi. Ky raport pasqyron edhe faktin se a u nxorën prova pas pranimi të fajit dhe cilat<sup>201</sup>.

***Në vazhdim do ti prezentojmë statistikat e siguruar nga Gjykata penale Shkup, pas kërkesës me shkrim të bërë me datë 29.10.2021 viti, për nevojat e këtij punimi të magistraturës.***

Tabela 1. KOK-PP Propozim marrëveshje – krim i organizuar

Regjistri	Viti	Prop – marrëveshje të miratuara
KOK-PP	2015	107
KOK-PP	2016	73
KOK-PP	2017	33
KOK-PP	2018	16

<sup>199</sup> OSCE & Koalicioni të gjithë për gjykime të drejta, Analizë e të dhënave n ga monitorimi i procedurave gjyqësore në vitin 2016, Shkup, dhjetorë 2016, fq.53

<sup>200</sup> OSCE & Koalicioni të gjithë për gjykime të drejta, Analizë e të dhënave n ga monitorimi i procedurave gjyqësore në vitin 2016, Shkup, dhjetorë 2016, fq.56.

<sup>201</sup> OSCE & Koalicioni të gjithë për gjykime të drejta, Analizë e të dhënave n ga monitorimi i procedurave gjyqësore në vitin 2016, Shkup, dhjetorë 2016, fq.57-60.

KOK-PP	2019	24
KOK-PP	2020	25
KOK-PP	2021	34

**Në vitin 2015** janë mirratuar 107 propozim marrëveshje për 134 persona. Dominojnë veprat penale kontrabandë me migrantë (103), shoqëri kriminale (5) dhe lëshim në qarkullim të mjeteve narkotike dhe supstancave psihotrope(11). **Në vitin 2016** janë mirratuar 73 propozim marrëveshje për 90 persona, përsëri dominojnë veprat penale kontrabandë me migrantë(48), lëshim në qarkullim të mjeteve narkotike dhe supstancave psihotrope (11), keqpërdorim i pozitës zyrtare (7), pjesmarëje në ushtri të huaja (7), oragnizatë teroriste (5), keqpërdorimi i regjimit të vizave (3), shoqëri kriminele (3). **Në vitin 2017** janë mirratuar 33 propozim marëveshje për 47 të akuzuar. Më të përhira janë veprate penale: kontrabandë me migrantë (20), lëshim në qarkullim të mjeteve narkotike dhe supstancave psihotrope (14) dhe vepra tjera penale. **Ndërsa në vitin 2018** janë mirratuar 16 propozim - marrëveshje për 26 të akuzuar. Më të përfaqësuar janë veprat penale: kontrabandë me migrantë (14), keqpërdorimi i regjimit të vizave (2) dhe lëshim në qarkullim të mjeteve narkotike dhe supstancave psihotrope (3). **Në vitin 2019** janë mirratuar 24 propozim marrëveshje për 32 të akuzuar. Më të përfaqësuar janë veprat penale: kontraban me migrantë (19), keqpërdorimi i regjimit ë vizave (3), lëshim qarkullim të mjeteve narkotike (3) vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme (1). **Në vitin 2020** janë mirratuar 25 propozim marrëveshje për 33 të akuzuar. Më të përfaqësuar janë: kontrabandim i migrantëve (14), keqpërdorimi i regjimit të vizave (2) dhe lëshim qarkullim të mjeteve narkotike (5). **Ndërsa në vitin 2021** janë mirratuar 34 propozim marrëveshje për 45 të akuzuar. Më të përfaqësuar janë: kontrabandim i migrantëve (6), keqpërdorimi i regjimit të vizave (2) lëshim qarkullim të mjeteve narkotike (29).

Tabela 2. K-PP Propozim marrëveshje- penale

Regjistri	Viti	Prop – marrëveshje të miratuara
K-PP	2015	90
K-PP	2016	73 (72 - të miratuara)
K-PP	2017	79 (75 -të miratuara)
K-PP	2018	35(29 - janë mirratuar)
K-PP	2019	39
K-PP	2020	18

K-PP	2021	22 (21 -janë mirratuar)
------	------	-------------------------

**Në vitin 2015** janë mirratuar 90 propozim - marrëveshje për 108 të akuzuar. Më të përfaqësuara janë veprate penale: falsifikim i dokumenteve (6), keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtarë (11), lëndimi i rëndë truporë (13), vjedhje e rëndë (5), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psihotrope dhe prekursorë (14) përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (10), fshehja e tatimit (11).

**Në vitin 2016** janë parqitur 73 propozim marrëveshje për 82 të akuzuar, janë mirratuar 72 propozim marrëveshje. Më të përfaqësuara janë veprate penale: falsifikim i dokumenteve (6), keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtarë (11), lëndimi i rëndë truporë (5), vjedhje e rëndë (4), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (25) përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (9), fshehja e tatimit (2), dhunim (6), dhënia e ryshfetit (1) (dënim me kusht). Është paraqitur një propozim marrëveshje për veprën **penale vrasje**, K-PP 866/2016 e cila është **refuzuar**.

**Në vitin 2017** janë paraqitura 79 propozim marrëveshje për 102 të akuzuar. Janë mirratuar 75 propozim marrëveshje 4 janë refuzuar. Më të përfaqësuara janë veprate penale: falsifikim i dokumenteve (8), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (31), tregëti e palejuar (6), vjedhje (4), fshehje tatimi (7) ndërtim i kundërligjshëm (2- dënim me kusht), asgjësim i materijalit zgjedhorë (2- dënim me kusht). **Janë refuzuar** dy propozim marrëveshje për veprën penale - përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë, një propozim marrëveshje për veprën penale – shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, dhe një propozim marrëveshje për veprën penale – pjesëmarrje në turme që do të pengojë personin zyrtarë të kryejë veprimin zyrtarë. **Në vitin 2018** janë paraqitur 35 propozim marrëveshje për 47 të akuzuar prej të cilave 29 janë mirratuar ndërsa 6 propozim marrëveshje janë refuzuar. Më të përfaqësuara janë veprat penale: prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (9), falsifikim i dokumenteve (2), fshehje e tatimit (5). **Janë refuzuar propozim- marrëveshje për:** falsifikim i dokumenteve (2), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (1), keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimeve (1), fshehje e tatimit (2). **Në vitin 2019** janë paraqitur 39 propozim marrëveshje për 52 persona. Të gjitha janë mirratuar. Më të përfaqësuara janë veprate penale: fshehje e tatimit (12), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (20), vjedhje e rëndë (7). **Në vitin 2020** janë paraqitur 18 propozim marrëveshje për 25 të akuzuar. Më të përfaqësuara janë veprate penale: prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (3), lëndime të rënda trupore (4), pjesëmarrje në turme që do të pengojë personin zyrtarë të kryejë veprimin zyrtarë (3). Të gjith dënimit janë me kusht dhe një dënim në të holla. **Ndërsa në vitin 2021**, janë paraqitur 22 propozim marrëveshje për 39

persona. **Një propozim marrëveshje është refuzuar**, për veprën penale - përpunim mbajtje, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë. Më të përfaqësuara janë veprate penale: fshehje e tatimit (12), dhunim (12), Përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e arm[s apo mjeteve shpërthyesë (3), ndërtim kundërligjorë (1).

Tabela 3. Pranimi i fajit KOK - Krim i organizuar

Regjistri	Viti	Lëndë të zgjedhura sipas personave
KOK	2015	78 (81 person)
KOK	2016	68 (71 person)
KOK	2017	21 (për24 persona)
KOK	2018	60 (për 63 persona)
KOK	2019	91 vendim për 94 persona
KOK	2020	85 vendim për 88 persona
KOK	2021	45 vendim për 48 persona

**Në vitin 2015** janë mirratuar 78 vendime në bazë të pranimit të fajit te lëndët e krimit të organizuar, për 81 person. Më të përfaqësuara janë, vepra penale trafikim me migrantë (55), vepra penale shoqëri kriminele (8), prodhim i pa autorizuar i dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (3), të ndikuarit e paligjshëm ndaj dëshmitarëve(4). **Në vitin 2016** janë mirratuar 68 vendime në bazë të pranimit të fajit te lëndët e krimit të organizuar, për 71 person. Më të përfaqësuara janë: vepra penale trafikim me migrantë (35), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (10), pjesmarrje në ushtri të huaja (5), keqpërdorimi i regjimit të vizave (4). **Në vitin 2017** janë miratuar 21 vendim gjyqësorë në bazë të pranimit të fajit, për 24 persona. Më të përfaqësuara janë: vepra penale trafikim me migrantë (12), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (4), pjesmarrje në ushtri të huaja (1). **Në vitin 2018** janë miratuar 60 vendime në bazë të pranimit të fajit, për 63 persona. Më të përfaqësuara janë: vepra penale trafikim me migrantë (28), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (24), tregëti me person të mitur (4). **Në vitin 2019**, janë mirratuar 91 vendime në bazë të pranimit të fajit për 94 persona. Më të përfaqësuara janë: vepra penale trafikim me migrantë ( 38), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (39). **Në vitin 2020** janë miratuar 85 vendime në bazë të pranimit të fajit për 88 persona. Më të përfaqësuara janë: vepra penale trafikim me migrantë ( 54), prodhim i pa

autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (17), mitmarrje (3). **Në vitin 2021** janë mirratuar 45 vendime në bazë të pranimit të fajit për 48 persona. Më të përfaqësuara janë: vepra penale trafikim me migrantë ( 21), shërbim në ushtri armiqësore (6), pjesmarrje në ushtri të huaj(2).

Tabela 4. Pranimi i fajit K – Penale

Regjistri	Viti	Lëndë të zgjedhura sipas personave
K	2015	774 vendime për 801 person
K	2016	788 vendime për 771 person
K	2017	674 vendime për 678 persona
K	2018	933 vendime për 936 persona
K	2019	1106 vendime për 1109 persona
K	2020	1124 vendime për 1127 persona
K	2021	1116 vendime për 1119 persona

**Në vitin 2015** janë mirratuar 774 vendime në bazë të pranimit të fajit, te lëndët penale që mbajnë shkronjën “K” në shqip “P” – që do të thotë penale, për 801 person. Më të përfaqësuara janë, veprat penale: fshehje e tatimi (18), rrezikim i sigurisë në trafik (47), vepra penale vënie në rezik (4), mashtrim (21), mashtrim gjatë marjes së kredive (14), vjedhje (136), sulm ndaj presonit zyrtarë (9), dhunim (36), përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (30), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (51), mosdhënie e mjeteve për jetesë (22) vepra penale fshehje (10), grabitje (16), pengim i personit zyrtarë në kryerjen e veprimit zyrtarë (10), lëndim truporë (24), vjedhje e rëndë (162), lëndim i rëndë truporë (26), pjesmarrje në turmë që do të pengojë personin zyrtarë gjatë kryerjes së punës së sigurisë (23), falsifiki i dokumenteve (22), mashtrim doganorë (4).

**Në vitin 2016** janë mirratuar 788 vendime në bazë të pranimit të fajit te lëndët penale që mbajnë shkronjmjen “K” për 771 person. Më të përfaqësuara janë, veprat penale: fshehje tatimore (12), rrezikim i sigurisë në trafik (62), vepra penale të shërbyerit (10), mashtrim (20), vjedhje (127), vjedhje e energjisë elektrike, nxemjes dhe gazit natyrorë (24), dhunim (26), përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (23), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, supstancave psikotrope dhe prekursorë (35), mospagesa e alimentacionit (20), fshehje (14), vjedhje grabitqare (6), grabitje (10), lëndim truporë (13), vjedhje e rëndë (157), lëndim i rëndë truporë(21), vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik

(24), vrasje (3 – dy dënime me burg një me kusht), falsifikim i dokumenteve (20), vjedhje (14).

**Në vitin 2017** janë miratuar 674 vendime për 678 persona. Më të përfaqësuara janë veprat penale: fshehje e tatimit (8), rrezikim i sigurisë në trafik (56), keqpërdorim i të dhënave (3), mashtrim (18), vjedhje (60), vjedhje të energjisë elektrike (21), dhunim (30 – dënime me burg 4, tjerat dënim me kusht), përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë, (18), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë (49), mospagim i alimentacionit (23), grabitje (14), lëndim truporë (24), vjedhje e rëndë (142), lëndime të rënda trupore (19), vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik (15), vrasje (5- dënim me burg), falsifikim i dokumentit (52),

**Në vitin 2018** janë miratuar 933 vendime për 936 persona. Më të përfaqësuara janë, veprat penale: ndërtim i kundërligjshëm (4 – me kusht), fshehje e tatimit (17), rrezikim i sigurisë në trafik (43), keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimeve (6), mashtrim (20), vjedhje (74), vjedhje e energjisë elektrike (32- dënime në të holla dhe me kusht), dhunim (37), përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (18), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë (96), mospagese e alimentacionit (19 dënim me kusht – vetëm një dënim me burg), marrja e automjetit (15), grabitje (24), lëndime trupore (19), vjedhje e rëndë (250), lëndim i rëndë truporë (32), vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik (52) vrasje (5 - burg, një dënim me kusht), falsifikim i dokumentit (52).

**Në vitin 2019** janë miratuar 1106 vendime për 1109 persona. Më të përfaqësuara janë, veprat penale: fshehje tatimore (10), dhënie të dëshmisë së rrejshme(6) rrezikim i sigurisë në trafik (48), mashtrim (34), vjedhje (88), vjedhje të energjisë elektrike (41), sulm ndaj personit zyrtarë (26) dhunim (49), përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (26), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë (94), mospagim i alimentacionit (16), marrje rryshfet (4 - jo dënime me burg), grabitje (26), lëndime trupore (23), vjedhje e rëndë (318), lëndim i rëndë truporë (32), vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik (47), vrasje (9- dënim me burg), falsifikim i dokumentit (54), vjedhje (9),

**Në vitin 2020** janë miratuar 1124 vendime për 1127 persona. Më të përfaqësuara janë, veprat penale: dhënie të dëshmisë së rrejshme (11), rrezikim i sigurisë në trafik (37), mashtrim (18), vjedhje (63), vjedhje të energjisë elektrike (9), sulm ndaj personit zyrtarë (14), dhunim (34), përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (27), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë (54), **mosveprim sipas rregullave shëndetësore në kohë pandemie (386)**, grabitje (10), lëndime trupore (16), vjedhje e rëndë (240), lëndim i rëndë truporë (9), vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe

pronës në komunikacion (36), vrasje (7 - dënim me burg), falsifikim i dokumentit (40), mashtrim (23),

**Në vitin 2021** janë miratuar 1116 vendime për 1119 persona. Më të përfaqësuara janë, veprat penale: rrezikim i sigurisë në trafik (74), keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimeve (13), vjedhje (55), vjedhje e energjisë elektrike (22), dhunim (38), përpunimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregëtia e pa autorizuar e armësë apo mjeteve shpërthyesë (21), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë (63), **mosveprim sipas rregullave shëndetësore në kohë pandemie (269)**, lëndime trupore (19), vjedhje e rëndë (217), lëndim i rëndë truporë (24), vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pronës në komunikacion (33), falsifikim i dokumentit (110).

Tabela 5. KOK -OOA – Marrëveshje 2015 – 26.10 2021

Regjistri	Viti	Marrëveshje
KOK- OOA	2015	10 dënim me burg
KOK- OOA	2016	11 – burg 10/1 me kusht
KOK- OOA	2017	10 - burg 9/1 me kusht
KOK- OOA	2018	1- dënim me kusht
KOK- OOA	2019	14 - burg 3/7 me kusht, 3 holla
KOK- OOA	2020	2 - dënim me burg
KOK- OOA	2021	6 - 4 burg/2 me kusht

Më të përfaqësuara janë veprat penale: keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimeve (12), tregëti me migrantë (10), shoqëri kriminele (3), prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psihotrope dhe prekursorë (20), pjesëmarrje në ushtri të huaja (6).

Tabela 6. K-OOA – Marrëveshje 2015 - 26.10.2021

Numri i lëndës	Viti	Baza – shkresa	Lloi i vendimit procedural për person
K-OOA - 143/2015	2015	Organizim i loj.të fatit.	Dënim me kusht
K-OOA -143/2015	2015	Organizim i loj.të fatit.	Dënim në të holla

K-OOA – 48/2015	2015	Rrëmbim	Dënim me burg
K-OOA – 48/2015	2015	Rrëmbim	Dënim me burg
K-OOA - 129/2015	2015	Shkaktim të rezik të për..	Dënim me kusht
K-OOA - 93/2016	2016	Prodh dhe shpern e nark	Dënim me burg
K-OOA - 108/2016	2016	Prodh dhe shpern e nark	Dënim me burg
K-OOA - 14/2016	2016	Lëndim i rëndë truporë	Dënim me burg
K-OOA - 114/2016	2016	Prodhim, mbajtje armë	Dënim me burg
K-OOA	2017	Prodhim, mbajtje drogë	Dënim me kusht
K-OOA	2017	Prodhim, mbajtje drogë	Dënim me burg

Nëse i analizojmë numrat e lartëpërmendur mund të nxjerrim disa konkluzione:

1. Në tre vitet e para numri i KOK-PP- Propozim marrëveshje shënon rritje, në krahasim me tre vitet që pasojnë. E njëjta situatë është edhe me K-PP Propozim marrëveshjet.
2. Për të dy kategorite e lartëpërmendura, në kuadër të secilës nga ata individualisht gjatë viteve të analizuara, lloi i veprave penale lëndë e marrëveshjeve është i njëjtë me përjashtim të periudhave kohore kur paraqiten lëndë specifike, siç është vepra penale shërbim në ushtri të huaja, cënimi i regjimit të vizave dhe vepra tjera.
3. Te të dy kategorite vërehen propozim marrëveshje të refuzuara nga gjykata.
4. Te pranimi i fajit – krim i organizuar, numrat nëpër vite të paraqitura manifestojnë një variacion sa i takon sasisë së aplikimit. Ndërsa te pranimi i fajit – lëndë penale numrat manifestojnë rritje nga viti 2018 – 2021. Veprat më karakteristike gjatë periudhës aplikative ju nënshtrohen ndryshimeve duke nisur nga faktorët socio-ekonomik dhe faktorë tjerë. Duhet të theksojmë se gjatë viteve 2020 dhe 2021, për shkak të kufizimeve të shkaktuara nga pandemia Kovid 19, numrin më të madh të veprave penale të zgjedhura në këtë menyrë e përbën vepra penale “Mosveprim sipas rregullave shëndetësore në kohë pandemie”, me nperfshirje afro 30% të numrit të përgjithshëm të vendimeve në bazë të pranimit të fajit në këtë periudhë. Te kjo vepër penale dominojnë dënimet me kusht dhe janë zhvilluar në procedurë të shkurtuar.
5. Në fund janë paraqitur të dhëna për marrëveshje nga regjistri KOK - OOA, për periudhën 2015 – 26.10 2021, numra dhe dënimë të shqiptuar. Ndërsa në tabelën 6 janë paraqitur të

dhëna nga regjistri K-OOA – Marrëveshje 2015 – 26.10.2021, me vepra penale – numra dhe dënime të shqiptuara duke i paraqitur edhe lëndë konkrete.

6.Nëse analizohet struktura e veprave penale lëndë e këtij instituti penal juridik, mund të konkludojmë se nuk ka kufizime për aplikimin e marrëveshjes në procedurë penale dhe pranimit të fajti gjatë shqyrtimit kryesorë.

## **Kapitulli IV - Pranimi i fajit në procedurë penale dhe liritë e të drejtat e njeriut.**

### **4.1 Mbikëqyrja gjyqësore e aplikimit të pranimit të fajit.**

Mbykqyrja gjyqësore e pranimit të fajit në procedurë penale është garanci për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të dyshuarit/akuzuarit dhe viktimës nga njëra anë dhe interesit publik në anën tjetër, nëpërmjet valorizimit të vullnetit të dyshuarit/akuzuarit dhe mbykqyrjes së aspekteve procedurale.

Rëndësi të veçantë nga aspekti i lartpërmendur, ku promovohet parimi i së drejtës për mbrojtje efektive nga njëra anë dhe shmangjes së vetë-inkriminimit nga i akuzuari nga ana tjetër, ka qasja Gjermane para vitit 1975 kur kundërshtonte aplikimin e kontartës - marrëveshjes në procedurë penale, duke u nisur nga parimi i nevojës së verifikimit të fakteve dhe parimi i hulumtimit të së vërtetës materijale, që më vonë rezultoi me një liberalizim praktik e ligjorë, por me një pozitë dominante të gjykatësit sa i takon mbrojtjes së të drejtave të akuzuarve dhe interesit publik, si kompetencë ligjorë e prokurorit publik.

Në fakt, marrëveshja imponon një veprim të veçantë, duke tejkaluar disa nga fazat e procedurës penale. Pas pranimit të fajit, sipas normave relevante të Ligjit për procedurë penale të Republikës së Maqedonisë gjykata i nxjer vetëm dëshmitë që kanë të bëjnë me vendimin për sanksionin, siç janë: lista nga evidenca ndëshkuese; dokumente që kanë të bëjnë me situatën materijale dhe familjare të të akuzuarit; dëshmi për gjendjen e tij shëndetësore dhe dëshmi të tjera.

Sipas rezultateve nga monitorimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut<sup>202</sup>, në 76% të lëndëve në të cilat ka pasur pranim të fajit janë nxjerur këta dëshmi që kanë të bëjnë me informacione, që e ndihmojnë gjykatën gjatë përcaktimit të sanksionit.

Sipas vokacionit normativ, pranimi i fajit duhet të jet me vullnet të plotë të dyshuarit/akuzuarit dhe ndaj ti mos të ushtrohet forcë ose premtim për ndonjë përfitim. Në këtë kontekst, me rëndësi është të theksohet se legjitime janë pritshmëritë për dënim më të ulët. Bindjet e monitoruesve flasin për mundësinë që në 10% të lëndëve, deklarata për pranimin e fajit të mos ishte dhënë në mënyrë vullnetare. Monitoruesit këtë e kanë konkluduar nga komunikimi i gjykatësit me të akuzuarin dhe disa veprime tjera që aludojnë se është cënuar neni 6 i Konventës Europiane për të drejtat e njeriut, me të cilin ndalohet

---

<sup>202</sup> Fondation open society Macedonia, Системски мониторинг на кривични судски постапки во 2020 година, Скопје,

çdo lloj ndikimi dhe cënimi ndaj të akuzuarit në procedurë për pranimin e fajit ose ndonjë deklaratë tjetër<sup>203</sup>.

Nëse analizohet pozicioni i gjykatësit në SHBA, Rregullat federale të procedurës penale parashikojnë që bisedimet për pranimin e fajit të zhvillohen ekskluzivisht në mes prokurorit publik dhe të akuzuarit (mbrojtjes). Në mënyrë eksplicite është parashikuar se gjykata nuk ka asnjë të drejtë dhe mundësi të ndikojë në vendimin e palëve gjatë bërjes së marrëveshjes (11c, 1FRCP). Roli i gjykatës është vetëm të vërtetojë se prononcimi për fajësi i të akuzuarit është i vullnetshëm, i vetëdijshme dhe i bazuar në fakte. Përveç fakteve të lartpërmendura gjykatësi është i obliguar të kontrollojë, se a e ka kuptuar i akuzuari akt-akuzën dhe a është i njohtuar për të gjitha elementet e veprës penale. **Dhe më me rëndësi, gjykata duhet të vërtetohet se i akuzuari është i vetëdijshëm për të drejtën e tij kushtetuese për gjykim para porotës si dhe llojin e sanksionit penal - juridik. Edhe pse ky pozicion i gjykatësit duket inekzistent në procesin dhe bërjen e marrëveshjes, gjykatësi përsëri është diminus litis i procedurës penale me vet faktin që verifikon fakte të rëndësishme që garantojnë lirite dhe të drejtat themelore të dyshuarit/akuzuarit.**

Në Gjermani një kohë të gjatë zhvillohet një konfrontim praktik dhe teorik në kuadër të parimeve themelore dhe instituteve të ndryshme të Ligjit, ku debatohen çështje me relevancë për të drejtat dhe garancitë minimale të akuzuarve që i nënshtrohen një poçesi të tillë, siç është marrëveshja në procedurë penale, por edhe pozicioni i prokurorisë, përfitimet procesuale të palëve edhe roli dhe pozicionin e gjykatës në këtë drejtim, si dhe komunikimi me palët gjatë dhe jasht shqyrtimit keyesorë në kontekst të kontratës. **Gjatë veprimit prakti, janë zhilluar disa parime** siç janë: komunikimi i gjykatës me pjesëmarrësit procedural jashtë shqyrtimit kryesorë; zbutja e dënimit në rast të pranimit të fajit; parimi i ashtuquajtur “tregëti me drejësi” – d.m.th gjykata nuk mund të jep premtim të përhershëm për lartësinë e dënimit; të akuzuarit ti nxjeren **(iznudat)** shërbime të cilat janë në raport real me kundërshërbimin e gjykatës (koneksitet – lidhshmëri) dhe parime të tjera që meren si bazë për funksionimin praktik. Në këto rethana normative këto parime sigurojnë barazinë e palëve dhe unifikimin e veprimit institucional gjatë procedurës së marrëveshjes. Aspektet e lartpërmendura flasin për një praktikë 30 vjeçare të marrëveshjes, edhe pse ajo nuk ishte e rregulluar me ligj diku viteve të 70 të shekullit XX.

Sipas Ligjit për marrëveshje në proceurë penale të miratuar nga Parlamenti Gjerman në vitin 2009, marrëveshja fitoi formë ligjore. Sipas këtij Ligji, (neni 257), **gjykatësi mund të kontaktojë me pjesëmarrësit në procedurë penale “për mbarrëvajtjen e mëtutjeshme dhe rezultatet e procedurës”, si dhe për pasojat juridike që do ti gjykojë.** Gjykatësi mund të jep propozim ku do të theksohet kufiri mu i ulët dhe ai më i lartë i sanksionit. Ndërsa deri te marrëveshja vjen atëherë kur prokurori publik do ta pranojë propozimin e gjykatës. I akuzuari duhet të informohet për pasojat juridike. **Sipas këtij ligji, gjykata ka rol aktiv në bërjen e marrëveshjes,** me kompetenca konkrete procesuale që në njërën anë garantojnë të

---

<sup>203</sup> Foundation open society Macedonia, Системски мониторинг на кривични судски постапки во 2020 година, Скопје, 2021, fq, 23.

drejtat e të akuzuarit, ndërsa në anën tjetër janë garantë të interesit publik të cilin e përfaqëson prokurori publik.

Duke pasur parasysh faktin se propozim – marrëveshja shkon në verifikim të gjykatësi i procedurës paraprake ose kryetari i këshillit, nëse marrëveshja është arritur pas vërtetimit të aktakuzës (neni 317 i LPP të Republikës së Serbisë i parashikon kushtet kur ajo mund të pranohet) dhe duke i pasur parasysh kompetencat e gjykatësit i cili nuk mund ta ndërojë marrëveshjen por mund vetëm ta pranijë ose refuzojë, me të drejtë mund të thuhet se kontrolli gjyqësorë i marrëveshjes së prokurorit publik ma të akuzuarin, është një temë shumë e rëndësishme. Disa nga praktikuesit e ligjit potencojnë natyrën kontraktuese të marrëveshjes, që të mbrojnë interpretimin **për kufizimin e autorizimeve të gjykatës** që ka të bëjë me kontrollin e marrëveshjes, në një kontrollë formale. Kjo dë të thotë se palët kanë diskrecion absolut për negociim dhe marrëveshje. Tjerët mendojnë se gjykatësi si garant i ligjshmërisë së procedurës nuk duhet të vendoset vetëm në rolin e vërtetuesit të formës për marrëveshjen e arritur në mes palëve<sup>204</sup>.

Por duke i pasur parasysh nenin 317 dhe 318 të LPP të RS, dhe mundësite ligjore të gjykatësit konform marrëveshjes së propozuar, rrjedh se gjykatësi ka rol më efektiv se ai formal ose i verifikuesit të marrëveshjes, këtë duke pasur parasysh verifikimin e fakteve që kanë të bëjnë me vetë marrëveshjen dhe në veçanti vullnetin dhe prirshmëritë e të akuzuarit<sup>205</sup>.

Neni 233(10) i KPP-së i Republikës së Kosovës ua ndalon gjyqtarëve pjesëmarrjen në negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, por ua lejon atyre që të “caktojnë afat të arsyeshëm kohor, jo më të gjatë se tre (3) muaj për përfundimin e negociatave në mënyrë që të pengohet zvarritja e procedurës.

Edhe pse sisteme të ndryshme juridike parashikojnë forma të ndryshme të marrëveshjes dhe mbykqyrjes gjyqësore, dominante janë dy koncepte bazë të cilët manifestojnë pozicionin e gjykatësit si garant i parimit të oficalitet në bërjen e marrëveshjes gjegjësisht pranimin të fajit, të cilët dallohen për nga niveli i involvimit të gjykatësit në këtë proces. Egzistojnë edhe modifikime të ndryshme nga sisteme të përziera penalo juridik, por konteksti ngel i njejtë – mbykqyrje aktive të vullnetit të dyshuarit/akuzuarit dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të tij, duke mos haruar edhe interesin publik dhe viktimën.

## 4.2 E drejta e ankimit.

E drejta e ankimit të aktgjykimit të marë në bazë të deklaratës për pranimin e fajit është një nga çështjet më të rëndësishme që mundëson evitimin e padrejtësive të

<sup>204</sup> Водич за применс законика о кривичном поступки Републике Србије, Београд 2015, /vodic%20za%20primenu%20zakonika%20o%20krivicnom%20postupku%20republike%20srbije%20(2015). pdf.fq.64,

<sup>205</sup> Ibid,

mundshme gjegjësisht cënimit eventuale të vullnetit të akuzuarit, në këtë rast tash më të gjykuarit.

Mundësinë dhe bazat e ankimit të një vendimi të miratuar në këtë mënyrë janë parashikuar në legjislacionin e shteteve, më konkretisht në Ligjin për procedurë penale. Në LPP të Republikës së Serbisë, në aktykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtorë gjykata mes tjerave potencon se i akuzuari heq dorë nga e drejta për gjykim dhe kufizon të drejtën për ankim kundër vendimit të gjykatës të miratuar në bazë të marrëveshjes.

Sipas legjislacionit kroat, mundësia për ankim varet nga lloji i vendimit në propozim marrëveshjen e ofruar si dhe nga baza e kundërshtimit. **Sipas këtyre kriterëve, kundër vendimit të këshillit gjyqësorë me të cilin refuzohet marrëveshja ankesa nuk është e lejuar.** Edhe ndaj aktgjykimi në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajti nuk mund të aplikohet ankim për vendimin për sanksionin penal juridik, sekuestrimin e të mirave materiale, shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pronësore juridike, si dhe kundër gjendjes faktike të gabuar ose jo të plotë, më përjashtim kur i akuzuari për dëshmitë për përjashtimin e kundërligjshmërisë dhe fajit, ka marrë vesh pas miratimit të aktgjykimit (neni 361 alinea dhe neni 364 alinea 1 dhe 2 i LPP të RK).

Sipas LPP të Malit të zi, kundër vendimit me të cilin marrëveshja për pranimin e fajit miratohet ankesë mund të paraqet i dëmtuari, ndërsa kundër vendimit me të cilin marrëveshja refuzohet, prokurori shtetërorë dhe i akuzuari. Kundër, aktgjykimit të miratuar në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajit është e lejuar ankesa vetëm në rast kur aktgjykimi nuk është në pajtueshmëri me marrëveshjen e aritur (neni 301 alinea 10 dhe neni 303 alinea 2 LPP i Republikës së Malit të zi).

Në ligjin për procedurë penale të Bosnjës e Hercegovinës, është përjashtuar mundësia e kontestimit të vendimit të gjykatës ndaj tekstit të propozim-marrëveshjes së ofruar. Pasojat e vendimit gjyqësorë janë të dyfishta. (1) nëse gjykata pranon marrëveshjen për pranimin e fajit, deklarata e të akuzuarot notohet në procesverbal dhe vazhdon shqyrtimi për shqiptimin e sanksionit penal të parashikuar me marrëveshje, (2) nëse gjykata refuzon marrëveshjen, vendimi u konfirmohet palëve dhe njëkohësisht përcaktohet data për mbajtjen e shqyrtimit kryesorë<sup>206</sup>.

Sipas ligjit për procedurë penale të Shqipërisë, ankimi i vendimit gjyqësorë nuk është i lejuar. Paditësi mund të ankojë vetëm vendimin e gjykatës që ka të bëjë me hudhjen (refuzimin) e lëndës (nenin 407 të LPP të RSH).

Sipas KPP të Republikës së Kosovës, marrëveshja me shkrim mund të përfshijë dispozitë me të cilën palët **pajtohen për kufijtë e dënimit**, që do të propozohen nga ana e Prokurorit të shtetit, nëse i pandehuri bashkëpunon substancialisht. Ndërsa, nëse gjykata shqipton dënim i cili dëmton njërin palë, pala do të ketë të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin (paragrafi 13 i nenit 233 të KPPK).

---

<sup>206</sup> Prof d-r Stanko Bejatovic, Pojednostavljene forme postupanja kao bitno obelezje reformi krivicnog procesnog zakonodavstva yemalja regiona, Osce Misija u Srbiji, Beograd 2013, fq.21.

LPP i RMV parasheh mundësi të redukuara për ankim të një vendimi të miratuar nga gjykata pas paraqitjes së propozim marrëveshjes. Neni 381 alinea 4 – Miratimi i aktgjykimit në bazë të pranimit të fajit gjatë shqyrtimit kryesorë, potencon se aktgjykimi ose pjesë e aktgjykimit që është sjellur në bazë të pranimit të fajit të akuzuarit gjatë shqyrtimit kryesorë, nuk mund të jetë lëndë e ankimit nga i akuzuari për shkak të gjendjes faktike jo të plotë ose të gabuar. Sipas nenit 488 alinea 5 e LPP, gjykatësi i procedurës paraprake e njohton prokurorin publik, të akuzuarin dhe mbrojtjen e tij, se pranimi i propozim - marrëveshjes konsiderohet si heqje dorë, nga e drejta për ankim ndaj aktgjykimit të sjellur në bazë të propozim marrëveshjes. Palët duhet të jenë të vetëdijshëm se heqja dorë nga ankimi nuk mund të revokohet (neni 412 alinea 3 LPP). Në situatë kur refuzohet propozim – marrëveshja, nuk mundësohet e drejta e ankimit (neni 489 alinea 3 LPP)<sup>207</sup>.

#### **4.3 Revokimi i pranimit të fajit, aspekte praktike.**

Revokimi i pranimit të fajit është një nga çështjet më diskutabile të këtij instituti penalo juridik. Kjo duke u nisur nga aspektet normative, qëllimet dhe efektet që duhet të arrihen gjatë aplikimit të tij. Në praktikën gjyqësore këto çështje debatohen dhe zgjidhen nëpërmjet vendimeve konkrete si dhe qëndrimeve të ndërtuara në forume të ndryshme.

Në takimin punues për unifikimin e praktikës nacionale gjyqësore në nivel të gjykatave të Apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut i mbajtur në Manastir më 23 dhe 24 nëntorë të vitit 2017, në lidhje me pyetjet e parashtruara nga çështjet penale të dhomave penale u miratua një konkluzion në lidhje me çështjen e lartëpërmendur.

**Pyetja e patrashtuar:** “A mundet njëherë deklarata e dhënë për pranimin e fajit të revokohet në situatë kur shqyrtimi fillon nga e para dhe kur aktgjykimi i miratuar në bazë të pranimit të fajit, në bazë të nenit 381 të LPP, është shfuqizuar për shkak të cënimeve esenciale të normave të LPP. A duhet i akuzuari to ftohet përsëri të deklarohet për fajësinë”.

**Konkluzion:** “Në situatë kur shqyrtimi kryesorë ka filluar nga e para, ose kur aktgjykimi është miratuar në bazë të pranimit të fajit nga neni 381 i LPP ka qënë i shfuqizuar për shkak të cënimeve esenciale të normave të LPP, i akuzuari mund ta revokojë deklaratën për pranimin e fajit, përveç në rast se aktgjykimi kundërshtohet për shkak të mangësive të vullnetit ose nëse prokurori publik ka ndëruar përshtetimin e aktakuzës”.

Me vendimin Kz 2. Nr.39/2019, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i pranon ankesat, i shfuqizon aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë dhe lëndën e këthen në rishqyrtim për shkak të cënimit esencial të normave të procedurës penale nga neni 415 alinea 2 dhe 3 e LPP, për shkak se me këtë mënyrë të veprimit është bërë cënim i së drejtës për mbrojtje të akuzuarit dhe cënim i parimit të barazisë se armëve, që ka ndikuar në vendosjen e drejtë dhe ligjore para gjykatës së shkallës së dytë.

---

<sup>207</sup> Për mundësinë e ankimit dhe paraqitjes së mjeteve të jashtëzakoshme juridike, shih, Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајџиев, Гордан 2. Лажетиќ, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Делчо, Мисија на Обсе во Скопје, ноември 2018, страна 976.

Duke u bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë bazohet në deklaratën për pranimin e fajit nga i akuzuari, e dhënë në procesverbalin e shqyrtimit kryesorë para gjykatës së shkallës së parë. Pas shfuqizimit të aktgjykimit nga Gjykata e apelit, gjatë rishqyrtimit të lëndës nga gjykata e shkallës së parë, i akuzuari në fjalët hyrëse ka revokuar deklaratën për pranimin e fajit të dhënë më parë. Revokimi është bërë në prezencë të avokat-mbrojtësit të tij. Më një veprim të tillë nuk janë aplikuar në mënyrë jo të drejtë normat e procedurës penale dhe nuk ka cënim të së drejtës për mbrojtje nga neni 415 alinea 1 pika 8 e LPP, duke pasur parasysh të drejtën e diskrecionit të akuzuarit, për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, në secilën nga instancat për të realizuar të drejtën e tij për mbrojtje dhe procedurë të drejtë gjyqësore në përgjithësi. Gjatë vendosjes Gjykata supreme ka marrur parasysh edhe juridikcionin e Gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut, sipas së cilës e drejta e personit të mos - inkriminohet vetëveten aplikohet në procedurë penale ndaj të gjitha llojeve të veprave penale, nga më të thjeshtat deri te ata më të ndërlikuar. ( Saunders v the Unitet Kingdom 1991).

Gjithashtu dispozitat e nenin 6 të Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, nuk ndalojnë një person që me vullnetin e tij të lirë të apstinojë (heq dorë) nga garancitë për një procedurë të drejtë gjyqësore. Mirëpo për të qenë efektive (për qëllimet e Konventës), një apstinim i tillë duhet të vërtetohet pa mëdyshje dhe të jetë i përcjellur me masa minimale mbrojtëse, që janë ekuivalente me rëndësinë e tij. Në mënyrë plotësuese, ajo nuk mund të jetë në kundërshtim me asnjë interes të rëndësishëm publik (Hermi v Italy( (GC) nr.18114/02, §§, ECHR 2006-XII).

Si rrjedhojë e kësaj, para se të thuhet se një i akuzuar në mënyrë implicite nëpërmjet sjelljes së tij ka abstenuar nga një e drejtë e rëndësishme në pajtueshmëri me nenin 6 të Konventës, nevojitet të vërtetohet që ai ka mundur me vetëdije të plotë të parashikojë pasojat e veprimit të tij (Hermi v Italy) (GC), nr. 18114/02 §§ 74 ECHR 2006-XII dhe ( Sejdovic v Italy) (GC), nr.56581/00, §§ 87 ECHR 2006-II).

Duke pasur parasysh argumentet e lartpërmendura, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut vlerëson se i akuzuari, në kushte kur kemi aktakuzë të pa ndëruar mund që gjatë rishqyrtimit para gjykatës së shkallës së parë, të revokojë deklaratën e dhënë për pranimin e fajit, që është e drejtë e tij e diskrecionit si dhe e drejtë e zgjedhjes së tij. Në rastin konkret i akuzuari, me vetëdije në prezencë të avokatit – mbrojtës të tij, ka revokuar (tërhequr) deklaratën e tij për pranimin e fajit me një parashikim të arsyeshëm dhe të plotë të pasojave juridike nga veprimi i tij, në drejtim të realizimit efektiv të së drejtës për mbrojtje dhe të drejtës së akuzuarit që të mos inkriminohet vetëveten<sup>208</sup>.

Duke u nisur nga arsyetimi i këtij vendimi, Gjykata supreme – Dhoma për vepra penale, ka miratuar një **Sentencë**: *“Nuk ka cënim esencial të dispozitave të procedurës penale dhe cënim të së drejtës për mbrojtje, kur i akuzuari në aktakuzë të pa ndëruar gjatë rishqyrtimit para gjykatës së shkallës së parë, ka revokuar – tërhequr, paraprakisht deklaratën e dhënë për pranimin e fajit, që është e drejtë e tij e diskrecionit, për të cilën*

---

<sup>208</sup> Shih, Gjykata supreme e RMV, Vendim Vvk2 nr. 39/2019 nga 02.07.2020.

*gjykata kujdeset sipas pozitës zyrtare në secilën instancë, për të realizuar të drejtën e tij për mbrojtje efektive dhe të drejtën e tij që mos ta inkriminojë vetëveten”.*<sup>209</sup>

Duke u nisur nga ky argumentacion i gjykatës më të lartë i bazuar mbi parimet bazë të legjislacionit nacional, dhe në veçanti në praktikën e Gjykatës Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund të konstatojmë se praktika gjyqësore në RMV promovon të drejtën e revokimit të deklaratës për pranimin e fajit gjatë rishqyrtimit, në situatë të aktakuzës së njejtë (pandëruar), me qëllim të mbrojtjes së tij efektive dhe të drejtës së tij që mos të inkriminojë vetëveten.

Një pozicion i tillë mund të vërehet tërthorazi edhe në një nga vendimet të Gjykatës supreme të Kroacisë<sup>210</sup>.

Një situatë të kundërt kemi në lëndën Vkz 2 Nr.19/2019 nga 09.07.2020 viti, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, atëherë kur **i akuzuari jep deklaratë për pranimin e fajit në shqyrtim kryesorë para Gjykatës së apelit**, pas precizimit të aktakuzës.

Në këtë lëndë pas ndërrimit të aktakuzës në shqyrtim kryesorë para gjykatës se apelit, i akuzuari jep deklaratë për pranimin e fajit. Vendimi paraprak i gjykatës së shkallës së parë është miratuar pas një gjykimi të regullt dhe jo në bazë të deklaratës për pranimin e fajit nga i akuzuari<sup>211</sup>.

Në shqyrtimin e mbajtur para Gjykatës së apelit Shkup, pas dhënies së fjalës përfundimtare prokurori publik ka bërë precizimin e aktakuzës, në mënyrë që ka fshirë dispozitën blankete të nenit 19 alinea 3 të Ligjit për siguri të komunikacionit rrugorë dhe në vend të normës blankete të nenit 38 alinea 1 e të njejtit Ligj, ka vënduar nenin 37 alinea 1 nga po ky Ligj, pa ndryshuar përshkrimin e veprimeve të akuzuarit dhe kualifikimin juridik të veprës penale. Pas këtij precizimi mbrojtja ka kërkuar shtyerje të seancës. Këtë kërkesë gjyqi e ka pranuar dhe ka caktuar vazhdim të shqyrtimit për datë 01.04.2019, në të cilën i akuzuarë ka dhënë deklaratë për pranimin e fajit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Në favor të këtij vendimi, Gjykata supreme ka cituar praktikën e Gjykatës Europiane, sipas së cilës në situatë të rikualifikimit të fakteve gjatë procedurës penale të akuzuarit duhet ti jepet mundësi obligative, ti realizojë të drejtat e tij për mbrojtje në mënyrë praktike, efikase – të frytshme dhe në kohë (Pelissier and Sassi v. France) (GC), nr.25444/94, § 62, ECHR 1999-II dhe (Block v. Hungary), nr.56282/09, § 24 nga 25 janar 2011.

---

<sup>209</sup> Sentenca, Veb Gjykata supreme..

<sup>210</sup> Vrhovni sud Republike Hrvatske, Izbor Odluka, Narodne Niovine, 2014, fq.214-215, Gjykata supreme e Kroacisë , Aktgjykimin I Kz Us 41/2012, nga 12.09.2013 viti. Si rezultat i këtij vendimi të Gjykatës supreme, obliogohet gjykata e shkallës së parë edhe njëherë të vlerësojë ligjshmërinë e marrëveshjes dhe njëherit të ju mundësojë palëve të ndërojnë marrëveshjen në pajtueshmëri me mangësitë e konstauara nga kjo gjykatë. Nëse palët nuk e ndërojnë marrëveshjen ose tërhiqen nga ajo, gjykata e shkallës së parë do të caktojë seancë për gjykim duke marrë si bazë aktakuzën e vërtetuar.

<sup>211</sup> Shih, Gjykata supreme e RMV, Vendim Vkz2 nr. 19/2019 nga 09.07.2020.

Në rastin konkret, Gjykata supreme vlerëson se në mënyrë adekuate janë aplikuar dispozitat e LPP nga gjykata e apelit, për shkak se ka aplikuar dispozitat ligjore pas precizimit të aktakuzës, me të cilën nuk është cënuar identiteti objektiv i aktakuzës, në një situatë kur egziston kualifikim i njejtë i veprës penale si dhe pa ndëruar përshkrimin e veprimeve të akuzuarit. Në këtë mënyrë me të drejtë gjykata e apelit i ka mundësuar të akuzuarit të prononcohet për fajin, mundësinë ta prezentojë mbrojtjen e tij, të shpreh vullnetin e tij lirshëm dhe pa mëdyshje i vetëdijshëm për pasojat e një veprimi të tillë. Gjykata supreme konstaton se në këtë mënyrë është respektuar parimi i “barabarësisë së mjeteve” – armëve, në mes të prokurorisë dhe të akuzuarit, konform nenit 6 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut, (Bobek v. Poland) nr.68761/01, § 56, 17 korik 2007; (Klementyev v. Russia) nr.46503/99, § 95, 16 nëntorë 2006.

Duke i'u referuar këtij vendimi, Gjykata supreme ka miratuar **Sentencë**: *“Në mënyrë të drejtë janë aplikuar dispozitat e nenit 381 alinea 2 i Ligjit për procedurë penale, kur gjykata e shkallës së dytë pas precizimit të akuzës në pjesën e normës blanketë, pa ndërimi të përshkrimit të veprimeve të akuzuarit dhe kualifikimit juridik të veprës penale, i ka mundësuar të akuzuarit të deklarojë në lidhje me fajin, të deklarojë vullnetin e tij në mënyrë të pakontestueshme i vetëdijshëm dhe me një parashikim të arsyeshëm për pasojat, me çka është mundësuar respektim i mirfilltë i parimit të barabarësisë së mjeteve dhe është arritur baraspeshë e drejtë mes palëve”<sup>212</sup>.*

Në këtë Sentencë, janë gërshetuar të gjitha parimete themelore që kanë të bëjnë me sigurimin e kushteve për një gjykim të drejtë dhe vëndosjen e një barazpeshë të mirfilltë në mes palëve, duke u bazuar edhe në praktikën e Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut, të shprehur në vendimi e lartëpërmendur të Gjykatës supreme, bazë e kësaj sentence.

Rëndësi të veçantë në drejtimin e lartëpërmendur ku promovohet parimi i së drejtës për mbrojtje efektive dhe ikjes së vetë- inkriminimit nga i akuzuari, ka qasja Gjermane para vitit 1975, kur kundërshtonte aplikimin e kontartës - marëveshjes në procedurë penale duke u nisur nga parimi i nevojës së verifikimit të fakteve dhe parimin e hulumtimit të së vërtetës materijale, që më vonë rezultoi me një oportunitet të arsyeshëm ligjorë me një pozitë dominante të gjykatës në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të akuzuarve dhe interesit publik.

### **Në një situatë tjetër paraqitet qëndrimi i Gjykatës supreme për pranimin e dhunshëm të fajit.**

Në lëndën Kvp 2. Nr.54/2020, Gjykata supreme në pretendimet e mbrojtjes se deklarata për pranimin e fajit është dhënë në mënyrë të dhunshme konstaton:

Në rastin konkret, aktgjykimi i plotëfuqishëm është miratuar në bazë të pranimit të fajit të gjykuarit, të cilën e ka dhënë në fillim të shqyrtimit kryesorë në procedurë të parashikuar me ligjit. Gjatë shqyrtimit, gjykata konstaton se pretendimet për pranim e fajit

---

<sup>212</sup> Shih Veb, Gjykata supreme.

me anë të një deklarate të dhunshme, janë të pa baza dhe nuk janë të mbështetura me dëshmi. Këta pretendime paraqiten për herë të parë para kësaj gjykate. Në bazë të kësaj Gjykata supreme vlerëson se pretendimet për gjoja pranim të fajit në mënyrë të dhunshme janë të pabaza, në mungesë të dëshmive për pranim të dhunshëm të fajit që të mund të konsiderohet si pohim i argumentuar (Sinistaj and Others v. Montenegro, nr 1451/10). Duke u bazuar në këtë vendim Gjykata supreme ka miratuar Sentence, e cila është shpallur në faqen zyrtare të Gjykatës me datë 03.02.2021<sup>213</sup>. Problematikën e revokimit të deklaratës për pranimin e fajit e kanë të njohur edhe legjislacioni<sup>214</sup> dhe praktika Britaneze edhe ajo Amerikane<sup>215</sup>, nëpërmjet rasteve konkrete. Kjo çështje mund të shihet edhe në legjislacionet dhe praktikat e vendeve të rajonit, dhe ka për qëllim përmbushjen e parimit të dispozicionit të lirë të vullnetit nga aktorët e procedurës penale.

---

<sup>213</sup> Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, <http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/>, Praktika gjyqësore – Sentenca – krivicna oblast – Zakon ya krivicna postapka – priznanie na vina.

<sup>214</sup> The Criminal Procedure Rules 2020, UK Statutory Instruments 2020 No, 759 (L. 19), <https://www.legislation.gov.uk/uksi/2020/759/contents/made>

<sup>215</sup> U.S. Supreme Court, Brady v. United States, 397 U.S. 742 (1970), Brady v. United States, No. 270, Argued November 18, 1969, Decided May 4, 1970, 397 U.S. 74

## V. Përfundimi dhe rekomandime

1. Pranimi i fajësisë dhe marrëveshja në procedurë penale është një institut i rëndësishëm penal juridik dhe paraqet një qasje të moderuar në procedimin dhe zgjedhjen e veprave penale. Analizat komparative flasin për një konfrontim të vazhdueshëm të ithtarëve për verifikimin e fakteve dhe atyre që promovojnë dispozicionin e lirë të palëve gjegjësisht zgjedhje konsensuale të çështjes penale. Në aplikimin e marrëveshjes gjegjësisht pranimin e fajësisë theks të veçantë vëndohet mbi parimet bazë të së drejtës penale të njohura nga të gjithë sistemet juridike. Vlen të thekslohet se e drejta tradicionale penale-procedurale dhe praktika gjyqësore, që ishin karakteristrike për Europën gjatë kohë e kundërshtonte marrëveshje për pranimin e fajit, gjegjësisht të drejtën konsensuale duke u bazuar në parimin se reagimi ndëshkues është përcaktuar në mënyrë të prerë me ligj dhe ai nuk njihet dialog, kompromis, as marrëveshje, duke pasur parasysh faktin se qëllimi kryesorë, është mbrojtja e vlerave fundamentale sociale.

2. Parimisht njihen disa lloje të marrëveshjes dhe pranimin të fajit në procedurë penale. Sistemi penal amerikan njihet dy forma të marrëveshjes në procedurë penale, edhe atë, marrëveshje për aktakuzën ose e njohur si “charge bargaining” dhe marrëveshje për sanksionin ose “sentence bargaining. Vendet e sistemeve juridike kontinentale më tepër janë të orientuara kah marrëveshja për sanksionin, duke marrë parasysh edhe marrëveshjen – bashkëpunëtorë i drejtësisë, si lloj i veçantë i marrëveshjes në procedurë penale, të cilën e karakterizojnë disa modalitete varësisht se bashkëpunëtori është në cilësinë e të dyshuarit ose tash më të gjykuar dhe është në vuajtje të dënimit.

3. Pranimi i fajit mundëson që procedura penale të mbarojë me një rritëm të përshpejtuar, të zvogëlojë harxhimet procedurale, të zvogëlojë stigamatizimin e të akuzuarit dhe në fund, mund të ketë një mbarim të kontrolluar gjegjësisht të dëshiruar nga palët pjesëmarrëse në një çështje penale juridike. Njëkohësisht në këtë procedurë shmangët shqyrtimi kryesorë dhe prezantimin e dëshmive për gjendjen faktike që i mundëson prokurori shfrytësim racional të kapaciteteve për lëndë të cilat shkojnë në gjykim.

4. E drejta kontaktuese nuk do të thotë keqpërdorim të kompetencave të gjëra të prokurorit publik dhe cënim të parimit të oficielitetit, kjo duke pasur parasysh rolin aktiv të palëve dhe gjykatësit gjatë verifikimit të marrëveshjes apo miratimit të aktgjykimit në bazë të deklaratës për pranimin e fajit. Aplikimi i pranimin të fajit në procedurë penale imponon nevojën e përfshirjes efektive të aktoreve procedural e veçanërisht mbrojtjes së të akuzuarve, me qëllim të evitimit të keqpërdorime eventuale.

5.E drejta anglosaksone arriti të imponojë këtë institut penalo juridik për një përdorim më të gjërë, te më shumë sisteme penalo juridike kontinentale të cilët të drejtën kontraktuese e vëndojnë në një dipotri më të rehtë, duke ndërtuar mekanizma për ruajtjen e elementeve të parimit të vërtetimit të fakteve dhe parimit të oficielitetit, me theks të veçantë mbi pozicionin e të dëmtuarit, gjithnjë duke pasur parasysh liritë dhe të drejtat e njeriut gjatë zhvillimit të një procedure të tillë, nëpërmjet ngritjes së pozicionin të gjykatësit në këtë procedurë si garanci e të drejtave të lartëpërmendura.

6.Problemi i barazisë së palëve gjatë marrëveshjes për pranimin e fajit është segmenti kryesorë reth të cilit zhvillohen debate teorike e praktike, duke kontestuar diskrecionin e gjërë të prokurorit publik dhe mjetet që ai ka në dispozicion ndaj të pandehurit dhe mbrojtjes. Një debat i tillë është prezent edhe në SHBA, ku më shumë teoreticien nxjerin në pah anët negative të marrëveshjes në procedure penale në SHBA, siç është diskrecioni i tepëruar i prokurorit, nevoja e kufizimit të marrëveshjes për pranimin e fajit në disa lloje të akuzave, siç janë krimet më pak të rënda, si dhe përfshirje të gjykatësit dhe mbrojtjes në negociimin e akuzës, në mënyrë që të sigurohet një ekuilibër në mes të gjithë pjesëmarrësve ligjorë. Në përgjithësi fokusi i reformave dhe e ardhmja e këtij instituti shihet në nevojën për të adresuar pabarazitë brenda sistemit dhe definimin e pozicionit të pjesëmarrësve në marrëveshje në procedurë penale.

7.Vendet me sistem juridik kontinental pranuan përparësitë e këtij instituti penalo juridik, duke modifikuar një pjesë të tij që ka të bëjë me segmentin e barazisë së palëve nëpërmjet një pozicioni të veçantë të gjykatësit, me qëllim të ruajtjes së interesit publik (parimit të legalitetit) dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të akuzuarit në procedurë për pranimin e fajësisë. Aplikimi i këtij instituti në të drejtën kontinentale në fillim hasi në një refuzim, duke favorizuar parimin e oficielitetit dhe vërtetësisë materijale.

8.Marrëveshja për pranimin e fajit është një nga reformat e fundit e vendeve në rajon dhe bëhet fjalë për një institut që për bazë ka negociimin paraprak për pranimi e veprës penale, në mes të akuzuarit dhe prokurorit publik dhe në fund duke finalizuar atë me pranimin ose jo të propozim - marrëveshjes nga gjykata. Statistikat rajonale manifestojnë një qasje reale të sistemeve juridike ndaj këtij instituti penalo juridik, duke llogaritur në këtë edhe traditën e sistemeve, qasjen praktike, gadishmërinë dhe kapacitete e prokurorive publike. Vlen të theksohet se vendet e rajonit manifestojnë një përpikshmëri legislative sa i takon këtij instituti penalo juridik, në të cilat dominojnë motive anglosaksone të plotësuar me standarde të së drejtës kontinentale dhe në veçanti garancive që siguron Konventa europiane dhe Gjykata Europiane për të drejta e njeriut.

9.Me reformën e vitit 2010 edhe Republika e Maqedonisë e legalizoi pranimin e fajit dhe marrëveshjen në procedurë penale, duke ju bashkangjitur sistemeve dhe trendeve bashkëkohore si dhe favoreve që sjell ky institut në përshejtimin e procedurës penale, zvogëlimin e harxhimeve dhe zmadhimin e efikasitetit të organeve gjyqësore. Ky institut zgjoi kureshtjen e aktorëve procedural dhe sistemit juridik në përgjithësi. Statistikat relevante manifestojnë një aplikim meritorë të këtij instituti penalo juridik, ndërsa praktika gjyqësore luan një rol të rëndësishëm në tejkalimin e zbrazëtirave ligjore dhe krijimin e standardeve

adekuate, që sigurojnë aplikim të unifikuar të ligjit, transparencë dhe opinion të qëndrueshëm për arsyeshmërinë e këtij instituti.

10. Mbykqyrja gjyqësore e pranimit të fajit në procedurë penale është garanci për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të dyshuarit/akuzuarit dhe viktimës nga njëra anë dhe interesit publik në anën tjetër, nëpërmjet valorizimit të vullnetit të dyshuarit/akuzuarit dhe mbykqyrjes së aspekteve procedurale. Është me rëndësi të theksohet se gjatë aplikimit të këtij instituti juridik, janë zhvilluar parime relevante që sigurojnë barazinë e palëve dhe unifikimin e veprimit ishtitucional gjatë procedurës së marrëveshjes.

11. E drejta e ankimit të aktgjykimit të marë në bazë të deklaratës për pranimin e fajit, është një nga çështjet më të rëndësishme që mundëson evitimin e padrejtësive të mundshme gjegjësisht cënimet eventuale të vullnetit të akuzuarit, në këtë rast tash më të gjykuarit. Sisteme të ndryshme juridike të drejtën e ankimit e kushtëzojnë me llojin e vendimi gjyqësorë në faza të ndryshme të procedurës penale, duke veçuar heqjen dorë nga ankesa në marrëveshje për pranimin e fajit.

12. Revokimi i pranimit të fajit është një nga çështjet më diskutabile të këtij instituti penalo juridik, duke pasur parasysh aspektet normative, qëllimet dhe efektet që duhet të arrihen gjatë aplikimit të tij. Nëse i referohemi legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në situatë kur shqyrtimi kryesorë ka filluar nga e para, ose kur akgjykimi që është miratuar në bazë të pranimit të fajit nga neni 381 i LPP ka qënë e shfuqizuar për shkak të cënimeve esenciale të normave të LPP, i akuzuari mund ta revokojë deklaratën për pranimin e fajit, përveç në rast se akgjykimi kundërshtohet për shkak të mangësive të vullnetit ose nëse prokurori publik ka ndëruar përshkrimin e aktakuzës. Një mundësi të revokimit të pranimit të fajit parashikohet edhe në praktikën Amerikane dhe Britaneze, që është në funksion të promovimit të dispozicionit të lirë të vullnetit të palëve në procedurën e marrëveshjes penale.

### **Rekomandim:**

Duke i analizuar praktikat e ndryshme gjyqësore dhe modalitetet e pranimit të fajit, si dhe statistikat relevante të cilat manifestojnë një ritëm të përsheptuar të zgjedhjes së çështjeve penale nga aplikimi i këtij instituti dhe favore tjera, rrjedhimisht imponohet rekomandimi për një aplikim më të shprehur të këtij instituti penalo juridik, gjithnjë duke pasur parasysh parimet bazë që garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut nga njëra anë dhe mbrojtjen e interesit publik nga ana tjetër.

### **Bibliografija:**

1. Ante Novokmet, mag.jur. Asistent Pravnog Fakulteta u Osijeku, Austriski zakon o kaznenom postupku iz 1853 godine, sosvrto na njegovu ulogu u povjesti Hrvatskog kaznenog procesnog prava, Pregledni znanstveni rad UDK 343.1(436:497.5)(091), (PDF) Austriski zakon o kaznenom postupku iz 1853. godine s osvrtom na njegovu ulogu u povijesti hrvatskog kaznenog procesnog prava,
2. Besa Arifi-Viktima-ne-Drejte-Penale-AJLS-2008.pdf, Roli i viktimës në të drejtën penale bashkëkohore – RSHSL, Konferenca Vjetore 2008, Riridfinimi i rolit të viktimës në të drejtën penale bashkëkohore përmes reformave ligjore,
3. Д-р Гордана Бузаровска7 м-р Бобан Мисовски МРКПК,
4. Pojednostavljene forme postupanja u krivičnim stvarima, Rgionalna krivičnoprocesna zakonodavstva i iskustva u primeni, Obse misija u Srbiji, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>.
5. Osce, Marrëveshje për pranimin e fajtit – Doracak për profesionist, Shkup, dhjetorë 2010,
6. I Kovco, Kazna zatvor – Zasto i kuda, Hrvatski Ljetopis za kazneno pravo i praksu, Zagreb, vol.8 broj 2/2001,
7. Kondziela A “Tater – Opfer-Eusgleich und Unschuldsvemutung fur Kriminologie und Strafrechtreform”.
8. Xhemali Saiti, Алтернативните мерки наспроти новите облици на криминалитет, Скопје 2013,
9. Д-р Лупчо Сотировски & Олга Ѓуркова, Медијација во кривичните предмети, Скопје, 2011, - Recommendation No.R (99) 19 of the Committee of Ministres to member States concerning mediation in penal matters, 15 shtator 1999.
10. Federal Rules of Criminal Procedure, posljednja izmjena i dopuna 31. prosinca 2011., Burimi: <http://judiciary.house.gov/hearings/printers/112th/criminal2011.pdf>,
11. Easterbrook, Frank H., Plea Bargaining as Compromise, The Yale Law Journal, vol. 101, br. 8/1992, Symposium: Punishment, str. 1969-1978, Burimi: vonimir Tomičić, Ante Novokmet: Nagodbe stranaka u kaznenom postupku – dostignuća i perspektive, Prani vjesnik 2012 -34,
12. Lydia Brashear Tiede, An Analysis of Macedonian Sentencing policy and recommendations for future S directions: Towards a more uniform system, OSCE, Mission to Skopje, dhjetor 2012,
13. Д-р Вернер Бојлке, Закон за кривична кривична постапка, 2009,
14. Alternativni kazneni postupa u politici kaznenog procesuiranja u Jugoistočnoj Europi, Bosna i Hercegovina, Parlamentarna skupstina Bosne i Hercegovine, Sekretarijat/Tajnistvo Zajednička sluzba – Istrazivački sektor, Alternativni kazneni postupak u politici kaznenog procesuiranja\_l.pdf

15. Dragan Novosel, Načelo svrsishodnosti (oportuniteta) – zakonska resenja i primjena, Savremene tendencije krivičnog procesnog prava u Srbiji i regionalna krivičnoprocesna zakonodavstva (normativni i praktični aspekti), OSCE Srbija,

16. Проф.д-р Гордана Калајџиев & Проф.д-р Гордана Лажетиќ Бужаровска, Закон за кривичната постапка, Скопје, април 2011,

17. М-р Стојанка Мирчевска, МРКПК Бр.2 2007,

18. Проф д-р Оливер Бачановиќ, Новините во положбата на оштетениот во кривичната постапка, МРКПК Бр.2,

19. Dr Zeljko Horvatić, Posebni slučajevi odustajanja od gonjenja i mirenja u krivičnim stvarima, JRKK, 1-2/82,

20. Prof d-r Gordana Buzharovska dhe Asist.d-r Gorasn Misoski Pojednostavljene forme postupanja kao bitno obelezje reformi krivicnog procesnog zakonodavstva zemalja regiona, Osce Misija u Srbiji, Beograd 2013,

21. Коментар на Законот за кривичната постапка, 1. Калајџиев, Гордан 2. Лажетиќ, Гордана 3. Неделкова, Лидија 4. Денковска, Маја 5. Тромбева, Мери 6. Витларов, Тодор 7. Јанкуловска, Павлина 8. Кадиев, Дељо, Мисија на Обсе во Скопје, ноември 2018,

22. Dr. sc. Zvonimir Tomičić Viši asistent Pravnog fakulteta Sveučilišta Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku Ante Novokmet, mag. iur. Asistent Pravnog fakulteta Sveučilišta Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku, Pregledni znanstveni rad UDK 343.13:343.15,

23. Правна анализа - Практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р Џемали Саити, проф д-р Никола Тупанчевски, проф д-р Александра Деаноска, м-р Андреј Божиновски, OSCE – Мисија во Скопје, 2017,

24. Правна анализа I – Казнената политика на судовите во Република Македонија и практична примена на Законот за одредување на видот и одмерување на висината на казната, д-р д-р Џемали Саити, проф д-р Беса Арифи, судија Шпенд Деваја, м-р Андреј Божиновски, Здружение на судии & US Embassy Macedonia, Скопје, 2018,

25. Fondation open society Macedonia, Системски мониторинг на кривични судски постапки во 2020 година, Скопје, 2021, страна 21, преземено од Мисоски Б., Аврамовски Д., Петровска Н., Анализа на податоците од наблудените судски постапки во 2017 година, Коалиција - „Сите за правично судење“,

26. OSCE & Koalicioni të gjithë për gjykime të drejta, Analizë e të dhënave nga monitorimi i procedurave gjyqësore në vitin 2016, Shkup, dhjetorë 2016,

27. Prof d-r Stanko Bejatovic, Pojednostavljene forme postupanja kao bitno obelezje reformi krivicnog procesnog zakonodavstva yemalja regiona, Osce Misija u Srbiji, Beograd 2013,

28.Milan Filipovic, Monitoring suđenja u krivičnim postupcima – priručnik za novinare, YUCOM – Komitet pravika ya ljudska prava & American bar association- ABA, Monitorin Krivicnih postupaka.pdf .

29.Водич за примену законика о кривичном поступки Републике Србије, Београд 2015,  
/vodic%20za%20primenu%20zakonika%20o%20krivicnom%20postupku%20republike%20srbije%20(2015).pdf.

30.Drejtësia penale në Shqipëri, Vlerësimi i përgjigjes së sistemit gjyqësor ndaj trafikut të narkotikëve, Fondacioni Shoqëria e hapur për Shqipërinë,  
[https://www.osfa.al/sites/default/files/drejtësia\\_penale\\_ne\\_shqiperi.pdf](https://www.osfa.al/sites/default/files/drejtësia_penale_ne_shqiperi.pdf).

31.Fazat e procedurës penale – për Avokatët, fq.70,  
[http://www.brrln.org/uploads/documents/335/Priracnik\\_za\\_kvivicna\\_postapka\\_KOS\\_2\\_3-final.pdf](http://www.brrln.org/uploads/documents/335/Priracnik_za_kvivicna_postapka_KOS_2_3-final.pdf).

32.Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri procedurës penale në Kosovë, osbe, Misioni në Kosovë, qershor 2016 <https://www.osce.org/files/f/documents/b/c/243981.pdf>

33.Federal Rules of Criminal Procedure, 2011, <http://judiciary.house.gov/hearings/printers/112th/criminal2011.pdf> .

34.Plea and Charge Bargaining Research Summary, Bureau of Justice Assistance U.S. Departament of Justice January 24 ,2011,PleaBargainingResearchSummary.pdf,

35.Prirucnik za postupanje advokata u krivicnom postupku, Beograd 2019, prirucnik-za-postupanje-advokata-krivicnom-postupku.pdf.

36.Dr. sc. Zlata Đurđević, Osvrt na rezultate rada radne skupine Ministarstva pravosuda za uskladivanje zakona o kaznenom postupkus Ustavom Republike Hrvatske, [https://www.pravo.unizg.hr/\\_download/repository/1\\_Djurdjevic.pdf](https://www.pravo.unizg.hr/_download/repository/1_Djurdjevic.pdf),

37.Prof dr. Milan Skulic, Odnos nacela istine i pojednostavljenih formi krivicnog postupka, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/d/103136.pdf>,

38.Criminal proceedings and defence rights in the Netherlands, February 2014 fq.19-20<https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Criminal-Proceedings-and-Defence-Rights-in-the-Netherlands.pdf>,

39.Netherlands Code of Criminal Procedure, Netherlands\_CPC\_am2012\_en.pdf, Section 51b.

40.Pauline Jacobs and Petra van Kampen - Dutch ‘ZSM Settlements’ in the Face of Procedural Justice: The Sooner the Better?  
file:///C:/Users/user/Downloads/291-754-1-PB%20(1)%20(1).pdf;[https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2529959](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2529959).

41.Theme: Reform, Change Management,Criminal Procedure And Public Prosecution Reform In Italy: A Flash Back By Marco Fabri, Senior Researcher - Research Institute on Judicial Systems, National Research Council, Bologna, Italy,

file:///C:/Users/user/Downloads/Criminal\_Procedure\_and\_Public\_Prosecution\_Reform\_i.pdf,

42. William T. Pizzit and Luca Marafiotif, The New Italian Code of Criminal Procedure: The Difficulties of Building an Adversarial Trial System on a Civil Law Foundation, The Yale Journal of International Law Volume 17, Number 1, Winter 1992, <https://digitalcommons.law.yale.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1585&context=yjil>, fq.21

43. Nicola Canestrini Useful Information Italian criminal trial, <https://canestrinilex.com/en/readings/trial/>, 2018.

44. Plea and Charge Bargaining Research Summary, Bureau of Justice Assistance U.S. Department of Justice January 24, 2011, [PleaBargainingResearchSummary.pdf](#).

#### **Adresa (burime) elektronike:**

1. <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2021/08/izveshta%D1%98-za-2020-%D1%98o-na-rsm.pdf>.

2. <https://jorm.gov.mk/godishen-izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelstva-vo-republika-makedonija-vo-2016-godina/>,

3. <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/01/godishen-izveshtaj-za-raboteneto-na-javnoto-obvinitelstvo-na-republika-severna-makedonija-za-2018-godina.pdf>,

4. [https://www.law.cornell.edu/wex/plea\\_bargain](https://www.law.cornell.edu/wex/plea_bargain).

5. [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislativni/Udhezim%20nr.%20160\\_2021%20per%20Negocim%20e%20marreshes%20mbi%20pranimin%20e%20fajesise.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislativni/Udhezim%20nr.%20160_2021%20per%20Negocim%20e%20marreshes%20mbi%20pranimin%20e%20fajesise.pdf), A.nr.160/2021, nga 27.05.2021,

#### **Raporte:**

1. Republika e Kosovës, Prokurori i Shtetit, Raporti i punës 2020, shkurt 2021, <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files>

2. Izvješće Glavnog Drzavnog Odvejtника Republike Hrvatske o radu Drzavnih Odvjetnistava u 2020 godini, Zagreb, Travanj 2021,

3. Izvješće Glavnog Drzavnog Odvejtника Republike Hrvatske o radu Drzavnih Odvjetnistava u 2019 godini, Zagreb, <http://www.dorh.hr/dorh29042021>,

#### **Ligje:**

1. Ligji për procedurë penale i RM, Gazeta zyrtare e RM, Nr.150 nga 08.11.2010 viti,

2. Ligji për procedurë penale i RM, Gazeta zyrtare e RM nr.15/97,

3. Ligjin për procedurë penale (viti 1997), Gazeta zyrtare e RM nr. 15/03,

4. Ligji për ndërimin dhe plotësimin e Kodit penal, Gazeta zyrtare e RM NR.28/14,

- 5.Ligji për për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Z e RM NR.199/14,
- 6.Kodit penal i RM(2004),Gazeta zyrtare e RM nr.19/04,
- 7.Ndryshime dhe plotësime të Kodit penal, dhjetorë 2014, Gazeta zyrtare nr.199/14,
- 8.Ligji për mediacion, Gazeta zyrtare e RM nr. 60/2006; 22/2007; 114/2009 nga 14.09,2009,
- 9.Ligji për procedurë penale i Republikës së Serbisë, Gazeta zyrtare nr.46/06,
10. Ligji për procedurë penale i Republikës së Kroacisë, NN 62/03; NN 1152/08; 76/09; 80/11; 121/11; 91/12; 143/12;56/13; 145/13; 152/14; 70/17, <https://www.zakon.hr/z/174/Zakon-o-kaznenom-postupku>,
- 11.LPP i Republikës së Shqipërisë Nr7905/1995; Nr.7921/1995;7977/1995; Nr.8027/1995; Nr.8180/1996; Nr.8245/1997; Nr.8460/99; Nr.8570/2000; Nr.8602/2000; Nr.8813/2002; Nr.9085/2003; Nr.9187/2004; Nr.9276/2004; Nr.9911/2008; Nr.10054/2008; Nr.145/2013; Nr.21/2014; Nr. 99/2014; Nr.35/2017,
12. Ligji për procedure penale i Republikës së Slovenisë, Uradni list br.63/94,
13. Закон за кривична постапка на Сојузна Република Германија, 7 prill 1987, Gazeta zyrtare federale I, ndërrime 16 korik 2007 Gazeta zyrtare federale I, ИПЗ – Македонија, 2009,
14. ZKP i RS „Sl. glasnik RS“, br. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013 i 55/2014, [https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik\\_o\\_kvivicnom\\_postupku.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik_o_kvivicnom_postupku.html)
- 15.Kodi i procedurës penale të Kosovës Gazeta zyrtare e Republikës së KosovësNr.37/28 dhjetorë 2012,

#### **Vendime të gjykatave:**

- 1.NN 152/08, 76/09, 80/11, 91/12 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të R së Kroacisë, 143/12, 56/13, 145/13, LPP në përgjithësi.
- 2.Gjykata supreme e Kroacisë, Aktgjykimin I Kz Us 41/2012, nga 12.09.2013 viti, Shih në Vrhovni sud Republike Hrvatske, IZBOR ODLUKA 1/2014, Narodne Novine - Vrhovni sud Republike Hrvatske, Izbor Odluka, Narodne Niovine, 2014, fq.214-215, Aktgjykimin I Kz Us 41/2012, nga 12.09.2013 viti,
3. Republika e Shqipërisë, Gjykata e lartë, Standardet e gjyimit civil, administrativ dhe penal , përmes vendimeve unifikuese të Gjykatës së lartë 2000- 2014, 2014, Vendimi nr.2 datë 29.01.2003,
4. Gjykata supreme e RMV, Vendim Vkz 2 nr. 39/2019 nga 02.07.2020,
5. Gjykata supreme e RMV, SENTENCA KVP Nr.28/2015,<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/>.

#### **Udhëzime, rregullore dhe rekomandime:**

1. Udhëzim i Prokurorisë shtetërore, Prokuroria shtetërore e Republikës së Kroacisë, Nr 0-2/09, 2010,
2. Udhëzues për politikën ndëshkimore të Kosovës [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore\\_Shkurt%202018.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf)
3. Rregullore për mënyrën e matjes së dënimit, si obligim nga ndërmet dhe plotësimet e Kodit penal, Gazeta zyrtare NR 64/2014, Udhëzuesi për KPP-në, f 30 dhe 62. Shih edhe komentare për KPP-në, (shënimi 41 më lart) f 571-605.
4. Udhëzimet për Marrëveshjet mbi Pranimin e Fajësisë, Zyra e Kryeprokurorit të Kosovës dhe Kryeprokurorit të EULEX-it, 13 nëntor 2013, adresuar të gjithë prokurorëve në Republikën e Kosovës, [http://www.pshks.net/repository/docs/Instructions\\_on\\_guilty\\_plea\\_agreements.pdf](http://www.pshks.net/repository/docs/Instructions_on_guilty_plea_agreements.pdf).
5. Udhëzime mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë, 12 nëntor 2013, tashmë e shfuqizuar, [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/AnudhzAdmn/Udhezim%20per%20pranim%20te%20marreveshjes%20se%20fajesise-Shfuqizuar\(1\).pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/AnudhzAdmn/Udhezim%20per%20pranim%20te%20marreveshjes%20se%20fajesise-Shfuqizuar(1).pdf),
6. Udhëzim për rastet e dhënës në familje (Që të mos dërgohen në ndërmjetësim), A.nr,360/16, 29 qershor 2016.
7. Recommendation No.R(87(18) concerning the simplification of criminal justice,
8. Rezoluta e Kongresit të XIII për të drejtë penale, Kairo 1084,